

# SHENJTORJA E SHPATIT

TREGIME



8SH-94-32

SH 46

8SH-94-32

5<sup>1</sup>

BIBLIOTEKA E RINISË

# Shenjtorja e Shpatit

(Tregime)

~~44285~~  
2455

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## PËRSHESHI I PAPUT

Xha Trifoni, që kur lindi e u bë kaq plak me shkop në dorë e dhëmballë në kamare, nuk pa një herë diell me sy.

Mëngjezeve, me natë, kur xha Trifoni me qetë përpara e hostenin krahëve, si në të ri, shkonte në arë, diellin e linte gjithë prapa krahëve, më gjumë a më të zgjuar. Pastaj pak e nga pak dielli shpërgjumej duke ngritur kokën nga jastëku i Baba Tomorit dhe hapte gojën mbi fushat e Myzeqesë kur plaku ish më të sosur a brennda në arë. Ashtu edhe kur kthehej: dielli gjithë prapa krahëve, tek pështeste sytë e skuqur nga dremitja mbi jaştëkun hirosh të Apolonisë. Sa për pjesën tjetër të ditës, xha Trifoni as që kish nge të ngrinte kokë e të shihte diellin me sy.

Papu thotë më të mëngjér e më të djathtë se gjithë prapësia i vinte, xha Trifonit, nga terrellëku i kasolles e i arës, që i kish së prapi, të parren nga lind e të dytën nga perëndon, po xha Trifoni tundte kokën e përgjigjej gjithë po një:

— S'ka gjë, s'ka gjë, se mos zoti shihet ku-do... — dhe punonte me besë në zemër e diell prapa krahëve.

Meqë dielli s'këmbente udhë e xha Trifoni mendje, kasollja mbet atje tek ja kish lënë gjyshi e arat ku ja kish shënuar subashi<sup>1)</sup> E kështu shkonin e vinin vitet. Lëmenjtë ndronin vend, kuajt zot, bishat strofkull, po plaku s'këmbente zemër.

\* \* \*

Më të dalë të qershoret a më të hyrë të korrikut çdo shën Pjetër në mot, xha Trifoni nuk shtrohej vetëm e me të shtëpisë në sofër. Kryqin e perëndisë aso dite e bënte mbi bukë të tij papu Stefan. Papu Stefan, në doni të dini hollë-hollë, na ish prifti i shën Kozmait. Le që kush nuk e njeh papun, njeriun e perëndisë, që flet me zotin kudo ndodhet: në kishë në kishë, mbi gomar mbi gomar, në sofër, në sofër. Po ca më fort e njeh krahu i përkëtejmë lumit, që nga Mbrostari e në grykë të Semanit, se, çdo shën Pjetër në mot andej do ta kesh papun fshat më fshat e lëmë më lëmë, duke bekuar me borzilok e ajazëm të lashtat e stinës. Gjithë fshatrat e dinin siranë dhe shtëpitë radhën e tyre, pa nuk nxitoheshin në të korrat. Kish lëmë, të ndonjë fukaraj, që e zinte shiu i parë i vjeshtave, po pa ajazmën e paput nuk futej koqe në hambar. E papu ja fillonte bekimit që nga konaku më i parë i fshatit, nga lëmi i kapetanit<sup>(2)</sup> e pastaj lëmë më lëmë, gjer tek subashi të gjithë konakë

1) Fshatarë të pasur, mëkëmbës të beut në fshat.

2) Çifligarë të krishterë.

me pagurin në kamare e djathë në shëllirë të re. Sa për lëmenjtë e të këputurve, kish dhjakun papu që s'e mbante më kot pas. Dhe dhjakut i zinte dora si në bekim ashtu edhe në hakë, po aq mbarë sa dhe paput.

Po për lëmin e xha Trifonit puna ndryshon. Atje shkonte vetë papu, pasi mbaronte një herë lëmenjtë e tjerë. Me një tra, vërtet, e kish kasollën xha Trifoni, po papu s'vinte re. Pastaj kosi i bullicave të teto Frosinës, i ëmbël e i mpiksur për ta prerë me thikë, nuk kish të sharë. Dhe papu Stefani na e hante keq atë të shkretë pershesh.

## II

Një shën Pjetër papu na këmbeu udhë e zakon. Nuk e mvari më kamillafin në furkën e teto Frosinës, atje prapa derës, megjithëse lëmenjtë e botës i spërkatit tutje e tëhu me borzilok të ri e ajazëm të motit.

Xha Trifoni na u pismos pak dhe, dy ditë e dy net, kuajt mbetën të lidhur në lëmë e duajt e grurit lart në qerre.

— Se ç'ka papu me ne... — i tha e shoqja, teto Frosina,, atë mbrëmje, duke rënë në të shtruarat. Pastaj si shoi kandilin shtoi: — Diç më ha zemra, pa ku linte papu të thartohej kosi im...

Të tretën ditë e mori vesh xha Trifoni si qëndronte puna.

I thanë se papu na paskish marrë mëri me

të për shkak të atij laços, të birit, Naumit. Dhe Naumi, siç i thanë, na i paskish punuar një të pabërë. Kish shkuar ditën e të vdekurve, kur të gjallët mbyllin sytë me gjethë arre e të vdekurit shëtisin «traka-truk, traka-truk» nëpër ajo-dhimë, në shën Kozma, dhe kish bërë një zullum të madh me papu Stefanin që meshonte aso dite.

Djali i vogël i xha Trifonit na qe një laço sa për shtatëqind bashkë. Po edhe laços, vetëm, nuk i rrihet. E kështu, atë dië të shënuar kur shëtisnin edhe të vdekurit e jo të gjallët si Nau-mi me shokë, më të na mbledh nja tre laço të tjerë e na niset për në shën Kozma. Ç'patën në kullotë, lopë e qe, i lanë shpenguar fushave dhe vetë muarën bregun e lumiit për në kishë. Udhës këputën sikush nga një gjethë arre e sikush u bëri nga një vrimë; aq sa për të parë të vdekurit që do të shetisnin aso dite në kishë.

Kur sosën në shën Kozma, shpirt s'kish mbetur në ajat. Të gjithë kishin hyrë cë të shih-nin, si çdo vit, me sytë e vulosur me gjethë arre, të vdekurit që ngrihen nga varret. Veç nja tre pleq të këputur, që gjenden në çdo panair a të kremte, rrinin e kollofitnin në derë të kishës ç'kish mbetur në fund të kanistrave, se me bark bosh s'ke c'i do të vdekurit.

Të katër laçot hynë në kishë pa zë e bujë. Me takijet në njérën dorë e me gjethet e airës në tietrën, duke heaur opingat fësh-fësh nëpër plloçat e shtratatë të kishës, shkuant atje përpara. Qirini nuk ndezën, se s'kishin para, po ikonat i puthën. Gjithë kisha, dhe prifti me psaltërit. Kthyen kokën andej e bënë çudi me të katër,

sherretët e fshatit që ishin vënë më në fund në udhë të perëndisë.

Të katër loçparët ndenjën një copë herë urtë, duke nuhatur erën e fortë të kinjemit e të dyllit që u guduliste hundët e duke dëgjuar psaljen njësh, të mërziçme të paput. Pastaj s'ju ndej më rehat. Vështruan njëri-tjetrin në sy e, sikur ta kishin bërë me fjalë, lagën në gojë majrat e gishtrinjve dhe filluan të ndukin një nga një kokat e ndezura të qirinjve. Lambadhet, si kërcitën një grimë nga faji i pështymës, pushuan së derdhuri lot të njomë dylli dhe lëshuan përpjetë një bisht tymi. Njerëzit të ngacmuar nga era e rëndë e fitilit të shuar, nisën të kolliteshin; në fillim ata të rreshtit të parë, epitropi, bakalli i fshatit, subashi e pastaj me radhë, sikur t'ja mbanin ison parësisë, të gjithë gjer tek teto Frosina. Po kisha nuk është si shkolla. Perëndia nuk duron as qortime, as fshikëllima. Andaj kandillonafshi, çapçap ngritur mbi majrat e opingës ju afrua lopçarëve e ua bëri rrëptë me gisht:

— Kur s'ndizni, q'keni që shuan!... — dhe zu të ndezë një nga një qirinjtë e fikur. Njerëzia, sikur të prisnin këtë, pushuan së kollituri. Kisha u krohd prapë në tymin hirosh të kinjemit dhe në litaninë e paput.

Papu Stefani, pasi psali sa psali, si duket mbaroi dhe ngriti gjethen e arrës e zuri sytë. Që të gjithë bënë ashtu si papu: vulosën sytë me flitet e pemës. Kështu bënë edhe të katër lopçarët. Po vrima në gjethe ua ipte na, si në pëllëmbë, ajo-dhimën. Pritën sa pritën, po të vdekurit s'po du-keshin gjökund. Të katër laçot vështruan njëri-tjetrin. Në atë kohë filloi «traka-truk, traka-truk»,

që dilte nga ajodhima mbytur-mbytur e përhapej pastaj si tymi i kinjemit e kumbonte nëpër kishë trazuar me litaninë e mekur të psaltit. Të. katër lopçarët panë prapë nga ajodhima e vështruan prapë njeri-tjetrin. Diç panë pa i mori të qeshurit. Dhe ai që ja shkrep i pari qe, për brengë të tij dhe turp të xha Trifonit, Naumi. Pastaj ja dhanë tre të tjerët, E kisha, këtë ditë të vdekurish u mbush me gas të madh. S'qe keq dhe kështu, po nuk zgjati. Ulurima e paput, që dridhte mjekrën dhe duart për qiell, dha pallë. Të katër ua mba-thën këmbëve, po populli, i llahtaruar nga ngjallja e të vdekurve dhe pallma e paput, mori, o burra, të dalë nga dera. Papu Stefani vërviti prakat, me të cilat çdo mot, ditën e të vdekurve, bënte «traka-truk, traka -truk» dhe brodhi të zinte, të zinte vetëm... vetëm një. E prapë për brengë të tij e turp të xha Trifonit qëlloi që ky të qe Naumi. Ljepur Naumi në mes të njerëzisë, po ç'e do, papu s'kishte vetëm mjekrrën të gjatë, po dhe duart!

Kur besimtarët në çardhak të kishës mblo-dhën mend, kuptuan se ata që uluritën patën qenë të gjallët. Plakat nisën të bëjnë kryq përsë-ri që i shpëtoi zoti nga të vdekurit, nuset u hohën të gjejnë prakat e paput, teksha burrat qesninin e mekeshin me të katër laçot.

Të gjithë vijnë e shkojnë, po zemërata e paput atë ditë nuk pati të rënë. Ashtu dhe veshët e Naumit, që i mbetën të kuq flakë e ndehur-ndehur, sikur të ishin llastikë e të gjuanin me ta harabelë.

\* \* \*

— Hasha, hasha do ta bëj qerratanë! — kish thirrur si i tërbuar xha Trifoni kur i shtinë në vesh gjurulldinë e të birit në kishë dhe zemëratën e paput në ajodhimë.

Dhe hasha e bëri vërtet. Atë natë Naumi as u ngrys e as u gdhi në shtëpi. Në kufi të fshatit i thanë për zemërimin e madh të plakut dhe ai, nga frika e drurit, nuk shkeli në prag. Teto Frosina, gjithë atë natë, nuk mbylli sy. As xha Trifoni, që priste të shfrente paq mbi zuzarin që e kish turpëruar para zotit e njerëzisë. Po Naumi nuk u bë i gjallë.

Pas një javë gjithë fshati mori vesh, edhe xha Trifoni që e pat bërë hasha, edhe papu Stefanë që i pat mallkuar ditën e pagëzimit, se Nau- mi ish hedhur përtej, tek partizanët.

— Në esfel të vejë!... S'dua të ma zini më me gojë...! kish shfrehur në sy të burrave xha Trifoni. Po teto Frosinës, që fshinte sytë me kin- dat e kotllës, i pat folur me të butë.

— Hesht, deh, dhe ti! Atje, ja do të bëhet njeri, ja kështu!... dhe i pat rënë truallit me stap.

Dhe vërtet, Naumi, u bë njeri. Trimëritë e tij s'kishin të rrëfyer. Edhe xha Trifoni e mori vesh, po bir s'desh ta quante gjersa papu mbante akoma mëri me të e Naumi s'përfillej për zemë- ratën e tij.

### I I I

Të lashtat atë mot kishin marrë mbarë. Më t'ishin bymyer ato kallcat e të grunjtave e vaise-shin sa më një anë e më një anë, sikur të përshëndoshnin gjithë sa gjenin mb'udhë. Ujët e lumi-t mirrte tatëpjetë duke kënduar e mërmëritur mbi zajet që kish zbritur nga mali dhe kur e kur kthente kokën pas, andej bryleve, ku mezhda e lumi-t dy boj e ca njeriu e lart nuk i linte udhë. Në këto dhera kishte arat edhe xha Trifoni. Dhe mezhda e lumi-t, ashtu edhe ai, plak nga të rën-dët, nuk i bëri udhë zemëratës që e kish marrë atë mot për të birin.

Lufta kish shkuar edhe në këto anë e si kudo, kish lënë vragë mbi tokë e vragë në zemër. Po si mbi tokë, ku çdo gjë u mbulua nga bagëtitë e stinës së re, ashtu dhe mbi zemër të njerëzisë ndihu kallci i ri, që përshëndeste botën përkultur gjer poshtë mbi dhe.

Kasollja i qe djegur xha Trifonit, nga gjermanët e ballistët, po ara i qëndroi në vend. Nuk di, për mbarësi apo për ters, po papu Stefani diç i konte përditë në vesh.

— Dëgjo papun ti, pa s'të del liksht!... Ndërvend se prapësinë ta ka trualli. Unë flas me perëndinë dhe perëndia tha: «Dhe kasollja u dogj dhe prapësia mbeti...». Ngrije të them, kasollen, në perëndim të arës, matanë, ballë diellit si ballë perëndisë, në do që të shohësh ditë të bardha.

Po xha Trifoni tundte kokën e s'këmbente mendje.

— Jo, mor, jo... Atje tek ma lanë kasollen

gjyshërit, atje do ta lë... Si të mbledh kockat unë, në esfel le ta ngrenë pastaj.

Ahere prifti ja kish mbledhur.

— Po qorr je, o xha Trifon që nuk shikon si i ngrehim kishat ne orthodoksit e perëndisë, me ajodhimën nga lindja, ballë diellit si ballë zotit?

Xha Trifoni s'kish folur, po kasollen e ngri- ti gjithë me mendje të vet, atje, mbi truallin e shkrumbëuar të së parës.

Po jo më kot kishin zbritur partizanët nga mali... Ja, për këtë: që të shihnin diell me sy edhe ata që e kishin patur më kurriz, edhe xha Trifoni, që kasollen e kish në atë krah nga lind dielli dhe arat në perëndim së prapi...

\* \* \*

Çdo gjë ka anë e udhë, po gazi i xha Trifonit këtë mot nuk kish të përbajtur. Me hosten të qeve, kur s'kish besim në trup të tij, masste e stërmaste kallnjëtë e hedhur përpjetë përlakmi të botës e për ngazëllim të plakut. Të gjithë, kush për zili të syrit e kush për nakar të zemrës thoshin se këtë mot asnjë nuk i kish kaq të mbara të grunjat sa xha Trifoni,. Po plaku ecte në punë të tij ngadalë-ngadalë, si lumi në udhë të tij. Tek e tek tundte kokën, po kjo jo për siklet të moteve të vështira që pat kaluar se sa për atë fjalë që i kish shtyrë në vesh papu, kur pat rënë biseda për tokat e manastirit që u ishin ndarë bujqërve.

— Ç'i thua ti kësaj!... Nëm ç'nuk më ke na ç'nuk të kam?... Mirë juve, rob jini e s'dini, po perëndia si duron kësisoj!

Vërtet të lashtat i kish si do zoti e robi, shtëpinë ngritur me gjithë të mirat, tokë të tij të shumë e të yndyrshme, po q'e do. Ato fjalët e priftit i kishin mbetur murriz në zemër, që s'e linin të bënte një hap pa e lënduar gjer thellë në shpirt.

Sa hostenë kish shkuar xha Trifoni gjer ish bërë aq, një herë s'i pat ngulur në arë të tij, po gjithë në të kapedanit e të manastirit. Edhe një herë, që po e ngulte, tani, në pleqëri ja... ta pikojnë m'u në zemër... Dhe mejtohu e bot xha Trifoni dhe kthe mbarë e prapë fjalët që i kish thënë papu atij mëngjezi.

— Mirë, o i uruari i perëndisë, këtë mot na i paske të mbara të grynjtat e misërishtes, po sikur të zgresë një re shi e t'i zerë në lëmë, po sikur të dalë lumi e t'i zëré nd'arë, ku do të pësh-teç kokën ti, vet i njëzetë?

Dhe xha Trifoni, njeri i perëndisë, që s'i qas buza ç'nuk i mban zemra, diç kish pa bëlbëzon-te me vete:

— Vërtet, diell me sy s'të ka parë xha Trifoni, po edhe ky kapedani e igumeni nuk më kanë lënë vetëm, po m'u gjendën në brengë e rë hall, se, me sa dha zoti, rob jemi.

Këto mbluante në zemër xha Trifoni sa herë do ta gjeje jo në të mirat. Këto bluante me vete sa herë qëllonte në rrugë për pazar e mulli, atje majë pelës a maië qerres, tek ndiqte me sy po me mendje gjetiu, dy tragat e rrotave që tireshin, tireshin përpara e s'bashkoheshin kurrë.

\* \* \*

— Edhe ti, o burrë, po dërgoi dy gisht kartë të shkretën të na vijë djali në lëmë të madh, ta gjëzojmë gjithë bashkë këtë ditë.

Po plaku ngulur tek përvazi i dritares, shikonte të grynjtat e ardhura e s'bënte zë.

— Edhe zemërata ka anë e udhë, po jo kështu, na u bënë sytë ujë nga dera... — i fliste e shoqja duke ngritur të shtruarat.

Po zemërata e xha Trifonit mbante më shumë se ajazma e papu Stefanit.

Në mes të javës, një mbrëmje, kur plaku, si zakonit, qe pështetur në përmakët e hajatit e po dëgjonte këmborët e lopëve të fshatit, që sa vinnin e rralloheshin e meheshin, shpërndarë më të djathtë e më të mëngjér të rrugës, gjersa imbe-tej në fund zilja e lehtë e mushqerrës së tij, një dallëndyshe na kthehet me sulm nga korijet e qëndron, duke cicëritur plot mall, mbi buzën e folesë së saj ngritur atje në kënd të çatisë së hajatit xha Trifonit sesi ju kujtua i biri, Naumi, dhe kraharori ju mbush me një mall të parrëfim. Kur ndjen se zemra e vogël s'po ja nxinte gjithë këtë afsh që po teptiste mblodhi veten në hop e diç desh t'i fshehë botës e vetes kur mori e fshiu me kurriz të dorës një lot, pa e lënë të rrëkellehesh e të bënte vragë e tragë. Po malli i prindit është mall: po të zuri s'e mban dot. Dhe xha Trifoni, burrë nga të parët, që s'ja këput dot lotin as brenga as rakija, gjithë një zemër kish.

— Deh moj pikë e zezë deh... Ta qaj më gjallje!... Dhe fshiu prapë mollzat e rreshkura

të faqeve, që ja kishin mpirë me kohë lotët e parë.

Kur e pa teto Frosina të shoqin në këtë ditë, u fut brenda dhe vajti e bëri kryq te ikona: «O shën Mëri! Ti që i hape zemrën plakut, mos m'i mbyll rrugën djalit!...»

Xha Trifoni, si ndjeu hapa prapa krahëve të tij, la parmakët dhe mori të dalë. Rrugës i dolli qeni.

— Në djall ti me gjithë papun!... dhe i ra qenit me shkelm, sikur ja pat fajin kafsha.

#### IV.

Këtë herë zemërimi i plakut s'mbajti sa ajazma e mallkimi i paput. Të nesërmen xha Trifoni i dha udhë t'i shkruajë kartë të birit më te për për t'i shtyrë në vesh të ngjarat e fshatit se sa mallin e zemrës. Po edhe mallin e zemrës, ngazi që papu Stefani, takuar mb'udhë atë ditë, i dha fjalën se do të vinte në lëmë të madh t'i bekonte bukën e motit. Po aty ndaj darke ktheu mendje. Mallkimi i paput, heshtja e të birit dhe loti i gruas po ja kungonin zemrën me një brenë që nuk e shuanë dot as me të djegurit e fortë të rakisë, as me helmin e sertë të duhanit.

Tërë atë natë plaku s'vuri gjumë në sy. Dhe andej, dhe këndeje e kapërxyll s'po gjente doi. Po si i thonë fjalës «Dita zbardh atë që nxin natë», aty ndaj të gdhirë ju kujtua se gruri i tij s'ish rritur me bekimin e paput që të bënte vetëm për meshë prifti... Sakaq hodhi tej mbulesat e këmbadoras, i vajti të nipit pranë. Seç kë-

konte nga ai atë mëngjes: pa filloj ta puthte  
andej e ta puthte këtej të voglin që po flinte gjum-  
min e shqerrës. Lipi u kthyen në anën tjetër. Ahe-  
re teto Frosina ndjeu e hapi sytë.

— U, ç’lë ka gjetur o burrë, kështu, me natë?

Xha Trifoni s'bëri zë. Ish zënë me të nipin  
tek po i queshte e po e guduliste, në udhë për t'i  
nxjerrë gjumin.

— Aj, xhani i babajt, ngrehu!

Lipi, që kish një copë herë që po rrihte qe-  
pallat, pérpoqi duart nga gëzimi kur i gjyshi i  
tha në vesh të ngrihej të mirrte kartë e kalem se  
do t'i shkruante letër xhaxhajt, Naumit. Po teto  
Frosina, që s'kuptoi ç'thanë ashtu kokë më kokë  
gjysh e nip, ju kthyen të voglit me qortim:

— Pa larë sytë një herë, drejt e në librat,  
ti...

— Se mos balua lahet në mëngjes... qesë-  
ndisi xha Trifoni duke përgëzuar qenin që i fër-  
kohej pas potureve.

Kur mori vesh tetoja se ku qëndronte puna  
ju var Lipit kandile mbi kokë dhe s'i shqiti sytë  
nga karta. Xha Trifoni u mendua ndopak nga  
t'ja fillonte e pastaj shpoi të nipin:

— Aj, biri babajt, zë e shkruaj:

«Fort i dashur biri im Naum,

«Sefte pyes për shëndetin tënd dhe i lutam,  
perëndisë të jesh mirë, sikundër dhe në këtej me  
gjithë shtëpi e gjë të gjallë, me fuqi të zotit, mirë  
jemi.

«O, sa gjëra ka për të të shkruar xha Trifoni ty,  
ashtu si ja do zemra, që nga kau balash e gjer tek  
kaposhi yt, që lufta i mori me vete bashkë me ka-  
sollen! Nejse, dy gjisht kartë po të shkruaj, për ma-

llë të nënë Frosinës, që s'të heq nga goja, pa për mua or bir, të na kujtoje ti më parë, do qe më e udhës. Po ç't'i bësh. Zemra e plakut, sado e fortë ndodhtë, prapseprapë zemër plaku është.

«Reforma agrare, që e zinin aq shumë mbë gojë partizanët kur zbrisnin nga neve, erdhi dhe këtej. Arat na u matën e na u stërmatën e na u caktuan shtatëdhjetë e ca dynym, gjithë në dhe të mirë e kallame më e tepërtë. Nipëria i qëndisën sinoret me fiçorre lumi dhe pastaj më prapa hapën një hendek një boj e ca njeriu. Unë, pas tyre, o bir, rrinje e i dëgjonje tek argaliseshin nga gazi i madh që ndjenin në zemër aso dite. «Ja, këtu nën këtë ledh është varri i kapedanit...» qeshte e hasdisej yt vëlla, Mihali, nësa Vasili ja priste: Edhe lugat të bëhet tani kapedani, këtë hendek s'ka për ta hedhur kurrë...» Ata qeshnin e qesëndiseshin me kapedanin, po mua, të flas shpen-guar e si djalë që të kam, më vinte pakëz rëndë. Mos m'u zemëro, o bir; shokët e tu, ata të malit, gjithë me zemër të hapët kërkonin që t'ju flisnin. Edhe ti nuk do të më zemërohesh. Ish pak i sertë, po jo dhe fort i keq nga shpirti ky kapedani ynë. Vërtet, ato që na ipte kur gjendeshim në shtrëngesë, qëllonte të na i kërkonte edhe për së dyti, po, mos të ish ai, xha Trifoni do të ta kish marrë të keqen me kohë, që kur erdhi një herë lumi e i përlau me të lashta e me të vona.

«Nuk di qysh të të them, o bir, po sesi e ndjej veten sot, kur ja, u gëdhish zot në tokën tijme. Nuk të them luftuam dhe u vramë, po ku di unë... sesi më duket... I ndjej shpatullat si pakëz afif, si pa pështetje. Sikur... sikur do të gremisem që në çapin e parë. Më ngjan vetja, tani në pleqëri, mu si ajo

foshnja që s'mbahet dot në këmbë po s'e mori njeri prej dore. Është bela, bela o bir, me ne pleqtë, po belaja goftë për kokat tona e mos ju pengoftë në rrugën që keni zënë. Turp të të them, e di, po, pas atyre që kemi hequr, pas atyre që më kanë parë sytë, besa, si zor është t'i besoj vetes, krahëve të mi.

«Të ta them, Naum. Të presim të na vish në lëmë të madh. Do të jetë dhe papu Stefani. Mos më lë të mbyll sytë pa ju parë të pajtuar. Ashtu bir i babajt.

«Po mbetem me kaq. Mirë thonë se kali i botës të lë mb'udhë, si Lipi mua, me kaq barrë mbi zemër. Ai po nxiton të shkojë në shkollë. Ej, or, bir, edhe lopët na i la fushave, që kur zuri në dorë kalem e libra. Nejse, u pa kjo punë, xha Trifoni do bëhet edhe një herë lopçar para se të mbyllë sytë.»

Lipi, që u zemërua nga këto fjalë, la kalemin dhe bëri të ngrihet.

— Aj, se qesh babagjyshi me ty... e përkëdheli plaku duke e mbajtur.

— Nuk e njeh tét gjysh ti, ashtu e ka ai, po s'të trazoi ty s'i kihet... u hodh dhe tha tetë Frosina, duke parë me inat të shoqin që ja la të birit letrën përgjysëm e duke e marrë me të mirë të nipin: — Merr kalemin e shkruaj edhe nga nëna këto fjalë:

«Teto Frosina të puth me mall e gjithë të pret të vish. Ka hequr mënjanë një dorë trana me vezë dhe s'i shkon pa ty.»

— Shkruaji!... — foli tetë Frosina duke i mbajtur kalemin të nipit:

«Eshtë trana me vezë, se s'ka më ballistë e gjermanë që të na farosin kurjakët e pulave.»

Ashtu, shpirti tetos, nga ana ime këto fjalë.

Dhe Lipi, duke shkruar, kthente kokën sa më njanë më njanë, herë nga xha Trifoni, herë nga teto Frosina, sa i dha fund me këto fjalë:

«Presim të të shohim në lëmë të madh. Nusej dhe nipërit të puthin dorën. Unë xha Trifoni, dhe teto Frosina të puthim sytë me mall. Të puth dorën edhe unë, Lipi, që shkruaj në këmbë të xha Trifonit.

Mojalli më I të qershorit 1946».

Teto Frosinës nuk ju ndënj gjersa nisi të nippin të mbyllë letrën. I dha me vete pesë kokrra vezë për t'i blerë sheqerka. Po për atë që do të binte kartë nga i biri ajo taksi zogëzën pikaloshe.

\* \* \*

Ditët shkonin dhe kallcat e grurit sa vinin e zinin bukë. Rrezet e diellit shkisnë mbi ujet e pakë të lumit dhe humbisnin nëpër mezhdat që të merrnin sytë.

Lumi vazhdonte të flinte mbi shtrat të tij, po xha Trifoni ngritur me natë, rrinte e vështronë mbi breg si rridhnin ujerat ngadalë-nga-dalë... Ashtu, mu si ditët e tij të pleqërisë, rridhnin këto ujerat e ndenjura atij behari të parrëfim, që do t'i sillte në shtëpi djalin e vogël.

Sa më shumë ditë shkonin pa marrë përgjigje, aq më tepër dhe gazi i shterrej plakut mu në zemër. Si ujet e lumit ky malli i xha Trifonit, që s'ngop e s'shemb dherin e thatë.

Kur mori kartë teto Frosina, zogëza pikalo-she ngrohte vezë, po tetoja nga gazi i madh, e fali dhe kloçkë.

Naumi s'u shkruante shumë, dy fjalë të shkreta, dhe teto Frosina s'ju nda Lipit gjersa

ja këndoi dhe një herë, dhe një herë, megjithëse nga kjo punë i shkoi një furrik me vezë, se i nipi s'dëgjonte ndryshe. Ku bënte fjalë për ardhje, tetoja e puthi Lipin dhe ju lut t'ja këndoje dhe një herë tjetër, mënjanë, vetëm asaj.

## V.

— Eh, or bir, edhe tymi i duhanit në fillim merr drejt po pastaj më prapa zë e dredhon rru-gë e çakërdiset për qzell. Ma ka thënë papu, mua, këtë, njeriu i perëndisë, që flet orë e çast me zotin.

— Si letra jote, o baba, që dredhonte e dredhonte e mb'udhë s'dilte... — Naumi kafshoi, përnjëherë buzën. I erdh rëndë që pa u ulur mi-rë në vatër, ja filloj me të keq.

— E që t'i s'ju përgjigje fare atij krahu...

— tha duke mbajtur veten xha Trifoni.

Ky i biri diç ish rritur në shtat e në hije. Plaku e kuptoi menjëherë se s'kishte të bënte më me laçon e parë.

— Ti ke një frikë në zemër, o baba, dhe kë-të e thua dhe s'e thua. Unë, po t'i shoh dhe në sy ato që t'i këndova në kartë. Dhe pikëllohem, o baba, kur kujtoj vuajtjet që të kanë prurë në, këtë ditë, sa mos t'i kesh besë shpëtimit dhe krahëve të tu. E di ku të ha zemra, o xha Trifon. E di pse i ndjen krahët si pakëz hafif e të pam-bështjetje, sepse, edhe ti po të mos ma kishe thënë, unë, si biri yt, do ta kisha kuptuar.

Xha Trifoni luajti pakëz nga vendi, po s'foli.

— Ti do tē thuash se sido që tē bëhej, edhe sikur moti shumë i lagët a i thatë tē mirrte, edhe sikur tē grunyat e misërishtet tē kalbeshin e tē digjeshin brenda ndë arë pa lidhur kokërr, edhe sikur koqe yshyri tē mos shtije bren- da në hambar, prapserapë bukën e gojës do ta kishje, se beu nuk do tē linte tē vdisje përmbyss. Vérte, o baba, pa tē hequr mishtë ç'do tē ta donte lëkurën kapedani?

Ky i biri kish marrë zjarr, po xha Trifoni, plak në mend e urtësi tē tij, gjithë me tē butë, ja priti:

— Mirë, o bir, po njëzet e ca gojë nga kjo kockë kërkojnë... — dhe i ra krahuarat tē tij.

— Po toka, do tē thuash ti... Po toka, mor Naum, kështu në ditë tē pikës si jemi ne bujqëria, vetëm tē vdekur tē nxë.

— Dëgjo, baba... Ne që bëmë luftën vetëm, pa ndihmë tē beut a tē kapelanit, gjithë pa ndihmë tē tyre do tē ngrejmë dhe jetën tonë.

— Ja, kot ne pleqtë hyjmë në mes... — dhe psherëtiti plaku, thellë.

— Mos, baba... pikëllimi i pleqve mundon fëmijët. Pastaj ç'ke ti?

Xha Trifoni, si padashur, fërkoi kurrizin pas murit:

— Ja, ashtu, biri babajt, ndihem si pa pësh-tetje, këtej pas krahëve.

Naumi e kuptoi. Plakut i ish bërë vesves tē gërvishët gjithë në plagë tē vjetër.

— Andej flije mendjen o xha Trifon. Vëre takjen mbi sy. Kemi partinë ne, që na shikon në

dritë të syrit, furkën më të fortë ku mund të pështetesh pa frikë, furkën e lyer e të regjur me gjakun e bijve të tu, që as krimbi më i keq s'do ta bluajë dot e as moti më i prapë s'do ta kal-bë dot.

— Eh, or bir!... — dhe psherëtiu sërisht xha Trifoni, aq thellë nga zejmra.

— Folë, o baba, zbrazu një herë e mirë, që të ndihesh më pas i lehtë. Hape zemrën, që të di dhe unë ç'të keq pate nga kjo ditë.

— Asnjë të keqe, biri im, veç të mirave, po, di, di dhe unë, papu njeriu i perëndisë, që flet me zotin kudo ndodhtë, llafos fare ndryshe!

Pa mbaruar mirë këtë fjälë, dera e konakut u hap dhe nëpër të zbehtën e llambës që shpinte dritën gjer atje, të dy, at' e bir, panë papun të qëndronte në mes të pragut.

— Atje ku bota më zë në gojë, qoftë përmirë a përmirë keq; atje ndodhem dhe unë, njeriu i drejtë i perëndisë!... — Si tha këto, kapërceu pragun dhe vajti e vari kamillafin prapa derës.

— Ashtu, ashtu, uratë!... — ju përgjigj xha Trifoni duke u ngritur e duke i bërë vend njeriut të zotit.

Pas pak konaku u mbush me të shtëpisë. Të gjithë i morën dorën paput, ja vunë në buzë e në ballë e sikush vajti e u ul në vend të tij. Edhe Naumi e përshëndoshi, po dorën s'ja vuri as në buzë as në ballë. Papun e dogëndisi kjo mospërfillje, andaj s'priti ta qesëndisë në sytë e njerëzve të shtëpisë.

— Lopçar na ike nga fshati, o bir, pa praks e perëndi dhe na u ktheve zyrtar që na bëre pa praks e perëndi... O zot, të falemi që na bëre të

krishterë, se i krishteri mbetet para meje e përendisë!... dhe nisi papu, mbytur, të flasë me zotin.

Pa po si më t'u bë ky Naumi i xha Trifonit nga kjo qesëndi e shenjtëri e priftit të shën Kozmait! Flakë për flakë ja priti;

— Po dhe ti, papu ç'la dimri gjet behari. Veç dollomasë që na e paske prerë të re këtë mot, gjë s'paske ndryshuar.

Papu bëri sikur s'dëgjoi atje tek po fliste me perëndinë.

Kur u shtrua mësalla dhe u vu rakia me të përbrendshmet e kaposhit të pjekur si meze, të gjithë thanë nga një fjalë, veç papu Stefani, që s'e kish synë fare andej, (megjithëse mendja aty i rrinte), po gjithë për qiell, tek falej e lutej për shtëpinë e xha Trifonit, duke i zënë më gojë të gjithë kokë më kokë e emër për emër.

Llaf e muhabet u ngrit rakia, u shtrua çorba, u ngrit çorba, e u shtruan zogjtë jahni, u ngrit jahnija e ja dhanë kaponjtë e detit të pjekur, gjersa u erdhi radha kupave të kosit, që po prisnin nëpër duart e përveshura të nuseve.

— Eh!... E ha shumë këtë të shkretë përeshesh të ndërtuar me kosin tënd, moj Ffrosinë, — ju kthyesh papu plakës së shtëpisë, duke fërkuar atë kohë mjekrën.

— Të qofsha falë, ty o papu... e ç'lë mangut ti që t'u hëngërka keq ky përsheshi!... — dhe qesh e bot xha Trifoni, me papun, e fërkohundën, si e kish zakon, kur ish në gaz e sipër. Qeshte plaku, me gjithë zemër, tek shihte në sofër, pranë e pranë e të pajtuar, Naumin me papun.

Dhe bashkë me xha Trifonin qeshte dhe prifti i shën Kozmait.

Naumi në mes të bukës, në mes të gazit, i ra paput me bryl.

— A se pëersheshim bashkë këtë çanak me kos, o papu?

— Qysh jo, o i bekuar i perëndisë, s'ep nomi të prishemi pér kaqë gjë!... Dhe përshesh papu me të dy duart aty mbi çanak dhe fol e bot me perëndinë atje në qiel:

— Dhe falu të liqëve, o zot, ç'u ke taksur të mirëve, dhe jepu të mirëve ç'u ke taksur të liqëve, se të mirët gjithë të mirë mbisin.

Të gjithë zunë të bëjnë kryq: Ata të sofrës lanë lugët, ata në këmbë shpunë bardhakët e kotruvet në dorën tjetër, veç Naumit, që vazhdon te të përsheshët, të qeshte nën buzë e të dëgjonte.

— E zoti që njeh njerëzit si bariu dhentë, se me duar të tij, me baltë të tij, me fytyrë të tij, me frymë të tij i gatoi: dëgjon e gjykon mëkatarin e kësaj bote... Lëmenjtë janë të mbarë këtë mot, se zoti, me mëshirë të tij, u ep dhe të liqëve ç'u ka taksur të mirëve.

Nuseve, ngrirë qiri më këmbë, ju këpütën duart nga të bërit kryq. Po papu s'kish të pushtuar.

— Dhe çdo gjë në këtë botë ka kufi. Dhe arat në do, dhe lëmenjtë në do dhe llafet në do. Dhe mos u trazoftë mordulla me grurë, se shumë keq gjersa të qërohet e të ndahet e mira më një anë. e keqja më tjetër anë...

Çanaku po kulmohej. Lugët s'ndiheshin më në sofër, veç psaljet e paput ashtu mbytur — mbytur.

— Dhe mos u gënjeni në bëri lëmi një herë, dy herë, tri herë. Çdo gjë ka kufi, dhe arat në do, dhe lëmenjtë në do, dhe llafet në do. Edhe mëshira e perëndisë dhe pendesa e robit kanë kufi në këtë botë të mëkatuar.

E, me të thënë këto e pasi bëri kryq e prapë se ç'tha me zotin atje në qiel, njeriu i perëndisë rrëmbeu lugën dhe ju mat përshestit këtu mbi sofër.

— Aty, papu, qëndro!... ja priti Naumi dhe i ra lugës me lugë.

Papu mbet i çuditur dhe bëri kryqin e perëndisë. Po Naumi s'e la ta mbarojë.

— Më ndje, po, këtë përshest a s'e shkoqëm bashkë?

— Falur qofsh, o i bekuar i perëndisë, bashkë e bëmë e bashkë do ta hamë.

Naumi e vështroi drejt në ninëzë.

— Dhe zoti thotë se çdo gjë ka kufi, dhe arat, dhe lëmenjtë... Diç desh të shtonte tjetër Naumi, po s'ju kujtua çfarë.

— Ashtu, ashtu o i bekuar, dhe arat, dhe lëmenjtë, dhe zemërimi i perëndisë... Dhe lum ai që beson në fjalë të tij, dhe mallkuar ai, që prish gjerdhet, që bashkon qetë, që trazon krahët, që çart besën e tij, se perëndia thotë: «Gjithësecili veç, në vatër të tij, të gjithë bashkë në kishë...» Dhe u mat papu, me lugë në dorë, ndaj përshestit.

Po prapë luga mbajti lugën e prapë Naumi foli:

— Zoti thotë se çdo gjë ka kufi. Dhe ti, o njeri i perëndisë, që flet me zotin kudo ndodhesh, që bie në njerëzi fjalën e tij, thua se çdo

gjë ka kufi, dhe arat dhe fjalët... dhe zemërata...

— Ashtu, ashtu, dhe zemërata dënimplotë e mëshirëmadhit... — Dhe férkoi mjekrën papu nga qejfi që e vu komunistin të ecë në brazdë të tij.

— Po, o njeri i perëndisë... dhe zemërata... dhe përsheshi.

— Dhe përsheshi... — përsëriti papu pa e patur mendjen në vend dhe mori sërish lugën në dorë.

— Aty, papu... — dhe luga i ra lugës... — Zoti thotë se çdo gjë ka kufi: dhe arat, dhe lu-menjtë dhe përsheshi, Mos u nxito, bashkë e përsheshehm e bashkë do ta hamë, po shiko, o njeri i perëndisë, ta kemi fjalën që më përpara... nda e ha ç'përsheshe vetë e mos u trazo në të tjetrit... se çdo gjë ka kufi, dhe arat dhe lu-menjtë dhe përsheshi.

Më s'u përbajt ky papu kur dëgjoi Naumin të flasë kësisoj e qesh e bot nga gazi i madh që e mori.

— Po si, o i bekuar... si bëhet që në këtë çanak të shkretë të ndaj ç'përshesha vetë e të mos trazoj të botës!

— Pse qesh kështu, o papu! Ti shkoqit fjalët e perëndisë atje në quell e s'qenkerke i zoti të ndash kafshatat që thërmovë vetë në këtë përsesh këtu mbi sofëri!... Mos qesh, mos qesh kësisoj, o njeri i perëndisë, që flet me zotin kudo ndodhesh: mbi ungjill mbi pelë apo mbi thembrat e tua... <sup>(1)</sup>

Brraf na u hodh më këmbë ky papu; sikur ta kish kafshuar shëgjetlla në vend të lik. Ashtu

dhe xha Trifoni kur dëgjoi të birin të flasë për thembra mu në mes të bukës. Po Naumi, që s'donte t'ja dinte andej, vështroi të gjithë me radhë dhe ja krisi gazit tek pa priftin të rrëmbejë kamillafin e të fryjë jashtë.

Kur në oborr u ndjenë këmbët e pelës, lutjet e xha Trifonit dhe mallkimet e paput, Naumi zuri t'ëmën prej dore.

Ulu, nënë, të hash një kafshatë bukë, se t'u këputën këmbët së mbajturi nder e duart së bëri kryq.

Me t'u kthyer xha Trifoni, pasi s'kish përmabajtur dot as priftin as zemërimin e tij, ju çua të birit i hakërryer.

— Po jo kështu, deh!... dhe vajti e u fut në odë, u përfol me tetu Frosinën dhe tërë atë natë s'mbylli sy.

\* \* \*

Lëmin tjetër gruri u shi pa bekim të paput e gjithë pa bekim të tij u fut në hambar, e shkoi në mulli e u bë bukë e u hëngër tërë motin.

Në verë, kalliri i mbjellur me farën e truar çau tokën e, i uruar nga syri i botës, mori përpjetë. Sa më shumë që reshtej plaku mos zinte mallkimi i paput, aqë më shumë vinte kalliri bukë. Dhe çuditej xha Trifoni me vete dhe me mbarësinë që ja kish gjetur shtëpinë tanë në pleqëri. Po prapë as papu Stefani nuk e harroi. Në lëmë të ri, si moteve, dërgoi njeri ta thérresë, që t'i bekonte bukën, pasi i kish mallkuar farën. Po djali i madh u kthyte nga shën Kozmaj me pële lidhur pas pelës e me shalë bosh. I kallxuan

më pas se një natë ata të fshatit përtej lumit, e patën gjetur priftin në pyll të Drizës tek fjalosej jo me zotin siç e kish zakon ky papu i shën Koz-mait, po me një firar ballist dhe e kishin vënë përpara.

Xha Trifoni, kur dëgjoi të ngjarat e paput, tundi një herë kokën dhe shfryti djathtas e mëngjeras. Rrahu pastaj këmbën pas truallit dhe mori udhën që të takonte papun e ta pështynte mu në surrat. Po më të dalë të fshatit, ata që vi-nin nga Fieri i thanë se priftin e kishin vënë «brenda», që të fjalosej pakëz me vete, se mjaft kish folur me perëndinë.

Që asaj dite plakut i erdh zemra në vend dhe atje e la gjersa një natë, pasi gëzoi me fsha-tin bashkë lëmenjtë e rinj dha shpirt në krah të Naumit, djalit të vogël, mallkuar e falur aq herë në jetë të tij, po këtë herë bekuar me gjithë shpirt.

\* \* \*

Dielli s'ndërroi udhë e as bijtë e xha Trifonit mendje. Arat mbetën atje tek ishin e kasollja me krahët gjithë nga lind dielli. Dhe mëngjeseve kur shkonin në arë, dhe mbrëmjeve kur ktheheteshin në shtëpi, diellin gjithë prapa krahëve e kishin, po, të mirat e motit, ngado që të ktheje kokë.

Me partizanët kish zbritur nga mali dhe mbarësia.

## M. KALLAMATA

### BUALLI I KËNETËS

I pari që «e pa» Atë ishte Petro Zarika, ndihmës traktorist në kantjerin e bonifikimit. Themi «e pa» sepse as vetë Petrua nuk dinte të thoshte se çfarë kishte parë, megjithëse betohej se «diçka pa».

Atë mbrëmje nëndori ai kthehej si zakonisht për të kaluar natën në shtëpinë e vet. Ishte vonë, gadi më të ngrysur kur u nis nga kantjeri dhe po nxitonte që mos ta zinte nata rrugës, jo për gjë tjetër, por sepse nuk donte të gjendej natën buzë kënetës. Sidomos i druhej asaj pjese ku kënelta ishte e mbuluar me kallamishte. Rruga nga do të kalonte, gjarpéronte e futej thellë në ato kallamishte, që natën të kallnin datën me fëshfërimën e tyre. Le që ai edhe ditën druhej të kalonte përmes tyre vetëm. Kjo pjesë e kënetës s'dihet pse lidhej në kujtesën e tij me legjendat e ngjarjet e tmerrshme që kishte dëgjuar kur ishte fëmijë.

Por megjithëse nxitoi, atë e zuri nata tamain afër kallamishteve.

Atë pasdreke kishte rënë shi dhe qelli ishte ende i mbuluar me re të zeza, që lëviznin me

shpejtësi duke fshehur e duke nxjerrë një drapër hëne që po perëndonte. Nga këneta vinte një erë e keqe barishtesh të kalbëzuara dhe dëgjoheshin gjithfarë zérash e britmash të shpendëve të ujit. Ç'jehonë të çuditëshme nxirrnin ato zëra! Çukitjet e vazhdueshme të rosave të egra, klithmat e rosakëve, vikamat e piskave e të begaçinave, gagarisjet e patave dhe zërat e tjera të shpezëve të kënetës përziheshin njera me tjetrën dhe sikur shoqëronin fërshëllimën e erës së detit dhe fëshfëritjen e pandërprerë të kallamishteve.

Petro Zariku për t'i dhënë zemër vetes filloj të këndojë. Këndonte por mëndjen e kishte te fëmijët që e prisnin rrëth vatrës, te gruaja dhe sikur ndjente afshin e nxeh të të zjarrit të oxhakut që e priste.

Befas një klithmë çau ajrin kaqë afër sa atij filluan t'i gjëmojnë veshët. Ishte një britmë e hollë si e thirrur e ndonjë fëmije. Ai qëndroi në vend, mbajti frymën dhe vuri dorën në zemër sikur ta ndalonte që të mos i shqitej nga kraharori. Por britma u përsërit prapë, në ajër, disa hapa larg tij dhe ai shkriu e vuri buzën në gaz kur e kupto se ishte trembur kot, nga një begaçinë.

Tashti vazhdoi rrugën duke u futur mes përmes kallamishteve, vendit më të drojtur. Nuk këndonte më. Ndoshita pushoi këngën që të mos shqetësonte «qeniet e padukëshme», xhindet e shtrigat, që, në imagjinatën e tij, strehoheshin në atë vend të llatarshëm. Kështu në heshtje dëgjoheshin vetëm çapat e tij dhe herë pas here fëshfërimat e kallamave dhe britmat e zogje. Rënkimin që erdhi thellë nga këneta, ai as nuk e dë-

gjoi nē fillim, por pastaj mbajti vesh mirë, bile qëndroi nē vend. Po. Nga këneta vinte një rënkim i thellë, si grahmat e një njeriu që jep shpirt. Pastaj u dëgjua përplasja me zhurmë e një trupi të rëndë nē ujë dhe një fëshfërimë më e fortë e kallamave. Për një çast mendoi se dikush do të kishte ngecur nē kënetë dhe u mat të thërriste, por pastaj u kujtua se ato rënkime nuk dilnin nga fytì i njeriut. Atij iu dukën aqë të çuditëshme, aqë të huaja, sikur të vinin nga një botë tjetër! Dhe padashur zemra iu tkurr dhe filloi ta pushtojë një frikë e pashpjeguar. Pikërisht nē këtë çast një ulurimë e llahtarëshme çau ajrin e qelbur të kënetës dhe ai «pa» kallamat të përkulen gati pér të puthur tokën dhe «ndjeu» një afsh të nxeh të zjarr, që iu përplas nē fytyrë. Mbeti i ngrirë nē vend: donte të bërtiste, por nuk bërtiste dot, donte të vraponte, por nuk lëvizte dot. Zemra sa nuk i pushoi dhe u përplas nē tokë sikur e shtyu njeri pa pandehur. I llahtarisur vështronë kallamishtet dhe iu duk sikur «një gjë e zezë» si një re vigane po ngrihej nga këneta dhe po i afrohej ta përpinte. U mblohdh kruspull ashtu shtrirë siç ishte nē baltë. Pastaj, as ai nuk e kuptoi, se si e mori veten, eci një copë herë këmba doras, u ngrit nē këmbë, u rëzua prapë, u ngrit dhe filloi të vraponte, duke u penguar nepër plisa e shkurre dhe duke u rrëzuar herë pas here. Nuk ndaloi, por u përplas te dera e shtëpisë së vet dhe ra shakull, pa ndjenja, te praku i saj.

Kur erdhi nē vete pa t'ëmën që po i fërkonte

damarët dhe gruan e fëmijët e trembur përreth, që po e vështronin të shqetësuar.

— Ujë, ujë, më jepni ujë! — tha duke marrë frymë me zor.

E gëlltiti ujin e gotës duke e derdhur shumicën në kraharon.

— Ç'pate, bir' i nënës?

Si për t'i dhënë asaj përgjigje, nga këneta u dëgjua prapë ulurima.

— E dëgjon? E dëgjon? — klithi.

— Po, more bir, kemi qëkuri që po e dëgjojmë dhe nuk po e kuptojmë ç'është — tha ajo.

— Ah, ta dini, si kam shpëtuar! O zot, si kam shpëtuar! — bërtiti Petrua duke vështruar me sy të zgurdulluar diku në tavan, dhe pa shtuar asnijë fjalë përnjëherësh mbuloi kryet me jorgan.

Atë britmë e dëgjuan të gjithë fshatarët, që banojnë rreth kënetës. Edhe ata nuk e shpjeguan dot këtë klithmë të çuditëshme. Kalamajtë, duke vështruar prindërit, u rrasën të frikësuar fort pranë njeri tjebrit në të shtruarat. Dikush për t'i dhënë zemër vetes e të tjerëve u mundua ta kalojë lehtë duke thënë se duhet të ishte ndonjë buall i ngecur në baltë, por prap as ai vetë nuk ishte i bindur. Pleqtë ranë në mendime dhe nuk e thanë dot fjalën e tyre sepse kishin frikë mos i tallnin të rintjtë, por edhe të rintjtë nuk e shpjegonin dot, sepse nuk e kishin dëgjuar kurrë një britmë të tillë.

Të nesërmen burrat e fshatit, para se të nisnin punën nuk kishin bisedë tjeter. Secili shfaqi mendimin e tij. Dikush tha se mos kish qenë ndonjë dosë që ishte mbytur në baltë, tjetri e bëri gomar që pëlliste, një i tretë tha se duhet

të ishte viç. Kur erdhi Petrua, puna u ngatërrua keq:

— Jo, shokë, — tha ai. — Unë e pashë me sytë e mi që s'ishte as dosë, as gomar, as viç. Mbrëmë kam shpëtar për një qime. Po vija natën në shtëpi, si zakonisht, kur dëgjoj një si rënkim të thellë. Ndalova, që të mbaja vesh kur nga kallamishtet u ngrit një gjë e zezë sa një bina dhe lëshoi atë britmën e frikëshme, që keni dëgjuar. Nuk isha as dhjetë metra larg dhe pashë me sytë e mi si u përkulën kallamat nga frima e saj që ishte kaq e fortë, sa më rëzoi edhe mua për tokë! Unë e di si kam shpëtar mbrëmë.

Të rinjtë qeshën dhe dikush e pyeti me qesëndi:

— E çfarë ishte?

— Sigurisht ndonjë kuçedër — u përgjegj në vend të Petros një i ri dhe ja plasi gazit.

— Të janë bërë kallamishtet kuçedër nga frika — shtoi prapë një tjetër.

Dhe ata nuk e pushuan gazin.

Po pleqtë u vrenjtën. Ata as nuk qeshën si të rinjtë as nuk thanë gjë, vetëm tundën kokën.

Me t'u ngrysur filluan të dëgjoheshin prapë rënkimet e britmat, herë më larg e herë më afër. Po kështu edhe të nesërmen dhe të pasnesërmen. Fshatarët rrëth e qark kënetës as nuk prisnin të ngrysej mirë, por pa u errur mblidhnin bagëtinë e i vinin llozin shtëpisë. Asnjeri nuk bariste tash-ti natën. Edhe të rinjtë i pushuan shakatë. Ata i dëgjuan me vemëndje disa herë këto britma dhe nuk mund të shpiegonin se cfarë kafshe ishte. Këto klithma e vikama të frikëshme ishin të pa-njohura për ta. Por tashti që as të rinjtë, me

shkencën e tyre, nuk dhanë dot shpjegime, u erdhi radha pleqve ta «sqaronin» dhe ata filluan të tregojnë përsëri përrallat e legjendat e harruara. Më plaku i tyre, Kozma Nasi, duke i nxjerrë fjalët dalëngadalë si me darë tha i menduar:

— Më dëgjoni mua: ai éshtë Bualli i Kënetës. Ai që ka jetuar gjithmonë në fund të kënetës. Ju po e thani kënetën, prandaj ka dalë. Kjo éshtë shenjë e keqe. Kam frikë se do të na bëjë ndonjë hata! Më dëgjoni mua!

Disa të rinj u tallën me këto budallallëqe, por të nesërmen fshatarët nuk i afroheshin më kënetës as ditën. Madje edhe peshkatarët nuk shkuan më të gjuanin. Ata gjetën si shkak mëmetimin e rrjetave dhe nuk u tundën fare nga vendi. Pastaj dikush u ankua se i kishte humbur një derr, një tjetër se nuk i kishte ardhur zagarri në shtëpi, dhe një i tretë dha alarmin se i kishte humbur kau. Të gjitha këto humbje nuk mund të shpjegoheshin veçse me Buallin e Kënetës që i kishte përpirë.

Bardhyl Leka, sekretar i rinisë së fshatit, vendlisi ta sqaronte këtë çështje, sepse, mendoi, më mirë të ndizte një qiri sa të mallkonte errësirën. Ai nuk i besonte përrallat e pleqve për buallin e kënetës, por prap nuk ishte në gjendje ta shpjegonte se çfarë kafshe ishte ajo që kishte tmerruar fshatarët me britmat e saj. Nga të gjitha kafshët që njihte, asnjera nuk kishte atë zë. Puna më e mirë mendoi, éshtë të kontrollohej kënetëta dhe të vritej kafsha. Por gjahtarët e fshatit ato ditë kishin humbur. Ata gjuanin rosa në grykën e lomit apo fare në breg të detit, shumë larg vendit ku ishte dukur kafsha e panjohur.

Prandaj ai kërkoi ndihmën e shoqërisë së gjuetarëve të qytetit, e cila të nesërmen u dërgoi një skuadër gjahtarësh të zgjedhur si kokrat e qershishë nga më të mirët. Në krye të saj ishte Avni Ballgjini, një burrë i gjatë e nishanxhi i dëgjuar. Ata u grumbulluan në shtëpinë e Kozma Nasit që i priti me gjela deti.

Duke pirë raki rreth oxhakut, ata bënë planin si ta rrethonin kënetën.

— Më dëgjoni mua — u thosh Kozma Nasi.  
— E keni kot. Është Bualli i Kënetës. Ai as nuk kapet as nuk vritet. Do të mirrni veten më qafë.

— Lëna rehat me këto përralla, o xhaxho, — i tha Avniu dhe duke u kthyer nga shokët vazhdoi: — Unë mendoj, shokë, ta rrethojmë vendin dhe me të filluar britmat, t'i afrohemë nga të gjitha anët dhe ta vrasim.

— Mirë po na duhen nja dy varka dhe thonë se varkat e peshkatarëve janë shpuar.

— Atë e rregullojmë. Unë po shkoj me një varkë. Kush po shkon me tjetrën?

— Unë — tha Mihali një gjahtar i vjetër.

— Ja pra, tha Avniu, ju rendituni në buzë të kënetës dhe ne po vemi me varkë nga të dy anët. Sonte duhet ta sqarojmë këtë punë.

— A s'ka mundësi ta bëjmë nesër, ditën? — pyeti dikush.

— Jo. Ditën ajo shkon në det, prandaj duhet ta bëjmë sonte.

— More më dëgjoni mua, u hodh prap Kozmai — është Bualli i Kënetës. Nuk e vrissni dot...

Atë ditë në të errur ata u reshtuan buzë kënetës. Avniu u hodh në varkë, por varkëtari që

ishte me tē, diçka ngatërronte nē fund tē saj du-  
ke hequr ujin me kovë.

Bardhyl Leka me dy tē rinv ndezi zjarr nē buzë  
tē kënetës dhe ndehu duart pér t'u ngrohur.

Binte një shi i hollë.

Nata erdhi ngadalë. Zhurmat nē kënetë fi-  
lluan tē qetësohen. Sipër gjahtarëve fluturonin  
rosat. Herë herë çafkat lëshonin britmat e tyre  
tē holla. Tē gjithë prisin me ankth nē vendet e  
tyre tridhjetë metra larg njeri tjetrit. Dikush  
nga padurimi ndizte e shuante cigaren. Një tjetër  
ndronte e shndronte fishekët e çiftes, kurse një  
i tretë dridhej nga tē ftohtit. Herë pas here ata  
u fërshëllenin njeri tjetrit.

Një fllad i lehtë filloj tē fryjë e tē lëvizë  
kallamishtet. Nga kënetë erdhi një erë e keqe  
pastaj u dëgjua një rënkim e nuk shkoi shumë e  
britma e tmerrshme, po ajo britmë që kishte  
llahtarisor fshatarët, çau ajrin.

Bardhyl Leka, po priste tē dëgjonte tē shtë-  
nat e çifteve kur pér çudi vuri re se gjithë gjah-  
tarët u gjëndën rrëth e përqark zjarrit.

— E dëgjuat? — pyeti njeri.

— E dëgjuat? — ja pat tjetri.

— More, ç'qenka kjo kështu?!

— Jo. Kjo nuk është kafshë.

— Ec tē ikim. S'është punë pér ne!

Avni Ballgjini ishte duke shtyrë barkën, kur  
dëgjoi britmën. Pa dashur u drodh dhe i hyri një  
frikë që s'e kish ndjerë kurrë më parë. Megjitha-  
të ai nuk u tërhoq.

— Nise! — e urdhëroi shokun e vet, një  
peshkatar që kishte marrë përsipër tē voziste.

— Por barka nuk u nis.

— Nise! — i bërtiti.

— È si ta nis? — A nuk e sheh se èshtë mbushur plot me ujë? — u ankua peshkatari duke iu dredhur zëri. — S'kemi g'bëjmë, shoku Avni, kthehemë.

— A s'ka mundësi ta hiqni ujët?

— Jo. Varka èshtë shpuar — gënjeu tjetri.

Avni Ballgjini mallkoi, shau nëpër dhëmbë e doli në breg. Në të vërtetë ai ishte i gjëzuar që gjeti një arësyte të fortë për t'u têrhequr nga kjo punë.

Pranë zjarrit u bërtiti shokëve:

— Po ju, pse jeni grumbulluar këtu? Pse kini lënë vendet e caktuara?

Asnjeri nuk u përgjigj.

— Po Mihali, ku èshtë?

Prapë heshtje. Disa ngritën supet.

Një rënkim filloj të vinte nga këneta, pastaj britma dhe papritur një krismë pushke dhe një thirrje e zgjatur e një njeriu të trembur. Një përplasje e menjëherëshme e një trupi në ujë dhe pastaj pllaq e plluqet e një diçkaje që lëviz në kënetë drejt bregut.

— Ajo èshtë — tha njeri nga gjahtarët. — Po vjen drejt nesh!

— Të ikim, o burra!

Dhe papritur njeri tjetrin ata ja dhanë vrapijt në rëmujë, drejt fshatit. Vetëm Bardhyl Leka dhe Avniu qëndruan.

— Ku shkoni, more të marrë, qëndroni! — bërtiste Avniu, ndërsa Bardhyli thërriste gjahtarë që mungonte:

— Mihal, O Mihal!

Në shtëpinë e xha Kozmait gjahtarët, rrëth

e qark zjarrit, diskutonin si tē verbërit, që bise-dojnë pér ngjyrat:

— U thashë, o burra, nuk keni ç'i bëni: është Bualli i Kënetës. Na dëgjoni edhe ne pleqve pér këto punë — thoshte Kozmai.

— A e pe si u ngrit nga këneta si një re e zezë. More se çfarë hata që ishte — tha njeri nga gjahtarët.

— Po flakën që lëshoi nga goja, nuk e vu-të re?!

— Ju thashë, është kuçedër — ja pat njeri.

— Përralla! Duhet tē jetë ndonjë kafshë që nuk e njohim.

— E ku ka kafshë tē panjohura sot, sidomos në anët tonë?

— Kushedi.

— Dëgjoni se ç'ka ndodhur andej nga Dhërmiu para pesë-gjashtë vjetësh në kohën e fashizmit: Na ishte një bari që ruante lopët fare në buzë tē detit. Një natë dëgjon një britmë tē tmerrshme dhe fshihet pas një guri. Edhe lloët u mblohdhën grumbull në mes tē livadhit. Kur nga fundi i detit del një buall i madh, i bardhë krejt, si borë. Sa doli në breg lëshoi një britmë sa që tundi dheun, e dallgët filluan tē ngrihen tē dall-disura, kurse një çast më parë deti ishte fare i getë.

— Po pastaj ç'u bë?

— As pa më tutje bariu, po ja dha vravit e në katund. Vetëm tē nesërmen pa se i mungonte një lopë.

— Më dëgjoni mua. Është Bualli i Kënetës

— përsëriti Kozmai.

— Eh çfarë paska kjo dynjal!

Dikush trokiti.

Hyri Mihali krejt i lagur. Pas tij një burrë i thatë, varkëtari, edhe ai i lagur, dhe në fund Avniu me Bardhylin.

— Zjarr, o burra, se vdiqëm!  
— Hapni vend këtu.  
Të porsaardhurit zunë vend afër zjarrit dhe Mihali me varkëtarin filluan të thanin rrobat.

— Cfarë ndodhi?  
— Lere se ç'na panë sytë sonte! — tha var-këtari.

— Ti shtive?  
— Unë — u përgjegj Mihali.  
— Epo ç'ndodhi?  
— As unë nuk e di.  
— Pa na trego.  
— Ja. Sa dëgjova rënkinin, i thashë Leksit ta nisi varkën. Ky i uruar e nisi por jo në drejtimin e zërit, po në të kundërtën. More ç'bën kësh-tu? — i thashë kurse ky jepu remave.  
— Ehe, pse budalla më bëre ti mua? Ti vete kuçedrës në gojë! — ja priti Leksi duke ndehur këmishën për ta tharë.

— E, që thoni ju, po i afroheshim bregut, kur na vjen prapa një si re e zezë. Ne ikë, ajo pas. U bëmë njësh me varkën. Atëhere shtiva. Leksi lëshoi një britmë, u mënjanua dhe e përmbyssi varkën e ramë të dy në kënetë. Shyqyr që nuk kishte shumë ujë se do të ishim mbytur. Mezi kemi dalë, ja, siç na shihni.

— Po c'ishte, vallë?  
— Djalli e di se ç'është.  
— Është kuçedër — tha Leksi dhe papritur murmuriti me zë të ulët me vete: — O zot, o

Shënmëri, shyqyr që shpëtova, për ata kalama-qër njëherë! — E që thoni ju, shokë, — vazhdoi duke ngritur zërin, — flakë nxirrte nga goja! I kishte sytë sa një rrotë maqine, gojën e hapur sa një derë furri, dhëmbët me kanxha si plugje traktori! Sa gjë e llahtarëshme! Na shpëtoi zoti sonte!

— Më duket se po flet kuturu, po i zmadhon gjërat.

— Ashtu thua ti se s'ishe aty, po të ishe!... Sidoqoftë unë me këtë punë nuk merrem më.

— As unë. Ta dinim se ç'ishte, hajde de, po as nuk e dimë se me çfarë kemi të bëjmë.

— Të lajmërojmë Tiranën. Vetëm ata të qendrës mund ta zgjidhin — propozoi dikush.

— E ç'do t'i bëjnë ata?

— Ama ç'pyetje! Ata kanë më shumë kompetencia.

— Bëni ç'të doni.

— Unë mendoj të lajmërojmë kryesinë e shoqërisë së gjahtarëve — shtoi një tjetër.

— E ç't'u themi?

— T'u themi se ka ardhur një kafshë e panjohur deri më sot.

— More më dëgjoni mua. Është Bualli i Kënetës — përsëriti Kozmai.

— Është kuqedër — tha Leksi.

— Dragua, them unë!

— Mos more! — u tall Avniu.

— Çfarëdoqoftë është diçka e panjohur dhe e panjohura gjithmonë të kall frikën — tha një gjahtar.

— Këtu ke të drejtë. Ja ç'më ka ndodhur

mua kur isha ushtar — tha Mihali. — Shkoja përtë shpënë një letër në komandë. Më zuri nata në mal. Gjeta një vend të sheshtë dhe thashë të flija pak. Sa u shtriva, vura rë se ndodhesha si-për një varri dhe rrëth e përqark varre të tjerë. Ta dini si m'u drodh zemra! E dija se të vdekurit nuk ngrihen nga varri, dhe nuk besoja as atëherë lugetër, por do ti se s'më zinte gjumi. Pa më hipi pastaj një frikë e madhe e po dridhesha i téri. Nuk durova dot dhe u nisa. Ke parë ti, të jesh i sigurt se nga të vdekurit nuk të gjen gjë dhe prap të kesh frikë!

— Edhe mua kështu më ka ndodhur një herë — u hodh një gjahtar i vjetër. — Isha i vogël atëherë dhe punoja me karvan rrugën e Korçës, pas babait tim. Një herë na zuri nata afër varrezave. Lidhëm kuajt aty pranë dhe ramë. Sa pa na zënë gjumi dëgjojmë rënkime: hëm... Hëm... Hëm!... Bobo, thamë, u ngjallën të vdekurit, dhe o burra kush të ikë më parë. Mirëpo harruam të zgjonim një shokun tonë. Po pse kishte burrë të kthehej prapë e ta zgjonte! Atëherë filluam ta thërrisnim dhe ta gjuanim me gurë. Mirëpo ai flinte top! Gërhiste sikur ishte në dyshek. Kur ja dhamë me popël kokës, u zgjua duke thirrur e duke sharë. —

More lere se kush të ra, i bërtitëm, po çohu se të zuri lugati! — Ai sa dëgjoi rënkimet u hodh përpjetë, dhe ashtu siç ishte, ja dha vrapi duke u penguar e rëzuar nëpër varre... Kur vajtëm të nesërmen, q'të shihnim! Aty afër na paskej qenë një viç i lidhur!...

Me kësi përrallash ata e gdhinë atë natë dhe të nesërmen secili shkoi në punë të vet.

Misteri i kënetës mbeti i pasqaruar. Tashti filluan të hapen lloj lloj shpjegimesh sepse errësira bëhet më e thellë kur shuhet drita. Shoqëria e gjahtarëve të Tiranës mori disa telegrame urgjente për të organizuar ekspedita që të sqarononte punën. Dikush i shkroi një relacion Institutit të Shkencave dhe disa bënë propozime që të lajmëronin ndonjë repart të ushtrisë për ta rrethuar kënetën e për ta rahur me top!

Ndërkojë njerëzit mbylleshin herët nëpër shtëpia. Peshkatarët nuk gjuanin më dhe të gjithë i shmangeshin rrugës buzë kënetës jo vetëm natën, por edhe ditën.

Bardhyl Leka, sekretar i rinisë së fshatit rrinte si më gjëmba. Atij i vinte turp dhe hante veten me dhëmbë që nuk e kishte çuar deri në fund e nuk e kishte sqaruar punën e kafshës së kënetës. Ai nuk besonte as përrallat as legjendat, që po thurrejshin tashti rreth kësaj kafshe të panjohur. Ai e dinte se njerëzit gjithmonë kanë pasur frikë nga errësira dhe i janë trembur së panjohurës, por errësira nuk është gjë tjetër veçse mungesë e drithës dhe e panjohura mungesë e dijes. Për të çarë errësirën e për të zbuluar të panjohurën, duhet në radhë të parë të mposhtet frika, që paralizon mëndjen dhe dobëson vullnetin. Kur njerëzit nuk e arrijnë dot këtë, shpikin e trillojnë gjithëfarë legjendash e besime të kota për t'u justifikuar. Ja edhe tashti jo vetëm po përsëriteshin legjendat e vjetra, por po trillcheshin edhe të reja. Ai sa nuk tërbohej kur i dëgjonte këto dhe e ndjente veten fajtor. «Jo, thoshte me vete, tek ne këto nuk duhet të kenë jetë të

gjatë. Bashkë me kënetat ne duhet të zhdukim edhe legjenda të tillë»

Prandaj ai e vendosi dhe duke marrë me vete katër të rinj, shokë të tij, iu fut vetë kënetës, këtë radhi i vendosur që ja ta vriste kafshën e panjohur e të svaronte këtë mister, ja të humbisë fare.

Prandaj ende pa u gdhirë u fut i pari në kënetë, duke i hipur varkës së Mihalit, pikërisht asaj varke, që ishte përbysur atë natë dhe asnjeri nuk ishte kujtuar ta kthente mbarë. Ai hyri thellë në kallamishtet duke vozitur me kujdes, kur papritur disa hapa para tij u duk një kafshë e madhe e zezë, që mezi lëvizte, duke hapur rrugën me këmbët e saj të vogla si lopatë. U kujtua në çast se e kishte parë diku në një libër këtë lloj foke apo luan deti, por nuk e vrau mëridjen ta caktonte se çfarë ishte. Pa humbur kohë i zbrazi të dy grykat e çiftes duke shënuar kafshën drejt e në kokë. Pastaj u hodh nga varka në ujin e cekët të kënetës, rrëmbeu lopatën dhe e goditi disa herë kafshën që po përpëlitech. Si e pa që kafsha s'po lëvizte më, thërriti shokët. Ata e nxo rrën me vështirësi në breg kafshën e vrarë.

Disa fshatarë u grumbulluan rreth saj duke e vështruar me kureshtje. Ndërmjet tyre Kozma Nasi, plaku i moçëm që ngulte këmbë pér Buallin e Kënetës.

— More, sa e madhe qënka! Ke parë ndonjëherë kafshë të tillë?

— Kurrë! Unë nuk marr vesh, kafshë apo peshk është?

— Trupin e paska si të peshkut por kokën... Edhe Kozma Nazi vështronë i habitur.

— E xha Kozma, — tha Bardhyli me të qe-shur, — ta vramë Buallin e Kënetës!

Ai tundi kokën dhe tha me zë të ulët:

— E vratë!

Dhe vazhdoi të tundë kokën sikur po shkundëte legjendat dhe bestytnitë, që kishte grumbulluar në të,

## BISHTUKU

Shumë njerëz i thonë kandil. Shumë të tjerë kanë filluar ta harrojnë këtë emër, kurse ka akoma që i thonë bishtuk. Unë do ta quaj bishtuk, sepse më pëlqen që ka si nënë fjalën bisht dhe sepse vetë Hasani plak, i biri i Demir Qurkut, e quante bishtuk. Të dy, si Hasani dhe bishtuku kanë kohë që rrinë karshi njeri tjetrit, por si këtë natë ata s'kanë ndenjur kurrë. Dhe nata është shumë e gjatë. Ajo u ngrys që sapo perëndoi dielli pas shkëmbinje të bardhë, dhe s'ka të aguar. S'ka asnjë shenjë mëngjezi. Bishtuku rri në këmbë, si qiri i zi, e djeg një flakëzë të vockël sa një gjuhë rabecke dhe ndriçon. Ndriçon vetëm të zotin që ka përballë, duke ja zmadhuar hijen trifish në murin e bardhë të porsa lyer. Tymi që lëshon bishtuku dhe era që lëshojnë ende muret e lyera me gëlqere e turbullojnë më shumë Hasanin dhe ja zbojnë nga trutë e lodhura edhe atë pikëz gjumë që mund t'i vijë. Hasani s'duron dot më. Ngrihet ngadalë, me zor hap dritharen e vogël dhe mundohet të vështrojë përjashta natën pa fund. Ajo shtrihet e plotë dhe si e përjetëshme. Sytë e Hasanit nuk dallojnë asgjë

përveç errësirës. Ai mbush bulçitë dhe si nxjeri një gëlbazë nga goja, si gëlbazë bishtuku, pësh-tyn gjithë inat përjashta, si të pështynte në surrat natën e zezë. Pastaj e fut kokën brenda dhe sheh bishtukun, tymin e tij të ri e të hollë, si bisht miu që ngjitet përpjetë duke u luhatur. Ai luhatet sa herë që i zoti kolliitet ose flet me zë, me veten e tij, apo me bishtukun.

... «Kjo është nata jote e fundit, o bishtuk», foli plaku dhe ngriti kokën përpjetë, në tavan vështroi varur llambën elektrike që reflektonte sa një xixëllojë dritën e bishtukut.

«Nesër do të ndriçosh, moj llambë elektrike», — i foli Hasani llambës duke e vështruar, dhe përsëri u ngrit në këmbë, erdhi rrrotull nëpër dhomë, dhe shfryu dufin që e mundonte.

«Më turpërove, moj çupë. Unë të desha si dritën e syve, kurse ti më turpërove. O q'natë e keqe! Sonte do të ishte dasma jote, sonte do të qmëndej i tërë fisi ynë. Sonte do të bëhej dasma e fundit e kësaj shtëpie. Ti e dije që plaku yt ty të kish të vetme, apo nuk e dije?» pyeti plaku duke iu drejtuar bishtukut dhe heshti.

Dikush ecte në gur, rëposh konakut, kur ai po fliste me veten e vet. Plaku mbajti vesh dhe njobu hapat e së shoqes që po ngjiste shkallët. Pas pak ajo hyri brenda duke mbajtur në dorë një bishtuk, që i ndriçonte vetëm fytyrën.

— Mjaft më, bjerë e fli, — tha plaka.

— S'më flihet.

— Atëhere rri, po të paktën shuaje bishtukun. I tërë fshati të sheh që rri e vuan. Drita e bishtukut duket gjer matanë lumit.

— Le të duket, nesër ky s'do të ndriçojë më.

Ata ç'po bëjnë. Po flenë? — pyeti plaku për të ndërruar muhabet.

— Flenë. U lodhën gjithë ditën e tashti flenë.

— Në mëngjez dua të flas me ta.

— E ç'punë ke ti me ta. Ata s'kanë faj. Erdhën për të vënë dritat. S'i ke as krushq, as dasmorë. Ata janë punëtorë. I ka dërguar N.I.S.H. Elektriku i Elbasanit. Gjithë ditën majë shtyllave lidhin tela. Thonë se po t'i zesh me dorë ata tele, vdes në vend. As ciu, as miu s'bën.

— O, ç'vdekje e bukur! — psherëtiu plaku.

— Ptu, lanet, — mallkoi gruaja, — Kjo natë të paska çmendur fare!

— E si të mos më çmendë, kush e mban gjithë këtë turp!

— Turp, turp, vërtet, — tha nëpër dhëmbë plaka dhe zgjati dorën që mbante bishtukun, e zgjati përpara sa ndriçoi errësirën dhe hodhi një hap me kujdes, pastaj një tjetër, sepse bish-tuku nuk ndriçonte më tej. Në çdo hap që bënte lëkundej dhe plaku shihte përtej derës se si në koridorin e gjatë të shtëpisë largohej dalngada-lë e shoqja. Sa herë që ajo bënte një hap lëku-ndej dhe drita e bishtukut.

«Do mundohem të fle», — tha plaku dhe u shtri, po bishtukun nuk e shoi: «Le të ndriçojë dhe sonte, e ka për të fundit herë».

Ndonëse i mbylli sytë dhe ndonëse mundo-hej të ndillte gjumin, plaku nuk fjeti. Atij i dil-te gjithmonë parasysh e bija dhe pa dashje rikujtoi me radhë shtatëmbëdhjetë vjetët e Zafirës.

Ajo erdhi në këtë botë më 1950 dhe u përshëndet gabimisht më një të shtënë dyfeku, që nga dritarja e vogël. Që kur lindi ajo e turpëroi tanë. Gratë ja sollën gabim lajmin dhe Hasani, që po i digjej shpirti për një djalë të pleqërisë, s'priti po dha kushtrimin nga dritarja e vogël e konakut. Kur hyri në dhomë mamia e fshatit dhe e uroi për vajzën, Hasani u zbe.

— Ç'u turpërova, — tha dhe flaku tej pushkën.

Mamia u mundua ta qetësonte, po ishte e kotë. Ai kishte shtënë me pushkë dhe të gjithë ata që e kishin dëgjuar atë krismë nga kulla e tij e kishin marrë me mend se ç'kish lindur në shtëpinë e Hasanit, kurse...

— Po ja, ku i ke dy djemtë, që mburreresh? — ndërhyri përsëri mamia për ta qetësuar, — Njëri në Cërrik tjetri në ushtri. As njërin e as tjetrin s'i ke në shtëpi. T'i morën edhe nuset dhe të vinë rallë e përmall.

— Ashtu është, moj bijë, ashtu është; edhe kjo do të ketë kësметin e saj. Po e desha një djalë për pleqëri. Pastaj vajta dhe qita pushkë si i çmendur.

— Hajt mos u turpëro kot, kur të rritet edhe ajo do të qesi pushkë, mbase edhe më mirë se ti...

... Zafira filloi të rritet. Të atit i dukej sikur ajo rritej e dobët dhe shëndetkeqe. Dalngadalë në shpirt të tet filloi të rëndoja vështrimi i trembur i së bijës. Ajo ishte bërë katërmbehjetë vjeçë. Kishte mbaruar shtatëvjeçaren,

Kishte mësuar të bënte dhe punët e shtëpisë, po kokën kurrë s'e kishte ngritur. Tamam në moshën, kur duhet të shpërthente ishte vyshkur. Sytë e saj të kaltër dukeshin të fjetur si një gjol i mbuluar me barishte e shkurre. I ati e shikonte dhe bënte çudi. Ai pandehte se e bija do të çelej dhe do të gëzohej kur t'i thonin të bëhej gati për dasmën. Dhe i thanë një ditë. Ajo nuk u çudit. Sytë e saj s'lëvizën fare. As u çellën, as u ngrysën. Ajo e dinte, bile e dinte me hollësi se si ish lidhur fati i saj me një fëmijë që kish qarë një natë të egër dimëri se qe trembur nga fjalët që thuheshin me zë të lartë prej miqve të largët në konakun e ndarë me gardh e baltë. Ajo, që kur e mësoi, ndjeu t'i hyjë në gjoksin e njomë gjithë ai dimër i egër që e mbajti të mbyllur tanë dy ditë e dy net. Gjithë ai dimër me borë, i futur me zor në zemrën e saj nga zakoni i lashtë, e thau atë dhe gjithë uji i turbullt i lumit ja errësoi ndricimin e syve të kaltër. Në çdo hap që bënte, Zafira ndjente se kishte përpara një lumë dhe rrëth e qark një dimër. Këto ndjenja ja zvogëluan asaj botën e madhe dhe qielin e gjerë me yje. Ajo u rrit e fejuar, e veçuar nga shokët e shoqet e saj.

«Ti je grua, ti ke një burrë, s'të ka lezet të lozësh rrugës», këto fjalë ajo i dëgjonte shpesh. Këto fjalë përbënин botën e saj fëminore, e cilë i kaloi pa lënë gjurmë. Dhe ja, tashti ajo është vajzë e rritur, punon në arë me shat, mbush ujë në krua dhe vështron rrëth e rrotull. Vështron se si përtëritet natyra buzë prillit, se si, ndriçojnë yjet në netët e qershorit kur kositet bari dhe se si këndojnë shokët e shoqet e

shkollës së saj. Shikon se si disa prej tyre ndahen dy e nga dy e humbin buzë lumit ku shushërojnë shelgjet e ndriçojnë xixëllonjat. I shikon, po gjë nuk ndjen. Zemra e saj sikur është tharë. Një herë ajo guxoi dhe mendoi një minutë të vetme për Xhelon. Ai i kërkoi ujë dhe ajo i dha. Ai e ngriti shtambën drejt diellit, piu dhe u lag, pastaj e vuri vetë në krua dhe kur ena u mbush, u ngrit dhe ja vuri asaj në kokë. Ja vu-ri me duart e tij dhe duke buzëqeshur, sikur t'i vinte një kurorë me lule thane dhe jo një shtambë dhjetë kilshe, Zafira donte të ngrinte kokën, së paku të shihte edhe një herë buzëqeshjen e tij, po shtamba s'e la të lëvizte. Qafa e saj e hollë sikur i qe gozhduar në supin e saj të brishtë. Natën ajo e pa në ëndërr. Të nesërmen syt e saj u hapën dhe kishin në bebe një rreze drite.

— Mirëmëngjez, — i tha ajo tet.

— Mirëmëngjez, — mërmëriti ai dhe vuri re vajzën. Aty për aty u mat t'i thoshte së bijës diçka, po u praps. Desh të bënte me të një shaka, desh t'i kujtonte të fejuarin, po s'i tha gjë. Zafira u largua dhe gjithë atë ditë priste me pardurim kohën e drekës që të vinte në krua vër ujë. Vajti, mbushi shtambën dhe priti. Në krua s'kish njeri. Mos vallë kishte ardhur shumë shpejt?

— Nuk po e ngre dot? — dëgjoi ajo t'i flasin dhe si e trembur ktheu kokën, po s'u përgjegj. U skuq dhe uli sytë. Ishte ai, Xhelua, shoku i saj.

— Pse s'flet, — vazhdoi ai, — ti sikur s'je nga kjo kooperativë!

Zafira ngriti kokën dhe e pa në sy. Një çast të vetëm. Xhelua u hutua nga vështrimi i saj i etur dhe mbeti. Ajo iku.

— Mirëmbërëma, — i tha ajo tet kur ai u kthyte në shtëpi.

— Bushtër, — i shfryu i ati. — Të pash edhe një herë me të, ta këputa kokën!

Dhe ajo s'guxoi më të mendonte për Xhelon. Ajo ishte e fejuar.

... «Bushtër» shfryu plaku që kishte më se një gjysëm ore që ishte ngritur e që iu kujtuan thash e themet mbi të bijën dhe Xhelon. «Bushtra» shfryu përsëri dhe vuri re se si u luhat flaka e tymi i bishtukut. U dëgjua një fishkëllimë.

Plaku hapi sytë, mbajti vesh dhe u bind. Ishte fishkëllima e largët e trenit të punës që dilte nga tuneli.

Fyyyy! Fy, fy! Fyyyy!...

«Baba! — ju bë Hasanit sikur dëgjoi zérin e Zafirës. — Unë do të shkoj në hekurudhë. Dje e shkrova emrin...»

Dhe ajo qe nisur me shoqet e sai. Në radhë, midis tyre, asaj i qe dukur sikur po shkonte përsëri në shkollë, sikur tashti po hynte në botën e saj të perënduar të fëminisë.

Treni fishkëlloi edhe një herë dhe Hasan ë dëgjoi fare qartë, si një gjëmim, zhurmën e thellë të rrötave të hekurit mbi shinat e hekurta. Pas saj, ajo u shua, veshi i plakut ndjeu zhurmën e qetë e shekullore të rrjedhjes së lumiit dhe iu kujtua postjeri i kooperativës që bënte 400 ditë pune në vit duke shpërndarë gazetat e duke i rënë cyles. Postjeri ecte që nga mëngjesi

deri në darkë. Kalonte në të gjitha fshatrat e kooperativës dhe, që të mos mërzitez, i binte cyles.

...Atë ditë, apo kish hyrë shkurti, ai solli gazeten dhe iku pa qëndruar as edhe një minutë. Ishin në oborr. Sapo kishin mbyllur gjënë e gjallë, kur erdhi gazeta. Zafira e mori dhe nisi ta lexojë, në fillim me zë të lartë që ta dëgjonte dhe i ati bashkë me tëmën, pastaj dalngadalë e uli zërin. Ai vuri re se si sytë e së bijës u zmadhu-an dhe filluan të feksin tamam si feksin yjet. Ajo e uli edhe më zërin dhe u zbe. I ati u tremb.

— Ç'është, — pyeti ai kureshtar.

— Asgjë, — pëshpëriti Zafira dhe u largua.

Ra nata, po këtë radhë jo si çdo natë. Zafira përsëri u largua dhe mori me vete bishtukun.

— Po kjo ç'ka, — pyeti Hasani të shoqen.

Plaka mbloindi supet, kurse Zafira, e ulur në shkallën e fundit pranë derës së gurit dhe, nën dritën e bishtukut lexoi deri në fund gazetën.

Pas pak ajo ngriti kokën e trëmbur. E ëma, me një bishtuk në dorë, po zbriste shkallët. Bishtuku i ndriçonte vetëm fytyrën dhe shaminë e kokës. Të dyja, nënë e bijë, u ulën dhe qëndruan kokë më kokë. Zafira nisi përsëri të lexonte!

Dy bishtukë pranë këmbëve digjeshin nga-dalë. Përballë tyre, në qyr,<sup>1)</sup> lëvizte gjëja e gjallë.

Pas pak, dy gratë kthyen krvet të trembu-ra dhe panë sipër tyre mbi shkallë, bishtukun e

1) qyr — vend ku mbahet bagëtia .

tretë që kishte ajo shtëpi. Atë e mbante me dorën të shtrirë përpara Hasan Qurku.

Plaku i shtëpisë qëndronte në shkallën e parë të çardhakut. Pak i përkultur përpara dhe gjysëm i ndriçuar nga bishtuku, ai dukej si një copë shkëmb që do të rrukullisej.

— Ngrihuni dhe bini të flini! — u foli ai grave.

Për çudi, në vend të plakës, u përgjegj Zafira.

— Mirë, tatë, tashti do të biem.

Plaka shikoi çupën në sy dhe s'e njohu. Syt e saj ndriçonin çuditërisht si të kishin pasë marrë dritë nga gjithë ato fjalë që kishte lexuar nën dritën e dobët të bishtukut, pranë derës së qurit.

Të dyja dëgjuan në heshtje se si u zvarri-sën këmbët e plakut gjer sa ai hyri në konak.

— Lexoje, bijë, dhe u bëftë ashtu si thonë këto fjalë, që të hyjnë në zemër.

— Do të bëhet kështu siç thotë ky fjalim, po jo me frymën e shenjtë, po me luftën që do të bëjmë ne vetë, me përkrahjen që do të na jepë organizata.

— Ashtu qoftë!

— Ah, moj nënë, si ke duruar ti? — pshëritiu Zafira dhe ndjeu t'i përloten sytë.

E ëma nuk foli. Dhe Zafira heshti dhe ndjeu se s'ishte vetëm bijë e saj, po shoqe e saj. Kjo ndjenjë e re i erdhi kaq papritur dhe e emocionoi kaq shumë sa e shtrëngoi fort tëmën pas vetes dhe qau.

— Jeta jonë s'do të jetë më siç ka qënë, unë këtë gjë tashti e ndjej në shpirt.

— Ashtu qoftë, veç ruaju, të pastë nëna. Ti je bija ime, po ti s'na përket më neve. Ti e di që je e...

Zafira ja zuri gojën sëmës me dorën e saj dhe u ngrit e ngjiti shkallët si flutur.

Të nesërmen, të pasnesërmen dhe gjer në ditën që ajo u nis për në hekurudhë, Hasan Qurku bënte çudi me të bijën dhe të shqoqen. Në shtëpi nuk kishte qetësi. Gratë që gjer dje kishin patur secila mëndjen dhe huget e veta, tashti ishin bërë një. Plaku nuk e duronte dot këtë unitet dhe shpesh xhindosej. Ai ndenji rehat dhe e ndjeu veten zot karshi gruas së tij vetëm sa kohë e bija ndodhej në hekurudhë. Herë herë ndjente një farë ankthi. Dhe këtë gjë e ndjente sa herë që kujtonte të bijën. «Kush e di se si do të kthehet ajo nga hekurudha» thosh me vete i shqetësuar.

Dhe më në fund ajo ditë erdhi:

I tërë fshati qe lajmëruar të dilte përparrë për të pritur dhjetë vullnetaret, dhjetë çupat e reja që kishin ikur para dy muash. Në qendrën e kooperativës gratë kërcenin. Të gjitha ishin veshur me fundin e sëndukut. Nga rrobat e tyre vinte erë trëndelinë. Ato qeshnin dhe këndonin.

— Ç'është ky turp! — tha Hasan Qurku.

— S'është turp, po festë, — iu përgjegj e shoqja.

— Prit se do t'ja dëgjosh avazin kësaj festë, — tha ai dhe ngriti kokën.

— Po vinë, po vinë! — thirri dikush dhe të gjithë u sulën përparrë si një lumë shumëngjyrash.

Të dhjetë vajzat si të ishin dhjetë pranvera bashkë, erdhën të veshura me pantallona dhe

mbushën me gëzim fshatin si dikur, kur vinin partizanët.

Plaku u mundua ta përbante veten po s'mundi: më në fund ai e përqafoi të bijën. Atë natë ai desh të fliste me të, po në shtëpi kishin ardhur miq, punëtorët e NISH Elektrikut, dhe plaku u muarr me ta, kurse të nesërmen ai nuk guxoi të hapte bisedë. Dhe të pasnesërmen gjithashtu. Plaku u bind se në shtëpinë e tij kishte ardhur një tjetër Zafirë. Ai e shikonte dhe bënte çudi. Sytë e saj, shtatëmbëdhjetë vjet të fjetur e të mekur, ishin çelur si lulja buzë prillit. Edhe të ecurit ajo tashti e kish ndryshe, edhe të folurit ndryshe. Gjithëçka kishte ndërruar tek ajo, sikur të kishte pasë ndjenjur në hekurudhë jo dy muaj, po dymbëdhjetë.

Shpirti i saj i ndrydhur dhe i myllur, kish shpërthyer apo i kishin thënë shpërthe, tamam si ajo kumbulla buzë pranverës që shpërthen apo sheh një ditë me diell. Tashti edhe dashurinë e saj ajo e shikonte ndryshe.

Ai, Xhelua, çdo ditë i dilte përpara dhe pinte ujë nga shtamba e saj, dhe duke e mbajtur shtambën të dy, në dy vegje, ecnin ngadalë dhe heshtnin. Dhe fshati i shikonte që nga dritaret e vogla të kullave dhe heshtëte. Dhe e ëma e Zafirës, që dinte gjithçka dhe, që shikonte gjithçka, s'fliste. Ajo ndjente në shpirt frikë për këtë dashuri të heshtur.

Pas disa ditësh nga Sulova e largët erdhën në konakun e Hasanit dy miq: shkesi dhe daja i dhëndërit. Dhe në heshtje, në konak, ku ndriçonte bishtku, u vendos që pas një javë të bëhej dasma, megjithëse pas një javë binte e prem-

te dhe jo e djelë, dhe s'ish as vjeshtë e as dimër,  
po maj.

Kaluan tri ditët e para, tri ditë të gjata maji  
me punë dhe diell. E katërtë dëshmi i Hasanit iu duk  
e gjatë. Të pestën Hasani e thirri të bijën në konak  
dhe i tha:

— Nesër do të bëhesh nuse. Do vinë të të  
marrin.

— E di, — u përgjegj Zafira.

— Si?

— E di i gjithë fshati.

— Si?

— Po, baba.

«Krau» kërciti një shuplakë në konak si një  
shkrepitinë. Sytë e Zafirës u mbushën me lot dhe  
xixa.

Ajo nuk foli. Ktheu shpinën dhe, e qetë, zbriti  
shkallët, doli përjashta dhe humbi në fushë, mi-  
dis grunjave të gjelbra.

Në darkë nuk u kthye. As të nesërmen, që  
ishte dita e dasmës së saj, dita kur do të vinin  
krushqit për ta marrë, nuk u kthye...

... «O zot, po çmëndem», pat thirrur Hasani  
dhe, nga që s'rrinte dot më në konak vetëm për  
vetëm me bishtukun, kishte dalë në çardhak.

Dielli po perëndente i kuq e i madh.

«Tashti duhet të vinë krushqit, tashti hapu  
dhë të futem», kish menduar plaku dhe s'kish gu-  
xuar t'i hidhte sytë nga rruga. Rrinte si i ngrirë  
dhe vështronë vetëm diellin.

— Po vinë, — dëgjoi zërin e trembur të gru-  
as dhe zuri kokën me duar.

Në oborr hynë kuajt duke hingëllirë sikur të  
kish ndodhur një vdekje e kobëshme.

— O i zoti i konakut! — dëgjoi fare qartë Hasani dhe zuri veshët me duar e u fut në dhomë.

— O i zoti i konakut, — iu bë sikur gjëmoi oxhaku. Pastaj dëgjoi fjalë në oborr. Zë burrash. Pas pak u ndjenë hapat e kuajve që ikën revan dhe më nuk dëgjoi asgjë.

Kur hyri e shoqja në konak, ai brofi në këmbë. Kurrë nuk e kish pritur ai me kaq ankth fjalën e saj.

— Ikën të zemëruar. Thanë se do të hakmerrin.

— Kush foli me ta? — pyeti Hasani.

— Punëtorët e NISH Elektrikut. Ata thanë se s'do të kish ndodhur asgjë, nëqoftëse ne do të kishim telefonuar mbrëmë në qendrën e lokalitetit të Sulovës; mund të telefononim që nga zyra e kryetarit të kooperativës dhe t'u thonim që të mos niseshin.

Gruaja fliste dhe i shpjegonte se c'i kishin thënë punëtorët, se vajza do të kthehej prapë, po Hasani nuk dëgjonte. Ai kishte zënë kokën me duar dhe heshtëte pranë oxhakut.

\* \* \*

— Fy, fy, fy yyyy!

«Treni, — pëshpëriti Hasani, — gjithë natën këtë havaz ka».

— Fy, fy, fy yyyy! — futi përsëri oxhaku fish-këllimën e trenit, pastaj futi zhurmën e rrotave të hekurta mbi shinat e hekurta.

Hasani mbajti vesh dhe iu duk sikur pikërisht kjo uturimë e largët që përtej lumit, ja kishë rrëmbyer vajzën dhe ja kish turbulluar mëndjen

dhe shpirtin. Ngadalë ngriti kokën të cilën e kish mbajtur qëkur të mbështetur mbi gjunjë dhe hodi sytë përjashta. Dritarja e vogël e konakut fus-te dritën e bardhë të mëngjezit që kishte feksur. Pastaj pa bishtukun që u përpëlit. Flakëza e vogël u shkëput dhe u ngjit në çast. U përpëlit dhe një herë dhe u shua. Hasani zgjati dorën e tundi bishtukun dhe kuptoi se qe mbaruar vajguri.

## PARKU

Meremja mendohet në shtëpi dhe nuk di nga t'ja mbajë. Të gjitha ato që kish dëgjuar atë pasdite, ishin të drejta. Ajo ishte gati të bënte be e rrute se i pëlqenin tërë ato projekte. Mu në të nyrrë të qytetit, parku i rinisë do t'i thoshte cilitdo vizitor, që vinte të shikonte Krujën shekullore, se ai vend ish i gjallë, me një rini të qeshur, me një jetë të re që shpërthente plot ngjyra në ato gërmadhat e skërkë. Nëqoftëse atje, majë shkëmbit, gërmadhat e kalasë ishin dëshmi e së kaluarës: parku i rinisë, mu në hyrje, do të ishte dëshmi e së sotmes dhe e së ardhmes. Dhe kish qenë një gjë me të vërtetë e bukur e kuptimplotë, siç kish thënë në mbledhje vetë i deleguari, që pikërisht vitin e pesëqindvjetorit të vdekjes së Skënderbeut, të rinjtë kishin dashur ta festojnë, veç të tjerave, edhe duke e zbuluar kësisoj selinë e kryetimit. Meremja e kish ndjerë gjakun t'i gufonte në zemër nga këto fjalë. Ishin të gjithë atje. Qenë ulur në sheshin e pjerrët e të gjelbër midis selvive, ndërsa i deleguari kish qëndruar në këmbë. Ajo e do Krujën, se e ka vendin e lindjes; se atje po rritet e po piqet, se atje ka shtëpinë, ka shokët e shoqet, se

atje — si thotë dhe vjersha — ka qeshur e ka qarë. E shikonte Krujën e saj të zbuluar, me rrugë të shtruara me plloça, me kopshte, me shkallë guri të skalitur, që lidhin irugët, me ndërtesa të reja, themelat e të cilave kishin nisur t'i hidhnin, me hotelin turistik në she-shin mbi monumentin, me dritat elektrike me forma karakteristike në qoshe të rrugëve, me vargun e dyqaneve në pazarin e vjetër, të rindërtuar ashtu siç kish qënë para se të digjej nga armiqjtë gjatë luftës, me... Meremja nuk e di as vetë se ç'ndjenja krenarie dhe entuziazmi e trazojnë në zemër kur mendon të gjitha këto. Dhe në çaste të tillë është gati të rrëmbejë kazmën e të mos e lëshojë nga dora, derisa parku të marrë fund.

Megjithatë, tani ka rënë në mendime. E mundojnë varret.

Të punoje për të ndërtuar parkun, ku, veç fushës së voleibollit e basketbollit, do të ngrihej dhe një kënd lojrash të ndryshme për më të vegjilit, me shilarsa, shkallë për të rrëshqitur, pista për të vrapuar e të tjera, ishte një punë fort e bukur për të rinjtë e shkollës. Për këtë Meremja qe e bindur. Vërtet atje kish qënë më parë një teqe, por po bëheshin vite që teqia me gjithë varret qe shpërngulur andej. Kryegjyshata i kish vendosur poshtë, në Fushë-Krujë. Tani ai vend kish mbetur një shesh i braktisur dhe gropat e varreve të shpërngulura i kishin mbuluar ferrat. Po ku ta dish që në atë çonjë sheshi të mos ketë varre të tjera?

Kruja është mbushur me varre. Varre në Krastë, varre në Abazaj, varre në dyzet teqetë, varre në kopshtet e shtëpive, varre në mes të pa-

zarit... Dhe këto varre, në disa lagje, kishin zënë vendet më të bucura, ndërsa shtëpitë e të gjallëve qenë strukur ku të mundnin, sikur druheshin mos zëmëronin të vdekurit.

«Dyzet teqe!... — mendon Meremja. — Dy dervishë të vdekur në varre gjysmë të rrënuara, një mbishkrim turqisht mbi një rrasë të nxirë, një shtëpizë e vogël aty pranë për dervishët e gjallë e jo keq nga shëndeti, dy selvi, pemë e pjer-gulla për raki qark, të gjitha këto, rrethojoj me një mur të lartë e do të kesh «vendin e shenjtë». Në të vërtetë, ata të vdekur nuk ishin aspak «të shenjtë». Mirë e kish thënë i deleguari: ata kishin qënë «komisarët» e sulltanëve!

«Po ec e thuaja të gjitha këto gjyshit! Ai mendon ndryshe. Edhe për pak më mbyti, kur i thashë se të nesërmen do të shkoja të punoja në parkun e të rinxve. Ai vend thotë, është i shenjtë e, kush vë dorë në të, e pëson! Ja, prit kur t'i zërë gjynahu! Nuk do të ndahen dot pa kurban, jo!

— Po ai vend nuk është më teqe, mor gjysh.  
— Ka qënë, — thotë gjyshi. — Kjo mjafton për ta shenjtëruar!

— Po atje ka kohë që s'ka varre. Vetë xha Llani i ka hequr...

Xha Llani është i kryegjyshatës.

— Eshtrat, — thotë gjyshi, — eshtrat ka hequr, por shpirti i të vdekurve është atje, në tërë atë truall që shkelni ju, në tërë atë gielberimin që shpërthen qark... Mjerë ata që guxojnë!

«Dhe gjyshi mundohet të ta mbushë mëndjen. Ai i ka jetuar vetë mrekullitë e «vendeve të shenjta»: ato që rrëfen, të lënë gojëhapur dhe pa

gjumë natën. Janë histori të llahtarëshme të vdekurish, që ngrihen si kokudhë nga varri dhe kërkojnë hakmarrje... Ç'është e vërteta, kur hyra në oborrin e asaj ish-teqeje, ndjeva një shtrëngim në zëmër dhe gjunjtë m'u prenë. Po, domosdo, s'e dhashë veten. Po të tjerët? Kushedi. Por kush mund të thotë se ç'ka njeriu në zemër? Vërtet as çanin kokë për asgjë, vërtet qeshnin e bënin shaka. Vërtet ata që u ngritën e folën — të gjithë maturantë, se atyre u pat rënë në mëndje kjo punë — thanë se mezi prisnin të fillonin nga puna, por: «Ehehe, — thotë gjyshi, — në shtëpitë e tyre kushedi se ç'sherr kërcet!» E mirë, ja u bëkan sherre po të rinjtë, ama, i janë përveshur punës e nesër do të shkojnë dhe të tjerë. Po kësaj ç'i thonë, babagjysh?»

## 2

Meremja shkon te Sabai. Nënën e Sabait ajo e ka hallë. Hallë Tixhja i ngjan në fytyrë e në trup vëllait të saj, të jatit të Meremes që ka vdekur këtu e dy vjet të shkuara. Megjithatë, me ç'mban mënd Meremja, babai qe ndryshe, ishte i butë me fëmijtë, kurse halla ka dorë dhe është helm nga goja. Sabai e ka provuar kaq herë dorën e saj. Jo, vetëm Sabai, edhe motra e madhe, Kumria, të cilën para katër muajsh, e kanë mbyllur. E lanë të bënte vetëm shtatëvjeçaren, pastaj i hodhën çarçafin e zi. Meremes nganjëherë i vjen çudi, s'i besohet që Kumria duron e mbyllur në shtëpi, ajo që është aq e qeshur, aq e shkathët dhe aq këngëtarë. Rri e gjora kërrusur mbi

gjergjef dhe këndon. Këndon me mall. Hallë Tixhja s'ja duron as këngët, sidomos kur kuhton që, në ato fjalë dhe melodi, e bija vë zëmrën e saj. Dhe këngët e Kumries të tilla janë: flasin përherë për zemra të ndrydhura që digjen nga malli, për diell; ajër, jetë... Megjithatë, Kumria s'e mbyll gojën dhe shtëpia gjëmon nga këngët, sikur ato të jenë të vetmet armë që i kanë mbetur.

Nganjëherë Meremes i shkon diçka në mëndje, që e bën t'i rrëqethet mishtë. Ja, edhe ajo po kryen të shtatën. Pastaj ç'do të bëjë? E sheh vjeten të mbyllur si Kumria dhe një nyje i bëhet në grykë, në krahëror i mblidhei një lëmsh që i zë frymën. Në shkollë, midis shokëve dhe shoqeve, duke dëgjuar mësimet dhe duke lexuar librat, ajo bëhet më e fortë, më guximtare dhc i duket se me atë, Meremen, asnjeri nuk do të kuturisë të bëjë atë që kanë bërë me Kumrien. Megjithatë, kur kthehet në shtëpi, kur sheh gjyshin, kur shkon te halla dhe sheh Kumrien, i ngjan sikur të gjitha përpjekjet e saj janë të kota. Atëhere ka frikë të mendojë dhe vendos të mos çajë kokën, të jetojë pa e menduar mbylljen e saj në shtëpi, ash tu si njerëzit jetojnë pa e menduar vdekjen.

Burri i hallës, dikur ka qënë një tregëtar i vogël, si gjyshi i Meremes, bile gjyshi ja pat bërë krushainë. Tani është magazinier në Fushë-Krujë. Megjithëse ai e ngre zërin sa që e dëgjojnë edhe komshinjtë në shtëpi urdhëron hallë Tixhja.

— Qyqja, — i thotë halla Meremes, — edhe të vdekurit s'po i lënë rehat! Po keni për ta gjetë nga Allahu!

Meremja, përballë saj, nuk flet. Hesht edhe

Sabai që kushedi për të satën herë i dëgjon ato fjalë. Ai vetëm e pyet:

— Po në shkollë, moj nonë?

Hallë Tixhja shkundet e gjitha aty ku rri, sikur ta ketë zënë gjarpëri.

— Hiç të mos shkosh! As ti, as Meremja. Teqja është teqe... Ju s'e dini, por keni për ta parë kur të hapet dheu e t'i përpjek njerëzit të gjalië!

Dikur Sabai trëmbej, kurse tani besimet e ko-ta të nënës e bëjnë për të qeshur. Por e mban vreten. I hedh një vështrim të shpejtë Meremes që i ka zgurdulluar sytë e dëgjon si e trëmbur çfryrjet e mallkimet e hallës.

— Po si t'ja bëjmë atëhere?

— Të rrini në shtëpi.

— Po gjer kur?

— Gjersa të mbarojë kjo punë... Le që s'ka për të mbaruar dot...

— Po si t'u themi në shkollë, moj hallë? — pyet Meremja.

— T'u themi që s'na lënë në shtëpi? — vazhdon pyetjen Sabai me djallëzi.

Halla brof përpjetë nga inati.

— Qepe gojën murtajë! — i çiret të birit, — Se, po e kapa mashën t'i nxiva mishrat!...

Atë çast, nga dhoma lart, vjen zëri i Kumrjes që këndon. Halla ulërin:

— Plaq dhe ti!... Kumrie, moj!

Kumria e lë këngën përgjysmë.

— Na shurdhove gjithë ditën!... Ju ka plasur delli i ballit, nuk keni pikë turpi, as ti as ajo...

Sido që të jetë, vendimi u muar. Meremja dhe Sabai nuk do të shkojnë në shkollë, do të bëhen

të sëmurë, sa kohë që do të vazhdojë puna në park.

Kur u ngrit për t'u larguar nga shtëpia e hallës, ishte errur. Sabai po milte dhinë. Në ko-psh, deri te porta e jashtëme, Meremen e përcollë Kumria. Kur po u afroheshin dy ullinjve, kjo e zuri prej krahu.

— Pash zotin, Mereme, — i tha dhe fytyra iu skuq, si t'i kish marrë flakë, — ai a është atje?

Meremja mbajti këmbët.

— Si s'është? — iu përgjegj. — Maturantët e filluan këtë punë!

— Ule zërin, — ja preu Kumria dhe ktheu kryet nga shtëpia.

— E ke parë ti?

— Si s'e kam parë?

— Ty të flas, — vazhdoi Kumria, — se të kam si motër të vogël. Vetëm, shtifsh nonën...

— Mos u bën budallaqe, — ja ktheu Meremja që e kuptoi se ç'kërkonte ajo me atë be.

Në gjysmëerrësirën e mbrëmjes, fytyra e holle e Kumries, e skuqur nga turpi dhe zori, dukej e bukur. Sytë i shkëlqenin nga malli i dashurisë.

— Të ka thënë, — pyeti me zë të këputur, — të ka thënë gjë përmua.

Meremja vuri buzën në gaz e u skuq edhe ajo. Uli sytë e ngriti supet. Kumria e kuptoi që tjetra nuk kish ç't'i përgjigjej.

Të nesërmen, Meremja u shti e sëmurë.

Në fillim, ndënji në shtrat, sikur donte të bindët veten që vërtet ishte sëmurë. Vetëm se, duke ndënjur shtrirë, mendimet e sulmonin pareshtur dhe s'e linin të qetë. Atëhere u ngrit. Nëna kish vajtur në punë, në punishten e rrobaqepësisë. Në

shtëpi kish mbetur vetëm ajo me gjyshin: Le që edhe sikur të ishte nëna, ç'do t'i thoshte vallë? Nëna nuk ndihet në shtëpi. Ajo lidhë duart në pëqi dhe heshtëte. Që kur kish vdekur babai, ajo e kishte humbur. Në fillim, kur vëllanë e Meremes e kishin marrë ushtar, gjyshi nuk deshi ta lë-rë të dalë në punë. «Kemi ullinjtë, thoshte, dy dhi i kemi, rrush sa për rakinë e vitit kemi, të shtoj-më pulat e nuk kemi keq për asgjë». Por e uli zërin kur pa që ashtu nuk mund të vazhdohej më. Tani nëna kish pesë muaj që punonte dhe mban-te shtëpinë. Është e vërtetë se ishte çelur ca, që bërë më e hedhur, por prapë nuk guxonë të dilte përpëra vjehrrit.

Meremja nisi të rregullojë shtëpinë. Fshiu, lau, por, megjithatë, mendimet nuk i largoheshin. I kujtohej shkolla, mendonte shokët e shoqet në klasë. Atë ditë kishin dhe lexicim, mësimi që i pël-qente më shumë. Duke sjellë ndër mend fytyrën e mësueses, iu kujtuan dhe fjalët e saj. E kish zakon ajo, për çdo gjë të vjetruar, të thoshte «mesjetë e vogël». Kështu do të thoshte tani edhe për Meremen. Dhe do të kishte të drejtë. Ashtu ishte ajo. E gjithë shtëpia e saj ashtu ishte. Edhe e Sabant. Një «mesjetë e vogël»; me ca rrënje ullinj, me dy kokë dhi, dhe me ca pula, me raki e me vajza të myllura, me hallë Tixhera dhe gjyshér që ulërijnë e të zënë frymën, me fëmijë që kanë frikë të jetojnë...

Punët e shtëpisë u mbaruan, por vargu i mendimeve nuk kish fund. Librave nuk iu afrua. U hidhët nga një vështrim vjedhurazi, me bisht të syrit, por nuk i prekte. I dukej se nuk kishte të drejtë t'i merrte në dorë, t'i shfletonte e t'i lexon-

te. Gjersa ish mbyllur ashtu në shtëpi, do të thoshte se nuk u kishte besuar librave, por përrallave të gjyshit e të hallë Tixhes. Nuk mjafton të marrësh nota të mira në mësimet, të përpinqesh për dhjeta e nënda, e rëndësishme është që mësimet t'i dish, t'i bësh gjakun e zëmrës sate. Ndryshe, çdo gjë është e kotë dhe shëmbet si një kështjellë prej letre. Ç'kish bërë ajo në të vërtetë? Qe mbyllur në shtëpi para se ta mbyllnin të tjerët, qe mbyllur vetë, me duart e saj. Kumrien, së paku, e kishin mbyllur. Dhe, duke mbyllur derën e shtëpisë, ajo Meremja, kish mbyllur edhe librat. Tani po e kuptonte dhe habitej se ç'lidhje paskësh pasur midis jetës së saj dhe parkut! Duke shëmbur vjetërsirat për të ngritur parkun, ajo do të shëmbte rrezikun që i kanosej rinisë së saj për t'u burgosur e zbehur midis katër mureve, ajo do të shëmbte «mesjetën e vogël» të gjyshit dhe britmat e hallë Tixhes, shpirtëndrojtjen e nënës dhe paragjykimet e krimbura që po i sëmurnin shpirtin. Duke punuar për parkun, ajo do të fuste jetën e re në zëmrën e saj, do të hapte dritaret dhe do ta linte diellin të hynte lirisht në shtëpi, do t'i zgjidhje duart e nënës të lidhura në pëqi dhe do t'i bënte sytë e saj të qeshnin.

Librat ishin në çantë, në dhomën e zjarrit, të varura në mur. Ajo u vërsul drejt tyre si e uritur. I nxori, i hapi, shpërfleti disa, por nuk duroi dot më: në mes të këtij vrulli, u shkreh në vaj.

tën e hallë Tixhes. Sabai nuk ishte në shtëpi.

— Ku ka shkuar? — e pyeti Meremja Kumrien.

— Në park, të punojë si gjithë shokët. Nëna është bërë tym e flakë, — u përgjegj ajo e zuri fytyrën me duar për të fshehur një buzëqeshje të djallëzuar.

Kur hynë në shtëpi, hallë Tixhja thirri nga dhoma e zjarrit:

— Kush është, Kumrie?

— Meremja, nonë.

— Thashë mos ishte ai lugati, se mu në kopsht, atje te fiku kam për t'ja ba varrin!

Kumria i hodhi një vështrim të shpejtë Meremes, dhe asaj i mjaftoi kjo për të hetuar në syste e kushërirës një gaz e kënaqësi, që i kishin dhënë fytyrës së saj të zbetë një shkëlqim të çuditshëm.

— Po ti, — e pyeti hallë Tixhja Meremen, kur kjo i erdhi përpara, — po ti nuk shkove?

— Jo, — u përgjegj Meremja.

— Ti bofsh hajër! Të lumtë! — dhe hallë Tixhja zgjati krahët drejt saj. — Ti po, ma bëre qejfin, jo ai imi! Eja te halla! — Vajza uli kokën dhe halla e puthi në ballë.

Meremes iu duk sikur buzët e hallë Tixhes i dogjën lëkurën, sikur i lanë atje një shenjë të shëmtuar. Ngriti dorën dhe e fshiu.

— Kurse imi, — vazhdoi hallë Tixhja, — as pyeti fare, po u nis e iku të tërbojë!... Ishallah këputet ndonjë tjegull dhe ma lë në vënd imansëzin!

— Mos mallko ashtu, nonë, — u hodh e tha Kumria.

— Mbylle gojën ti! Se dhe ti ke faj.

— E po ai djalë është! Vajzat e shkreta, po, i mbyllin dhe ua nxijnë ditët, por djemtë s'ka ndodhur ndonjëherë që t'i mbyllin... Veç në e bëfsh ti e para!

Hallë Tixhja kërciti dhëmbët dhe zgjati dorën drejt mashës por Kumria, më e shpejt, fryu nga dera.

— Kuçkë! — shau hallë Tixhja. — Kur do të vijë ai sahat, xhanëm, që të të bëj def nga shtëpia, të të heq qafe e mos të ta shoh ma bojën?!

Kur u qetësua ca halla, Meremja e pyeti me hollësi pér Sabanë. Mësoi atëhere që ai, në mëngjez, si pérherë e pa pyetur pér asnjeri, kishte vajtur në shkollë dhe, mbasdite, orën e caktuar, prapë pa pyetur pér asnjeri, qe nisur pér në park.

Meremja e dëgjonte dhe i vinte turp nga vetja, kur mendonte që Sabai ja kish hedhur. Kjo donte të thoshte se në atë «mesjetë të vogël» nga të rinjtë, vetëm ajo qe treguar frikaçë, sepse edhe Kumria kish nisur ta ngrinte zërin. Duke dëgjuar hallë Tixhen, ajo mendonte, nga ana tjetër, se asnje nga ato që kish patur frikë se do të ndodhni, nuk po ndodhëte. Hallë Tixhja do të ulërinte e do të çirej ca ditë, mbase do t'i jepte ndonjë flakurinë Sabait, mund ta mbyllte pér ca orë edhe në nevojtore, do ta zinte pér gërshetash edhe Kumrien, por pastaj çdo gjë kishte pér të ndjekur rrugën e vet.

Natën nuk e zuri gjumi. Dëgjonte frysëmarrjen e nënës dhe mendohej. Një herë tha se do kish qënë mirë sikur nëna të zgjohet dhe ta shikonte

të bijën që nuk flinte dot. Do të merakosej, e gjora nënë, dhe do ta pyeste se ç'e mundonte ashtu. «Mos je sëmurë?» do t'i thoshte. «Jo, nuk jam sëmurë». «Përse nuk fle atëhere?» «Sepse kam një brengë të madhe në zemër!» Nëna do të ngrihej nga dysheku e do t'i shkonte pranë. Ajo e dinte se nuk mund të ish punë mësimesh, sepse e bija që mësuar t'i sillte në shtëpi vetëm nota të mira. Kështu kish qënë që në klasë të parë fillore. «I thuaj nënës ç'ke?» Meremja atëhere do t'i rrëfehej. Nëna do t'i përkëdhelte flokët e do ta qetësonte. Po si do ta qetësonte? Gjatë tërë atyre ditëve ajo nuk e kishte hapur gojën fare. E kish parrë të bijën me një vështrim të mekur, e pa vullnet, me duart lidhur në pëqi, po nuk e kishte hapur gojën. Meremja zien e tëra: «Folë, nënë, folë! Mos më vështron ashtu. Thuaji gjyshit se bija jote e urren «mesjetën e vogël», atë mesjetë që të ka ndrydhur ty, të ka fishkur para kohe, të ka vjedhur fjalët, të ka vjedhur guximin e tanë po të vjedh edhe bijën. Folë, nënë, folë!»

Por nëna flë.

Orët kalojnë.

Meremja më në fund vendos që të nesërmen të marrë çantën e të shkojë në shkollë, ndërsa pasdite, në park. Le ta rrahë gjyshi, le ta vrasë po të dojë. Ajo nuk jeton dot pa shkollën, pa ecur përpara krah për krah me shokët... Po të pranojë sot të heqë dorë nga shkolla e nga parku, nesër duhet të pranojë që të heqë dorë edhe ngajeta.

Megjithatë, të nesërmen, në mëngjes nuk shkoi në shkollë. Në fillim tha se kish kohë; pastaj ora e parë filloi dhe ajo vendosi me vete që të shkonte orën e dytë. E kaplloj një shqetësim

e nervozizëm, sa që zunë t'i dridhesin gjymtyrët.

Mbathi këpucët. Bëri për të dalë. Vendosi të shkonte te hallë Tixhja, të shikonte se ç'bëhej andej.

Porta e kopshtit u hap. Hyri gjyshi. Kish sjellë peshk me vete.

— Ku shkon kështu? — e pyeti.

— Te hallë Tixhja.

— Shko pastaj, — ja preu. — Na, merr këtë peshk dhe pastroje.

Duke pastruar peshkun, Meremja mallkoi veten. I dukej sikur nuk vlente asgjë, posa që kish frikë të çfaqte haptazi mendimin e saj, posa që gënjenjet veten për t'i bërë bisht detyrës...

Macja, e ndjellur nga era e peshkut, erdhi dhe iu përqall. Ajo e flaku tutje. I cukte nervat, zëri i saj i zvarritur dhe si më të qarë, fërkimet e saj të buta dhe servile, që i kujtonin shpirtin brumë dhe vullnetin e sëmurë të një skllaveje... Ajo kish nevojë për shembuj të tjerë, për zemra të forta, për vullnete të çelikta, që nuk janë mësuar të lypin lëmoshë, por e rrëmbejnë me forcë atë që u përket.

E pastroi peshkun, e lau dhe e shpuri në dhomën e zjarrit.

Çanta ishte në mur.

Asaj i hip gjaku në kokë.

Turret, rrëmben çantën dhe del në oborr.

Nga brenda, zëri i gjyshit gjëmoi:

— Ku do të shkosh, te halla?

— Jo, — përgjigjet qetë-qetë e mbesa, — në shkollë.

Kur doli gjyshi në oborr, ashtu në çorape siç

rrinte në minder, Meremja ishte në portën e ja-shtme.

— Mereme! — thirri ai. — Mereme!

— Ç'do, gjysh?

— Kthehu!

— Përse të kthehem?

— Kthehu, të them!

— Mjaft ndënja këtu, — tha vajza dhe fytyra iu skuq nga inati, — mjaft ndënja mbyllur këtu! Është turp.

— Atë e di unë! Unë nuk të le të bësh si Sabai.

Unë do të bëjë si bëjnë të gjitha shoqet. Rrihmë, më vdis në dru, po deshe: unë nuk rri dot pa shkollë.

Plaku e pa që me të egër nuk do të nxirrte gjë mbanë, ndaj e ktheu ndryshe:

— Mirë, — i tha — në shkollë shko. Por atje, t'i kemi fjalët e prera; nuk do të vesh këmbë!

«Atje» ishte parku.

— Dëgjon ç'të them?

Vajza ja nguli sytë në heshtje një copë herë.

Kur u kthyte nga shkolla, gjyshi nuk i foli me gojë. E shikonte shtrembër, në heshtje. Meremja, e forcuar në zemër nga fitorja e parë që kish korrur në mëngjes, ish e vendosur të sulmonte më tutje... Dhe ishte e sigurtë se edhe këtë radhë do të triumfonë.

Pasdite trokiti porta e jashtme. Gjyshi ishte në kopsht duke prashitur qepët. Shkoi ai vetë përtat hapur.

Duke përshëndetur tërë gaz, në oborr hynë, njeri pas tjetrit plot tridhjetë djem e vajza, shokë e shoqe të Meremes.

— Kemi ardhur të marrim Meremen, gjysh.  
Plaku e kuptoi si qe puna, por për një çast,  
e humbi.

Pastaj deshi t'i gënjejë e t'u thotë se Meremja ishte sëmurë kur, atë çast, e mbesa doli duke qeshur nga shtëpia.

— Po ikim, gjysh!

Gjyshi desh t'i thotë mbesës që të shkëputet nga shoqet, por kopshti qe mbushur plot dhe djemtë e vajzat ishin tërë gjallëri e s'të linin radhë të flisje; i vinin rrrotull plakut dhe e trullosën fare me ato që i thoshin.

— Për Meremen mos u bën merak, gjysh! Do të punojmë bashkë, — i tha një vajzë syzezë, me dy quka në faqe.

— Mirë u pafshim, gjyshi i Meremes!

— Nesër do të vimë prapë!

— Mirë u pafshim, gjyshi i Meremes!

Dhe me gjallëri e zhurmë, ashtu siç kishin ardhur, ashtu edhe u larguan.

Meremja fluturonte nga gjëzimi.

## M. ZALOSHNA

### HIJA E ZEZE E «EFENDIUT»

Shkrimi që po botejmë mbështetet në një fakt të vërtetë, që ka ndodhur para pak kohësh në një fshat të rrethit të Beratit.

Në portën e jashtme u ndje një e trokitur e shurdhër, por shumë e njojur për Hyrinë. Erdhi përsëri «I nxirosuri», tha me vete dhe u ngrit të shihte nga dritarja në ish ai vërtet apo jo.

Zigur efendiu, hoxha i fshatit, hyri brenda, sikundër e kish zakon, pa pritur të delte njeri ta priste. Si njeri «me edukatë», për të mos e gjetur të zonjën e shtëpisë pa fshirë e pa rregulluar, ecte ngadalë nëpër oborr, shtrihej sikur kollej, vonohej, sikur gjoja i tërhoqte vëmendjen diçka. «Prapë e pruri kokën, që mos e pruftë!» mallkoi nëpër dhëmbë Hyria. «Pse e qas në shtëpi këtë, nënë?!» i tha e reja dhe vuri re sytë e së vjerrës kredhur në një brengë të fshehtë. Kjo gjë asaj i kish rënë në sy që prej disa muajsh, por sot rru-dhat e dhimbjes e të hidhërimit të plakës i pa në një dritë të re. «Ah, moj nuse, moj bijë», ju përgjegj?! Hyria, «ç't'i bëj të nxirosurit!?.» «Ç't'i bësh?! Mos e qas!» foli prerë Drita. Zigur efendiu trokiti edhe një herë te porta e brendshme, u koll, dhe hyri në korridor gjithë «edukatë», i qetë e i përvojtur.

— Ku të kam, motra Hyri?

Ja për këtë përvojtje të shtirur, për këtë «zë të butë» për këtë fytyrë gjoja prej shenjtori, plaka e urrente më shumë. Por me gjithë urrejtjen që ndjente për këtë njeri, Hyria mundohej ta nderonte sa të ishte e mundur më shumë. Ajo kishte frikë prej atij njeriu.

— Këtu jam efendi, këtu. Urdhëro!

Doli, i mori shkopin me dorezë të kthyer, ja vuri në një gozhë dhe i priu për në dhomë.

Zigur efendiu hyri duke përsëritur: «marshalla! marshalla!» Asgjë e veçantë nuk kish ndodhur në shtëpi për të bërë «marshalla» e për të rënë në sy, por efendiu, për t'u bërë qejfin të zotërve të shtëpisë, e kish zakon, kudo që vinte të thonte «marshalla». «Kështu, mendonte ai, u hynte më shumë në zemër njerëzve e i bënte përvete». «Plaç edhe ti me gjithë «marshallanë» «tënde!» — shfreu Hyria duke i rregulluar shilte të ulej, por në të njëjtën kohë u pendua, siç pendohej gjithmonë, kur e mallkonte, se mos hynte në gjynah. Duke hyrë në dhomë, Zigur efendiu t i mbeti «marshallaja» në gojë, kur pa Dritën në këmbë pranë trapezës, tek rregullonte kanën dhe gotat e ujit. Ai u druhej të gjithë të rinjve. E kish zakon që vizitat t'i bënte, kur të rinjtë e të rejat ishin në punë dhe në shtëpi gjente plakat e pleqtë. E mblodhi veten shpejt e shpejt. U përpooq ta dëbonte mërinë që ju shkaktua dhe ju drejtua Dritës me atë gjakftohtësinë e tij të shtirur:

— Marshalla! marshalla! Si je, bijë? Si je, evlat?

«Edhe gjarpëri gjakftohtë është, po ai e ka helmin më të fortë», mendoi Drita tek e pa t'i përulej me atë zérin dhe sjelljen e tij prej «shenj-

ti». Drita ju përgjegj pa e përfillur: «Mirë». Ajo nuk ktheu as kokën, kaq i ishte vështirosur ky shenjt.

Zigur efendiu, që u mat t'i jepte dorën e të përshëndetëj me të, ngriu pér një çast në këmbë i zbehur në ftyrë. Pastaj shkoi e u ul në shilte.

— Si je, motra Hyri? Si m'i ke evlatët?

Drita doli nga dhoma. Efendiu e ndoqi me sy gjersa dera u mbyll.

— Hej, si u bënë edhe të rinjtë tan! — tha ai me zemërim.

«Ç'ta bëri mirë», tha me vete Hyria. Dhe atij me zë: — Po, po, efendi, c't'i bësh! — ngriti supet. — Do të vijnë edhe ata në din, do të vijnë.

— Po, po! — përsëriti efendiu.

\* \* \*

Zigur efendiu gjatë dhjetë vjetëve që ushtronnte «mjeshterinë» e tij në atë fshat gjer para katër muajsh nuk pat shkelur në shtëpinë e Hyrisë. Këtë gjë e kish patur peng në zemër, sepse nga ajo shtëpi nuk «kish parë hair», siç thosh ai. Përveç kësaj, kjo gjë sikur ja ulte edhe vlerën në sy të tē tjerëve, ku kishte gjetur grazhd e kulloste. Para katër muajsh, Adili, djali i Hyrisë kish shkuar në një kurs në Tiranë. Me të mësuar këtë gjë, efendiu mori shkopin, çantën prej doku të mbushur me qitapë, të cilët as dinte t'i lexonte, dhe shkoi e trokiti në portën e Hyrisë. Me një buzëqeshje të rreme e të neveritshme, krejt i përulur, gjithë dashamirësi të shtirur, gjithë gadishmëri pér të qenë në shërbim të njerëzve, shkoi e u ul dhe zuri të bisedonte me Hy-

rinë për frikë zoti e perëndie, për të vdekurit e shpirtërat e tyre, për nevojën që kanë ata në atë jetë për t'u dërguar ndonjë selam e për t'i kujtuar kohë më kohë me një atme apo me jasin, ashtu sikundër kanë nevojë të gjallët këtu në këtë jetë për letra nga të largëtit. Efendiu kish mësuar se Hyrisë i kishin vdekur dy djem. Që në vizitën e parë ai mundi ta bindë lehtë-lehtë plakën fetare që hoxha t'u këndonte nga një jasin si djemve ashtu dhe burrit të vdekur. «Atmeja bën pesëdhjetë lekë, i tha Zigur efendiu plakës, jasini njëqind. Po me jasin, atyre që kanë kaq vjet pa i kujtuar, do t'u qetësohen më mirë shpirtrat». Dhe Hyria nxori e i dha hoxhës treqind lekë fshehur nuses. Kurrë nuk e kish bërë këtë gjë në jetën e saj, të nxirrte nga shtëpia qoftë edhe një majë gjilpëre fshehur djalit e nuses. Kjo e tronditi shpirtërisht dhe ndërgjegjja e saj mbeti gjithmonë e vrarë. Po ta hetoje, dukej si njeri që kish një dhembje në shpirt. Shpesh ajo pyeste veten: «Si e bëra unë këtë gjë prapa krahëve të djalit e të nuses?» Në vizitën e dytë, Zigur efendiu i pruri lajmin për jasinin që u kishte kënduar të vdekurve të saj dhe e pyeti nëse i kish parë në ëndërr apo jo, e si t'i kanosej shtoi me të butë: «shiko, mos më fshih gjë mua, se unë i di të gjitha!» Tha kështu e qeshi me ato sy dinakë e të fshehtë. Ajo vërtet i kish parë në ëndërr gjatë atyre ditëve djemtë dhe burrin dhe ja tregoi efendiut. Efendiu qeshi pa e fshehur, kënaqësinë e fitores së tij, vuri gishtin e madh në gojë, kafshoi thuan me dhëmbë dhe pastaj mbeti për një copë herë të madhe me sytë nga tavani e me një vështrim të habitur, si ata njerëzit që janë për-

para një problemi pa zgjidhje. «I nxirosur» ç'po bën kështu?!» pyeti veten gjithë frikë Hyria, dhe që atë ditë ajo, me vete, nuk e quante as në emër as «Efendi» por «I nxirosuri». Efendiu hoqi gishtin nga goja më në fund, diç prapsi me të duke goditur në ajër, dhe pa me ngulm Hyrinë. Asaj ju drodh zemra. «I nxirosur, ç'do të më thuash?!» pyeti me vete plot frikë duke i shkuar menjëherë mendja të djali që kish larg. Efendiu e vuri re, plaka pa qartë kënaqësinë që ndjente ai, kur e trondiste kaq shumë. «Çfarë njeriu je ti, mor i nxirosur!» tha me vete. Zigur efendiu, që i kish te folur edhe për xhinitë e shpirtërat e këqij, tun di kryet si pa të keq, si njeri që ka në dorën e tij gjithçka të dukur e të padukur në dhe e në qiell. «Hëm», ja bëri gjoja me keqardhje të thellë.

— Pastaj?! — pyeti plaka duke e kapërcyer pështymën me zor.

— Ti paske nusen me barrë?

— Po.

Zëri i plakës u drodh në fillim e u mek fare. Duart po i dridheshin dhe rëndoi me bryla mbi gjunjët e saj të dobët.

— Ajo paska dështuar një herë?

Plaka nuk po mundej t'i përgjigjej. Efendiu nuk kishte nevojë ta dëgjonte prej gojës së saj. Gjatë dhjetë vjetëve ai kish mësuar aq të fshehta lidhur me njerëzit e fshatit sa edhe vetë fshatarët nuk i dinin.

— Nusja jote, — vazhdoi efendiu me një qetësi të tillë sa që e bëri plakën e mjerë të dridhej. Ajo po të mos kish frikë nga ky njeri do t'i hidhej në grykë, do ta mbytte mjaft që të mos i dëgjonte ato fjalë që do të nxirrte nga goja: «nusja

jote do të dështojë. Ajo nuk do të bëjë kurrë fëmijë të gjallë.

— I nxirosur, ç'më the?! — thirri plaka pa e përbajtur veten, dhe e penduar, u zgjat e i vu-ri dy duart tërë rrudha mbi gju. — Aman, efen-di! Si të mos mbaj unë korba një fëmijë të djalit në prehër?

— Nusja jote, kur ka qenë me barrë në fëmijën e parë, ka shkelur mbretëreshën e xhinive dhe ka dështuar. Fëmijë në barkun e sat reje nuk do të rritet, gjersa...

Plaka dukej sikur nuk po e dëgjonte më. Dridhej.

— Por mos u tremb, — u nxitua hoxha t'i fliste gjoja me besim në vete, — mos u tremb, se ka perëndia, i kemi në dorë edhe ato.

— Efendii! — thirri Hyria duke hedhur vështrimin sikur kërkonte me sy diçka nëpër dhomë.

— Ka perëndia, ka perëndia, — e qetësoi efen-diu.

Pastaj, bashkë me plakën, shkuan në oborr. Hyria e pyeti Zigur efendinë tri herë me radhë: «Ç'bën aty?». Efendiu, që kishte zënë me dorë një degë kumbulle, ju përgjegj po tri herë:

— Unë tund degën,  
Dega të tundij pemën,  
Pema të tundij dhenë  
Dheu të tundij detin  
Deti të tundij mbretëreshën e xhinive.  
Mbretëresha e xhinive t'i falë gjynahet Drid-tës.

— I nxirosur! Nga i di gjithë këto?! — pyeste

plaka veten me nderim nga frika që i kish shtirë  
në zemër.

I dha njëmijë lekë Zigur efendiut për këtë «nder» të madh që i bëri». Por megjithatë i dri-dhej misht kur e kujtonte dhe nuk donte ta shihte me sy. Nga dita që «i nxirosuri» kishte këpçyer pragun e shtëpisë së saj, ajo kishte humbur guximin, qeshjen, fuqinë, dritën. Orë e çast i suleshin mendime të këqia, të cilat ishte e pazonja t'i përzinte: «Po sikur «I nxirosuri» të zemërohej me gjithë mend e t'i bënte ndonjë magji nuses, djalit, asaj, gjithë shtëpisë?» Shpesh i bë-hej sikur dëgjonte: «Unë tund degën». Ai nuk ishte ashtu zemërbutë, i dhimbsur, shenjtor siç hi-qej. Hyria këtë e kish parë qartë, kur asaj i futuronte mendja nga frika se mos i dështonte përsëri nusja dhe atij i endej një buzëqeshje djalië-zore, që të kallte datën e qëndronte para saj si ai ujku që ka vënë delen ndën këmbë. Hyria tmerohej për lidhjet e fshehta me hoxhën, që vazhdonte të mbante prapa krahëve të djalit e të nuses. Ç'do të thoshin ata po t'i dinin të gjitha kë-to? Ata nuk besonin, por ishin të lumtur. Digjët nga dëshira që të kish një njeri të zemrës t'ja qante hallin, t'i hapte zemrën e t'i thosh që ajo po vidhite shtëpinë e po mbushte xhepat e hoxhës, po hiqte nga goja e tyre gjalpin, djathin dhe po ja hante «I nxirosuri», sepse Ziguri i kish thënë se, që mbretëresha e xhinive t'ja falte fajin së resë e që magjia të prishej duhej përsëritur «luta-gjersa asaj t'i zbrisnin xhindët.

\* \* \*

Koha e mbarimit të kursit ku mësonte Adili po afronte. Për tri javë ai do të kthehej. Atëherë do të mbaronte për Zigur efendinë edhe mjelja e lopës së majme, siç e quante ai Hyrinë, prandaj erdhi kësaj radhe për të fundit herë. Por, po han-te veten me dhëmbë për shkakun që gjeti Dritën brenda. Një gafë të tillë nuk e pati bërë gjékundi. Ai kish frikë nga të rintjtë, prandaj atje ku i shkisnin këmbët hetonte mirë, pastaj shkonte e trokiste në derë. «Përse t'i qëllonte kështu kësaj here? Përse të takonte Dritën?!! Mallkoi veten që nuk ish siguruar e ish mjaftuar vetëm me një fjalë që i kishin thënë se Drita ishte në punë.

Hyria vuri re që efendiu po rrinte në shilte si t'ish ulur mbi ndonjë monë. Kohë më kohë e pyeste: «Aty është nusja?» «Matanë e ke nusen?». Nuk i foli për asgjë Hyrisë. Përpinqej të fshihet frikën që i kish hyrë në bark, por atë që nuk ja thosh goja e tradhëtonin sytë. Ndejti fare pak dhe duke u bërë më baltë se ç'bëhej, me shenjtërinë e tij të neveritshmë u ngrit e iku. Hyria e përcollë gjer te porta jashtë.

— Nëne, — i tha Drita Hyrisë kur u kthye, — mos e qas atë kurrë. Ai është i poshtër, kusar. Gënjjen njerëzit e çfarë nuk u merr. Të ka ardhur ndonjë herë tjetër?

— UU, jo bijë, jo. Ja, vetëm sot, — tha plaka duke u ulur gjoja për të ndrequr rripin e nalla-neve dhe nxitoi të hynte në dhomë. Por edhe vetë e kuptoi se zëri i saj fliste qartë që ajo kish ve-pruar prapa krahëve të së resë, prapa krahëve të

djalit që kishte lënë atë dhe nusen të re për të mësuar.

Hyri në dhomë dhe, duke shkrepur urat e zjarrit të ndizeshin, mallkonte me vete hoxhën «I nxirosuri» nga e pruri kokën! Kush u bë shkaktar e na e pruri në fshat, mos paftë ditë të bardhë! Në, këtë kohë erdhi Drita.

— Nënë, — e pyeti, — në qoftë se të ka gënyer edhe ty, nxirrja të gjitha në mbledhjen e fshatit. Ai nuk e di, por fshati i gjithë është ngri-tur në këmbë dhe do ta përzënë me daulle, si i thonë një fjale.

— Bijë, — thirri plaka duke ju dredhur buza, — kam frikë për ju! Për Adilin! Për ty!... Për!... — ajo e vështroi të renë nga barku, e drithëruar për foshnjën që priste ta rritte në prehër. — Ai mbledh xhinitë, të përbys shtëpinë, i vë zjarrin botës.

E reja qeshi me të madhe.

— Ai është rrëmall, moj nënë. Ja, ke për të parë ç'do t'i bëj fshati atij dhe ç'ka për të bërë ai nga ato që beson ti. Ai ka qënë një birko dembel, një hajdut pulash dhe erdhi këtu...

Tri ditë më vonë, në mbledhjen e fshatit për të përzënë Zigur efendinë, plaka e shkretë dëgjoi shoqet e saj si i kish rrjepur «I nxirosuri». Dëgjoi edhe ç'maskarrallëke kishte bërë përpara se të vinte në fshat e të tregohej si hoxhë. Priti plaka mos efendiu thërriste xhindet e i çmendte ata që i nxuarën në shesh të palarat, po asgjë s'pondot. Priti mos i vinte zjarrin fshatit, por ai ish mbledhur sa një grusht.

— Këtij matrapazi i kemi dhënë bukë e ky

na ka dhënë helmin — tha një nuse e re më në fund fare. — Të ikij, të mos ja shohim bojën këtij xhambazi.

— Ashtu bijë, ashtu, — tha me vete Hyria. Dhe vazhdoi. — Kushedi, moj korbë, q'do të ketë rrjepur «I nxirosuri» edhe tët vjerrë, prandaj më flet me aq zemërata.

«I nxirosuri», me të mbaruar mbledhja, ngarkoi plaçkat dhe iku. Hyria e ndoqi me sy si çapitej «i shenjti» me kalin përdore, me atë kalë që e ngarkonte java-javën me të gjitha të mirat dhe i shpinte në shtëpi.

Pastaj u ngrit. Gjunjët i qenë mpirë, sepse kish ndenjur gjatë ulur në bisht duke përciallë me sy «të nxirosurin», i cili tani u nxiros vërtet kur ja plasën turinjve turpet e ndyrësítë që kish-te bërë. Ajo qe e vetmia që e ndoqi me sy gjersa u zhduk fare duke pritur mos ai bënte ferk dhe e përvëlonte fshatin, pasi të qe larguar. Po as kio nuk ndodhi. Në vend të kësaj ajo shihte fshatarët grupe-grupe, të rinjtë e gëzuar që vinin në lojë hoxhën dhe qeshnin me të madhe, me zë të pastër e plot gjallëri. Ky gëzim i papritur dhe ky ton shrotitës i rinisë, po ja largonte pak nga rak edhe Hyries hijen e zezë të «efendiut» që u largua dhe humbi nga sytë si një njollë e errët dhe e neveritshme.

FUTA E ZEZË

— Tregim i vërtetë —

Rina Vasili, drejtuese e vatrës së kulturës në kooperativën bujqësore të Bregasit, kish ditë që bënte takime me pleqtë e plakat e fshatit. Ajo i kishte vënë detyrë vetes të shkruante një teksti për estradë. Qe hera e parë që i përvishej kësaj pune, por kishte besim në forcat e saj se do t'ja dilte mbanë. Kish mbaruar dy skeçe: njérin përgritjen e gruas në përgjegjësi dhe tjetrin për terrickuzën. Edhe dy kuplete çoc i kish sajuar për ato gra që ecin zbatbur dhe për burrat që mbahen me të madh se nuk mund të merren me «punë grash». Tematikë kish, por puna nuk i ecte mbarë. Mendja i punonte, bie fjala, te zakoni i veshjes së grave me të zeza. Kish shkruar disa variante skeçesh por... më kot. Asnjë nuk kish dalë për të genë.

«...Tërë rininë dhe tërë jetën gratë e kalojnë të veshura me futë. A nuk është ky një zakon i dëmshëm? Vajzat dhe gratë të veshura në të zeza, qoftë edhe vetëm me shami, për një kohë të gjatë nuk marrin pjesë në punë, në gëzime dhe në jetën kulturale e artistike të fshatit. Ne nuk e kemi problem pjesëmarrjen e femrës në grupet

artistike, në estradë, në teatër. Është krijuar traditë e mirë në Bregas. Por ne pengohemi, kur njerës ta zëmë i vdes një kushëri i largët. Ajo tèrhiqet menjëherë nga aktiviteti artistik, nga puna, ngajeta. Tri vjet detyrohet të rrijë veshur në të zeza, këmbë e kokë, pastaj edhe disa vjet të tjera me shami të zezë. As në këngë, as në valle nuk merr pjesë. Ç'gjë e hidhur!...»

Kështu mendonte Rina, tek ngjitej në fshat. Këtë e kish biseduar edhe me mësueset, bile edhe me sekretarin e organizatës bazë të partisë. Së bashku kishin arritur në disa përfundime. Por dilte pyetja: a duhet mbajtur zi? Për kë dhe për sa kohë duhet mbajtur?

Kish mendime se si duhej mbajtur, por jo për një kohë të gjatë. Kish edhe mendime të kundërtat.

Me të arritur në shtëpi i tha nënë Marigoë se kish nevojë të këshillohej me të dhe u fut në dhomë. Hëngrën bukë dhe, pasi të tjerët ranë për të fjetur, nënë Marigoja shkoi në dhomën e Rinës. E nxitur nga kureshtja për të mësuar çfarë kish çupa, harroi të merrte me vete edhe trikon e Pavllos, që kish vendosur t'ja dërgonte në ushtri si dhuratë për ditëlindje.

— E, moj Rinë. Çfarë këshillë mund të të japo nëna?

— Më parë dua të lë pyes: sa vjet ke që i ke veshur rrobat e zeza?

Ajo, e habitur, picërrroi sytë dhe mblodhi supet.

— Pse të duhet kjo? Unë nuk e mbaj mend, por nuk i kam hequr nga trupi këtu e niçzet e katër vjet të shkuara. Ah, prit se harrova. Edhe në

atë kohë isha në zi, por mbaja vetëm shaminë e zezë të kokës, sepse kunatës sime i kishte vdekur një nip.

— Domethënë, pothuajse tërë jetën e ke kaluar në të zeza?

— Mos m'i lëndo plagët, moj Rinë, se ashtu është. Po ty pse të hyjnë në punë këto gjëra?

— Mendoj se ky zakon është i dëmshëm dhe duhet ta luftojmë.

— I dëmshëm është, por jo edhe aq. Dëmtohen vetëm femra, pa tjetër njeri nuk dëmtohet.

— Këtu e kam fjalën edhe unë, — tha Rina. Nëna qeshi, por kësaj radhe si me pahir, se ju kujtuajeta e saj.

...Ish çupë në të katërbëdhjetat, kur vdiq gjyshi, dhe u vesh me të zeza. Marigoja që çupë e hedhur dhe i pëlqente shumë kënga e vallja. Por ajo për disa vjet nuk mori pjesë në këngë dhe në valle. Tri vjet ndëjtë e veshur e tëra në të zeza dhe tri të tjera duhej të rrinte vetëm me shami por fati e desh që të mbante shaminë vetëm një vit, pasi u bë sebep martesa e vëllait të madh për të dalë nga zia. Shpejt u martua dhe Marigoja. Por ja, në krye të gjashtë muajve nuse, në shtëpinë e Vasil Galës ra një vdekje. Një nip i tyre, diku në kurbet, u vra në një minierë, Marigoja-veshi përsëri rrobat e zeza. Në të mbaruar të zisë, vdiq babai i Vasilit, që i kishte kaluar të shtatëdhjetat. Rinia e Marigos u ngrys në të zeza. Shpesh ajo qante sepse nuk mund të qeshte, të këndonte e të vallëzonte, si shoqet. Pastaj pllakosën vdekje me radhë dhe ajo u plak në të zeza.

Këto ja tregoi edhe Rinës, duke shtuar:

— S'ke ç'bën, moj bijë! Kështu janë zakonet e vendit.

Rina filloi të tregojë se edhe ky zakon ishte i lidhur me zotérinjtë dhe me priftérinjtë që e shfrytëzonin për interesat e tyre.

— E pamundur, — u hodh Marigoja.

— Dëgjo, nënë. Edhe unë ashtu mendoja në fillim, por më vonë u sqarova për këtë. Vetë pleqtë e plakat e fshatit më treguan se... Ja dëgjo:

— Tërë fshatrat e krahinës, edhe Bregasin, i kishin çiflik Vrionët. Njëri nga djemtë e bejlerëve, nië farë Iljaz beu, hipur në kalë, kishte arritur në Bregas në një ditë vere e thatësire që s'mbahej mend. Qe e djelë dhe tërë fshati ishte mbledhur në dasmë. Dasmë i thënçin, se Kristo Ziu që martonte djalin s'kishte me se t'i gostiste shokët e miqtë. Por ata ishin mbledhur dheçoq kishin sajuar për t'ja mbushur shtëpinë me gaz Kristos që martonte djalin e parë.

— Pse nuk punojnë! qafirët? — kish klithur Iljaz beu. — Ata më duan të keqen!

Dhe pastaj u ishte drejtuar qehallarëve e xhandarëve që e shoqëronin:

— Shpejt, mblidhni fshatin! I thërrisni këtu bujqit e mi. U përvëlua misri. U tha toka dhe ata këndojnë, gëzojnë! Do t'i le pa kokrrën e drithit, për Zotin! Do t'i lë të ngordhin urie!

Ata kishin vrapuar në oborr të Kristo Ziut, se atje bëhej dasma, nën hijen e pemëve, pasi kassollja prej kashte ishte e vogël dhe nuk i nxinte. U bë zhurmë. U përleshën qehallarët e xhandarët me bujqit. Zënka nuk zgjati shumë dhe në oborr erdhi vetë beu i shoqëruar nga urata, Leksi.

— Mirë se na urdhëruat, zotërinj, — u tha Kristua.

— Të trashëgohet djali, me këmbë të mbarë nusja, — uroi prifti.

Beu i tërhoqi zvarrë fjalët e thata dhe shtoi:

— Mirë, o të bekuar, dasmë dasmë, por e shihni thatësirën?

— Ja, zoti na ka marrë me sy të keq, — u tall njeri nga të rintjtë.

Urata e shikoi vëngër:

— Po zoti thotë: «Ju mundohuni për një dhe unë ju jap dhjetë»

— Nuk të kuptojmë, uratë — u dëgjuan zëra.

— Urata thotë se duhet të bëni përpjekje që të mbushni ujë me fuçi, se do vijnë të korrat dhe unë nuk mund t'ju mëshiroj gjithnjë. Do ngeleni pa gjë. Të shkoni në kënetë. Merrni ujë atje. Me se? Me krahë, me krahë. Ju jeni dembelë. Përfitonit nga urtësia jonë.

Urata i hodhi sytë rrëth e rrotull nga ishin dasmorët, të veshur me rroba të arnuara. Dhe i bëri përshtypje që edhe gratë e veshura me të zeza kishin shkuar të dëgjonin këngë e të hidhnin valle.

— Urdhëroni në këtë rrugoz, zotërinj. Me këto që kemi, — i ftoi Kristua.

— Ne do të ikim, — ja mori fjalën nga goja uratës beu. — Nuk kemi nge të merremi me dasma, kur po na luan tepeleku i kokës nga vapa e thatësira.

... Megjithatë, atë natë beu vendosi ta lërë vilën dhe plazhin e Durrësit ku e prisnin miqtë e shokët e qëndroi në Bregas. E kaloi natën te ura-

ta, që thonë se kishte raki rrushi të zier dy hërë, verë dhjetëvjeçare dhe mjaltë zogash.

Rrëkellyen gotë pas gote dhe kur beu u' bë çakërqef, urata tha:

— Bej! Edhe unë kam filluar ta kem pisk me këta qelbanikë. Njëqind pengesa më nxjerrin për të më dhënë pjesën që i takon kishës. Po të mos ishin gratë që besojnë më shumë, do të kisha vdekur. Ke parë ti bej? Sot u binda, se po na i prishin zakonet. Kjo është në dëmin tonë. Ç'donin gjithë ato gra e vajza në dasmë?

— Po, hë, si thua ti, uratë?

— Si the?! Të bëj një meshë për dhembjen e shpirtit. Ja kështu. — E urata filloi të flasë, sikur ishte në kishë e para tij qëndronin besimtarët:

«Të bekuar dhe të bekuara! Po humbni mendjen, po humbni shpirtin. Nuk keni dhembje për ata që kanë shkuar në botën e përtejme. Turp, turp për ju gra e vajza që me futa në kokë shkonë e merrni pjesë në gaz. Ju duhet të duroni dhembjen në shtëpi, përndryshe edhe zoti nuk do t'ju mëshirojë. Mëshira dhe besimi kanë një gurrë, një burim. Si u bën zemra moj nuse, motra, nëna që akoma pa mbushur pesë vjet nga vdekja e të dashurve tuaj, të këndoni e të hidhni valle? Është njëlloj si të këndosh, si të dëgjosh! Kthehuni në rrugë të mbarë, o të bekuara! Dëgjojeni zërin e zotit. Kini dhemshuri! Kini besim! Ju, duke duruar vuajtjet shpirtërore, do të siguroni këngën, gazzin dhe qetësinë në botën e përtejme. Kënga dhe gazi këtu janë të rreme. Mbani veshje të zeza e vuani në këtë botë që të visheni me të bardha e të gëzoni në botën tjetër.»

Beu ja shkrepri një të qeshure prej të piri.

— Po ç'lidhje kanë futat dhe këngët e vallet me hallet tonë, o uratë?

— Ju jini me shkollë, bej, e kuptioni vetë. Duke u mbledhur, duke gëzuar e biseduar edhe grave u hapen sytë. Dhe po e harruan zotin, neve na përlanë. Po t'u hapen sytë, nuk do të vonojë dita kur edhe ty, edhe mua do të na venë drunë. Gratë duhet t'i mbajmë nën kurthin e fesë, t'ua lidhim këmbët me zakonet, përndryshe mbaruan.

— Ha-ha-ha! — u gajas së qeshuri beu:

— Je edhe diplomat, uratë! Mirë e ke menduar! Unë nuk u thellova fare.

Dhe hapi portofolin e i lëshoi në prehër një tufë me napolona.

— Për urtësinë tënde, për meshën e bukur që do të japësh.

— Brom bej, mirë se na urdhërove.

Rina heshti dhe shikoi t'ëmën.

Nënë Marigoja ja kishte mbërthyer sytë Rineshë dhe kishte humbur në mendime.

— Moj, po ku i ke mësuar të gjitha këto? Më ngjan se edhe unë i di, po, janë të vërteta. E mëaj mend edhe unë dasmën e Kristo Ziuat atë verë me thatësirë të madhe. Kam qenë edhe unë në dasmë, kur erdhi beu me uratën. Mbaj mend edhe meshën e uratës kur foli për futat dhe për zinë e grave, për dhembjen e shpirtit, për botën e përtejme...

— Ashtu është, nënë! Edhe ky zakon ka lidhje me klasat shfrytëzuese. Duke u ndrydhur, duke u mbyllur në shtëpi, gratë e vajzat e veshura me të zeza, nuk gëzojnë, nuk e shijojnë jetën, bëhen të zymta. Në fund të fundit: duke mos e njoqur jetën dhe të vërtetë ato mbeten skllave të fesë.

Rina e entuzizmuar se faktet e saja ishin bindëse, u ul të shkruajë skeçin, «Futa, urata dhe beu i fshatit tonë».

U lodh jo një natë e dy, por disa net. Kërkoi edhe ndihmën e shoqeve e të shokëve.

Në numrin e ri të estradës, që u dha në shtëpinë e kulturës të Bregasit, kishin ardhur shumë gra e vajza që ishin veshur me të zeza. Skeçin për futën e zezë ato e aprovuan duke qeshur dhe me duartrokitje. Por ky skeç la mbresa dhe hapi diskutime. Gratë dhe vajzat propozuan t'i heqin fare rrobat e zeza, të mbajnë vetëm një shenjë dhe këtë për një kohë të shkurtër.

LUGINA E NUSEVE

Ish fundi i majit. Kisha mbetur vetëm në dhomën e beqarëve. Dy shokët e mi kishin shkuar në shtëpitë e tyre për pushimin e së djelës. Isha shtrirë në krevat dhe po lexoja me vëmen-dje një libër me vjersha.

Trokiti dera. Ishte postjeri.

— Më falni, shoku mësues, kam një rekoman-de për ju; — ai më zgjati letrën si gjithnjë pa thënë gjësendi dhe në sytë e tij nuk mund të dalloje as më të voglin shqetësim. Postjeri ynë është njeri i thinjur në profesion. Letrën ma dërgonte miku im Dan Trimata nga një fshat rë veri. Brenda gjeta një ftesë martese të shkruar me shaptilograf dhe një letër të shkurtër. Dani më kujtonte, në mes të tjerash, një bisedë të kohës kur ishim studentë. Atëherë ne patëm prem-tuar se do të ishim për njëri-tjetrin «krushk i parë». Dhe unë vendosa të shkoj.

\* \* \*

Ai qytet në veri është i vogël, por të ar-dhmen e ka të madhe. Kjo gjë më ra në sy me-njëherë, ashtu si i ndodh çdo njeriu kur vete për

të parën herë në një qytet të vogël si ky. Pasi hëngra drekë dhe ngjita ngadalë shkallët e hotelit u shtriva të pushoj gjer sa të vinte ora e nisjes së autobuzit për në fshatin e Danit. Kisha dëshirë të bisedoja me dikë ose të lexoja. Por në dhomë s'kish ardhur ende njeri dhe libra s'kisha. Kur po shikoja nga dritarja pashë Danin. Hapa dritaren.

— Dan! — i thirra. Ai u ndal. Shikoi rrëth e rrotull. Më pa. Tundi dorën i gjëzuar sakaq, dhe si një fëmijë u lëshua me vrap drejt hotelit. Hyri në dhomë tërë vrull dhe u takuam si dy miq të vërtetë.

Në mbrëmje vonë po ecnin me Danin nëpërmes një monopati me lisa e prozhme. Yjet ndriçonin si sytë e Dan Trimatës dhe dritat elektrike na tregonin se fshati nuk ish larg. Pas pak arritëm.

Më vonë kur kishim rënë në shtresa në odën e miqve, Dani më tregoi se të nesërmen që pa gdhire do nisesha me krushqit për të marrë nusen. Në odë ishin edhe dy të tjerë. Ishte vonë, shumë vonë. Në orën katër të mëngjezit do nishim me autobuz. Jashtë në pistën e blertë dëgjoheshin tingujt e lehtë të fizarmonikës dhe këngët e dasmorëve.

— E, s'të zë gjumi? — më pyeti Dani që kisha pranë.

— Jo, po ty?

— As mua, a dalim jashtë? Është natë e bukur...

U ngritëm e dolëm duke zbritur me ngadalë shkallët. Kaluam nga porta kryesore, dolëm në

monopat te çezma dhe e ndjemë freskinë e natës një fshat.

— A shkojmë të pijmë kafe tek gjyshi? — më pyeti Dani.

Shikova në horizontin e bardhë yjet e zbeh-të. Pse mos të pinim kafe? Koha për t'u nisur po afronte. Shkuam te gjysh Mahmudi, kështu e quanin. Ai pikte kafe pranë vatrës. Ish krejt i bardhë ndër flokë e mustaqe. Vetëm mjekër s'kish.

— Miku yt? — pyeti Danin. — A je, bir, si je? — ai lëvizë me shkathësi dhe mua m'u duk se nuk kish më shumë se gjashtëdhjetë vjeç. Më vonë mora vesh se ky gjysh Mahmudi lëvizte mbi shpatullat e tij njëqind e dy vjet të tëra. Ai kish marrë si detyrë kafenë për ato net. Pikte e bluanente kafe aty në dhomën përdhese pranë oxhakut.

— Dridheni nga një, sa t'ju vloj kafetë — tha gjyshi e më zgjati kutinë.

— Ma jep ta vloj unë gjysh! — ju lut Dani.

— Kur të martohem unë, bir. Tani e kam radhën vetë — qeshi ai e ju duk goja pa asnë dhëmb. Nën vetullat kaleshe dy sy të lëvizshëm dukej se më studjonin me kujdes.

— Është larg Ahishta? — e pyeta unë.

— Jo, tej Luginës së Nuseve, një vrap pele. Unë e shikova me kërshtëri.

— Nja katër orë — më sqaroi Dani.

Gjyshi më vrejti me kujdes dhe vrenjti vetullat e puliti sytë e gjallë nën to. Ndoshata ai e kuptoi menjëherë se mua më bëri përshtypje emri i Luginës. Ndoshata me qëllim e nxori atë. Pleqtë ndjejnë kënaqësi kur tregojnë e ritregojnë ato që dinë. Sidoqoftë nuk munda ta kuptoj në donte të më fliste apo jo.

— A ka shumë kohë, që quhet kështu, gjysh? e pyeta.

— Ka do kohë. Ka. Ka që kur isha unë dymbëdhjetë vjeç, foli i qetë ai.

— Nëntëdhjetë vjet më parë — tha Dani. Na e kallzo qysh, ta dëgjojë edhe miku.

Gjyshi heshti, balli ju rrudh shumë. Trazoi prushin dhe dukej sikur do ndizej i téri me flakën e shkëndijëzavet që dilnin, dukej sikur do të ndriçonte thellësinë e vjetëve të shkuar, kur ai ish dymbëdhjetë vjeç djalë.

— Ish kohë tjetër atëhere, bir... ja nisi ai duke na mbushur filxhanët me kafe... — Tutje tëhu shëtitnin tabore të turkut, por ne pushkët s'i lëshonim. Një herë po bëhej një dasmë në fshatin tonë. Martohej djali i një fukaraji. Nejse, u mblodhëm farefis me miq e dashamirë. U therr një dash e u therr një viç, e u derdh edhe rakia. Tani rinia i quan gjepura këto... po ne i bënim... S'kish gëzime të tjera.

Të nesërmen, pa filluar çerçeri këngën, pesëmbëdhjetë trima ndër kuaj atllarë, me pushkë ndër krah u nisëm pér tek nusja. Më morën edhe mua. Një djalë i vogël e tërheq gjithnjë kalin e nuses tek ne. Thonë pér mbarësi...

Kaluam kodrën matanë fshatit fqinj. Zbritëm bregut të lumit mes shkurresh e konopicasë pér të dalë ndër vahna. Ish vjeshtë e parë dhe lumi s'kish dalë shumë. Kaluam luginën e Trëndai-lave, që tani quhet Lugina e Nuseve dhe më në fund arritëm në fshatin e nuses. Atje na pritën mirë, si e desh zakoni, dhe ne nuk ndenjëm shumë.

Të gjithë trimat ecnin më këmbë. Vetëm nus-

ja ish kaluar mbi një at tē bardhë, që ecte serbes.  
Po i afroheshim Luginës.

— Shikoni, burra! Një nuse po zbret matanë Luginës — thirri njëri nga trimat. Burrat vërejtën me kujdes, por kuajt s'i ndaluan. Më trimi mes tyre shtrëngoi pushkën dhe ma mori frerin e nuses nga dora dhe i tha një plaku tē më vinte në kalin e fundit. Plaku e bëri syrin pishë në drejtim tē malësorëve matanë, më tërhoqi për dore e menjëherë më hodhi mes dy arkavet tē pajës mbi kalin e fundit. Pastaj ai shpejtoi në krye tē dasmorëve.

Ruga e Luginës së Trëndafilave ish një shesh më fort i gjerë se i gjatë, i mbuluar, me bar e nga tē gjitha anët rrrethohej nga një pyll i imët. Ish një mrekulli e natyrës që më vonë u pre e u shkretue deri në çlirini e sot është tokë e punuar. Ata dolën atje mes lisash, ne këndejej. U dëgjuar krisma e thatë, tronditëse e pushkës matanë.

— Duan rrugë, burra! — foli plaku.

— Ja hap unë rrugën, — thirri ai trimi që mori frerin e nuses. Me dorën që kish tē lirë, e ngriti armën dhe krisi dy herë me radhë.

— C'bëre? — e pyeti plaku. Por ai nuk u tërroq. Vargu vazhdonte pas tij.

— Mbushni armët, burra! — u bëri zë ai krushqve tanë, tē cilët nën ankthin e krismave, i kishin mbushur pet-pet.

— Lironi rrugën — u dëgjuar një zë andej.

— Kanuni është me ne! — ju përgjegj me britma trimi që na printe. Ajo britmë ende sot më duket se jehon dhe e dëgjoj kur kaloj andej. Qëllon që njeriut i mbetet vrragë e pashlyer për jetë gjurma e një çasti. Kështu edhe mua.

— Jo, kanuni është me ne — shau ai që tërhiqte nusen tjetër dhe shtiu në drejtimin tonë. Plumbi mori prijësin tonë në krah.

— Bini, burra!... Plumbin burra! Nderin fisi — thirri ai. Për një çast dasmorët u ndaluan nga të dy anët. Një çast, vetëm një e çon peshë njerinë. Ashtu si ishim më këmbë, e morrëm veten. Nusja qëndronte kaluar, pak e mënjanuar. Unë, që isha afiuar me kalin tim të pajës, e dëgjoja atë tek qante. Pushka filloi. Plaku që më hipi në kalë e afroi atin tim më pranë nuses.

— Bir, kujdes nusen, ta çosh tek shtëpia gjallë o vdekur, se ta sjellë puna.

Pushka u bë më e fortë. Si ortek këpuntej e binte trimi aty mbi barin e gjelbër në lug të hapur nën rrezet e diellit vjeshtarak. Ata u kositën si bari në livadh. Nga ata kishin mbetur edhe dy, nga tanët vetëm plaku, nusja dhe unë. Pak hapa më tutje ish rrëzuar i mbytur në gjak nga plumbat një kalë. Pas tij ish plaku. Unë e shikoja atë nën tmerrin e plumbave që férshëllenin dhe nguleshin rreth e rrotull tij. Unë e shikoja me frikë. Po atij s'ja bënte syri fërt. E si të thashë, njëri nga ata që gjuante atje tej, shtiu mbi nusen tonë. Plumbi kaloi me ulurimë të mprehtë pranë veshëve të mi. Unë klitha, kali i nuses kërceu i trembur. Plaku thirri me zë të fortë nga vendi i vet:

— Gratë nuk janë qëlluar ndonjëherë, or këlysh! — dhe martina e tij shprazi flakë e tym.

Ai që shtiu matanë nuk lëvizi më. I fundit prej tyre u ngrit më këmbë dhe po ecte me pushkë të gatshme e me turr drejt plakut. Unë e shikova plakun me llahtar. Ai e mbushi shpejt e

shpejt martinën. Në gojë mbante një thikë. Ajo pamje më ngjalli frikë në shpirt, se isha fare i vogël, i mitur. Nusja jonë hoqi vrik duvakun dhe kërceu nga kali e rrëmbeu armën e një trimi të vrarë aty afër. Plaku u çua më këmbë. Mori nishan. Tre shprazën njëherësh. Ai trimi i ri u lë-kund, e drejtoi armën nga nusja, por këmbët s'e mbajtën dhe ra mes fushës duke e shprazur në erë armën që i ra në tokë. Ktheva kokën nga plaku. Një përrua gjaku i zbriste mbi ballë, mbi sy. Rrinte në një mënyrë të quditshme. Hoqi thikën me mundim nga goja dhe e hodhi tutje. Shikoi nga ne. Por sytë nuk u ndaluan tek unë. Ndoshta kërkonte nusen. Fshiu gjakun me krahun e këputur nga mundimi. U duk sikur qeshi. Pastaj ra. Nusja vrapoi tek ai. Hoqi një shami të bardhë nga koka, nisi t'i fshijë gjakun e u ngashërye.

E gjithë kjo ndodhi aq shpejt, sa nuk më kuitohet koha. Në raste të tilla, bir, një çast të duket një shekull dhe të thinj. Matanë Luginës pashë nusen e tjetrit që ktheu atin pér në shtëpi të vet pa asnjë shoqërues. Unë e nusja jonë i kthyem pér së mbari trimat tanë dhe, pasi i lidhëm kuajt e shëndoshë njërin pas tjetrit, u drejtuam pér në fshatin tonë. Kur kaluam vahnat, pamë fshatarët tanë të armatosur, që u turrën drejt Luginës. Matanë vahnave ne pamë edhe një herë nusen e tjetrit tek shkonte vetëm andej nga erdhë.

Të mirrte vaji kur shikoje në oborrin e shtëpisë gra me sy të mavjosur që as këndonin e as qanin. Nusen e morën gratë. Mua më mbytën me pyetje. Eh sa herë e tregova atë ditë historinë e Luginës!

Kur u kthyen trimat andej, njëri syresh më pyeti:

— Ç'tha plaku së fundi? Ç'tha?

Unë ja përsërita fjalët që tha plaku, kur kundërshtari qëlloi në drejtim të nuses.

Që nga ajo kohë i ka mbetur emri «Lugina e Nuseve», or bir. Asokohe ka pasur zakone të forta, ligje s'kish. Zakonin e zbatonin të gjithë, edhe zakoni sillte gjëma të mëdha. Merre me mend si vazhdonte të rridhte gjaku nga brezi në brez!. . Zakoni ynë e kërkonte që po të lëshoheshin dy nuse, do të lëshonte rrugë ajo që e kish shtëpinë më afër. Pra atyre ju takonte të lëshonin rrugë jo neve. Por ata nuk deshën, gjaku u nxeh dhe zakoni bëri punën e vet.

Gjyshi psherëtiu. Sytë e tij të shkathët nën ballin e ngrysur ishin fshehur sikur kërkonin ende kujtimet e kohës së shkuar. Tërhoqi xhezvenë nga prushi. Na shtiu përsëri kafe.

— Kështu ishte një herë e një kohë. Kohë e zakone, i thonë një fjale. Ato ikën e vanë. Po neve s'na harrohen. Pini, pini kafetë, se u bë ditë. Ato, zakonet e gjakut, mos u kthefshin më!

Unë kisha mbetur i zhytur në parafytyrim si në një ëndërr të keqe. E tashti m'u duk sikur u zgjova nga fjalët e fundit të gjyshit të Dan Trimatës. Ktheva kokën pas dhe pashë se kish zbardhur. Në oborr krushqit po lanin sytë e po bënin shakara me njëri-tjetrin. Autobuzi i veshur me vesë, qëndronte në cep të oborrit pranë një kumbulle stolisur me lule të bardha. Dolën disa gra që mbanin ndër duar sixhade e shamija me ibrisime. Ato filluan të zbukuronin autobuzin e vo-

gël. Unë u shpiva. U ngrita e dolëm tok me Danin.

\* \* \*

Fizarmonika e gëzuar përhapi tingujt e një melodie të gjallë të shpejtë, të shkathët. Auto-buzi, mbushur plot e përplot me dasmorë çau mes luginës së gjelbëruar nga gruri. Nga dritarja, tok me tingujt e këngës së rinisë, kalonin lapidarë të bardhë me yje e pa yje të kuq. Motra e Danit nuk pushonte së treguari për ta. «Këtu thyen qafën kaq mijëra okupatorë... Këtu dëshmori i punës... këtu çeta jonë kreu aksionin e parë... këtu u vranë prej fashistëve patriotët... këtu... Po unë isha zhytur në mendime dhe mezi i kapja këto biseda të shpejta të saj. Shikoja luginën përrpara. Ajo ish e dallgëzuar si janë tokat zakonisht në zonat malore, e blertë, e blertë nga gruri.

Kënga e fizarmonika gjëmonin. Motra e Danit thirri me zë të lartë:

— Kurse kjo lugina këtu quhet «Lugina e Nuseve»!

Unë e shikova me vërejtje. Kushedi ç'lexoi në sytë e mi. Pastaj të dy shikuam Luginën e Nuseve. Në të valvitej gruri i blertë. Të gjithë këndonin dhe askush, përveç ne të dyve, s'mendonte mbi historinë që ruan në gji kjo luginë...

«SHËNJTORJA E SHPATIT»

Ora kish kaluar nga nëntë. Babai nuk po dukej, ishte në mbledhjen e këshillit popullor të fshatit. Marina mendoi se kishte dhe disa fletore hartimesh, që duheshin qortuar.

Ajo u ngrit shpejt dhe u drejtua për në tryezën e punës. E filloi korigjimin me hartimin e Petros. Ai kishte zgjedhur temën interesante «Si u kthye Kisha e Gjinarit në shtëpi kulture». Mendimet i kish rrjeshtuar bukur.

«Kisha... Feja... «belbëzoi me vete Marina dhe padashur mornicat i kaluan nëpër trup; si atë ditë, kur nga tribuna e kongresit kishte folur për veten e saj e me qindra sy e kishin ndjekur me vërejtje, sikur donin t'i thoshin: «Edhe këtë s'e kishim dëgjuar!» Ç'përbindësha paskëshin qenë ata, që menduan një gjë të tillë?...»

E tek rrinte ashtu e menduar mendja i fluturoi shumë larg, në Tiranë, e cila i qe bërë më e dashur pas atyre ditëve që kishte marrë pjesë në kongres. Mbresat që i kishte lënë kongresi e kishin pushtuar me një forcë të tillë, që as ajo vetë nuk dinte si t'i spjegonte. Edhe në orën e mësimit, padashur, sillte ndërmend sallën, ku u mbajt

kongresi, nga tribuna e së cilës shumë gra kishin thënë fjalën e tyre të zjarrtë, të ngrrohtë e të gjallët: sillte ndër mend ato qindra duar që zgjatëshin me një mirënjojje të thellë e të pakufishme për të shtrënguar fort duart e mësuesit dhe të udhëheqësit të tyre të dashur, Enverit; sillte ndër-mend shoqet e saj, me të cilat qe miqësuar aq shpejt në kongres, e kish përshtypjen se kujtimet që e lidhnin me disa do t'i mbante tërë jetën me gjithë shkëlqimin e tyre. Shpesh në orën e mësimit, në rrugë, në shtëpi ndërsa merrej me ndonjë punë, i vinte sikur dëgjonte zërin e ëmbël e përkëdhelës të një shoqes që e njoihu në kongres që i thoshte:

— Shenjtore e Shpatit! — e që pas këtyre fjalëve gajasej së qeshuri e ajo i përgjigjej me buzën në gaz:

— Mjaft de, mos u tall, se më more mendt me këtë «Shenjtore e Shpatit».

Ai zë e solli përsëri në vete. Qeshi me veßen e saj dhe vuri re se kish dremitur gjatë kohës që mendja i kish fluturuar në Tiranë.

— Jam e lodhur — belbëzoi — e babai nuk është kthyer ende nga mbledhja.

Desh të vazhdojë qortimet e nxënësve, po qepallat i rendoheshin e koka i varej poshtë rën-duar nga gjumi.

Dikush trokiti në derën e jashtme. Marina erdhë në vete dhe u ngrit me të shpejtë si të ish zgjuar nga një gjumë i lehtë dhe i këndshëm.

Së bashku me të në dhomë hynë babai dhe një i panjohur.

— Shoku ka ardhur të shkruajë për ty — i tha ai Marinës, kur ajo, po i jepte dorën mikut që porsa ishte ulur.

Marina nuk foli. I hodhi një vështrim të shpejtë atij që kish ardhur për të shkruar për të, sikur donte ta peshonte dhe mendoi me vete: «S'e kuptoja pse u mundua gjer këtu, kur mund të më takonte në Tiranë?» Po atij s'i tha gjë. E pse t'i thoshte? «Fundi ai e di më mirë punën e tij, arësyetoi duke shkuar në dhomën tjeter, që të merrte tabakanë me të cilën do të qiraste mikun.

Gjatë atyre pak minutave Marinës i shkuani ndër mend dhjetra pyetje që mund t'i interesonin të porsaardhurit. «Mos do që të dëgjojë nga goja ime historinë e «Shenjtores së Shpatit?» pyeti ajo veten. «S'e besoj. Këtë e thashë në kongres... Po atëhere?»

— Marinë! — foli pas pak i ati — Shoku interesohet për jetën, për fëmininë tënde...

Asaj i kaluan të ngjethura nëpër trup. As ajo nuk e kuptonte pse ndjente një dhëmbje të thellë, kur kujtonte atë ngjarje të vërtetë, diçka poshtëronjëse dhe të ulët, një farë neverie rrëth asaj historie të fëminisë së saj. E prà ajo nuk kish asnijë faj. E ç'faj mund të kishte një foshnjë? E ç'mund të dijë një foshnjë, përvèç se të buzëqeshë e të lozë doçkat? Pó foshnjëria e saj ish lidhur me një histori sa të çuditëshme, aq edhe të pabesueshme. Ajo e kish provuar në trupin e saj të njomë gjithë atë dramë të tmerrshme e poshtëronjëse që ish zhvilluar, pa kuptuar ajo vetë gjë, se ish ende e vogël, shumë e vogël që të mund «të shihet» atë rrëth «hyjnor» të ndritshëm, që i «kish zbuluar» kokën.

Ajo e tregoi edhe një herë historinë e saj, historinë e «Shenjtores së Shpatit».

\* \* \*

Prifti i fshatit të Shpatit kish parë në ëndër sikur një shenjtor i kishte sjellë një dhuratë. Shenjtori, duke ja dorëzuar dhuratën, i kish pëshpëritur: «Shpatin do ta gëzojë i plotfuqishmi! Urata e kishte shtrënguar me të dy duart dhuratën e shenjtëruar. I dërguari i zotit kishte ikur, por ç'të shihte urata? Në duar i qe shfaqur një foshnjë e zbehtë, e qetë dhe e urtë, me një rreth të ndritshëm në kokë. Uratës së mënçur i kishte vajtur mendja te rrësimet e fesë: foshnja e ëndrrës paralajmëronte se në atë krahinë një fëmijë do të shenjtërohej. Kaq thoshte urata se mbante mënd nga èndra që s'ish veçse trillim i tij.

Atë natë që urata kishte parë këtë ëndër, në shtëpinë e Sif Bukanikut asnjeri s'kishte mbyllur sy. Atë natë të ftohtë marsi, e kishin gdhirë si ai ashtu dhe e shoqja, Dafina. Marina, çupa e tyre, ishte e sëmurë, qante dhe nuk lëvizte nga vendi.

— Ta çojmë te doktori? — belbëzcnte Dafina.

— Ç'doktor, moj! Shkojmë tek urata. Ai është i ditur edhe në punë të besimit, edhe në punët e doktorit.

Gruaja, duke gjalltitur lotët në heshtje, me t'u gdhirë mbështolli çupën me një copë shajaku, e mori në krahë dhe u vu pas Sifit.

Pa kapërcyer përroin që ndante arat e uratës, qentë filluan të lehnin. Dafina u step. Sifi i dha kurajo.

Pas një copë here, në dritaren me kapak prej dërrase, të punuar nga një dorë mjeshtri, nxori kokën një djalosh. Ishte lopçari i uratës.

— Hape, Petro, se kemi vajzën keq! — i bëri zë Sifi.

Djaloshi doli në krye të shkallëve. U hapi portën dhe u tha të prisnin sa të zgjohej urata.

Ndenjën ndonjë gjysëm ore në krye të shkallëve gjersa u duk prifti.

Sa e panë burrë e grua bënë kryq. Urata u tha:

— Pse kini ardhur kaq shpejt?

— Na fal, uratë, por çupa...

— Hajdëni, shpejt. Qenki njerëz të lumtur, prindër të nderuar. Ngjituni lart, në dhomën e pritjes! — dhe në çast iu kujtua t'u fliste përën-drën.

Urata e rrëmbeu Marinën nga duart e Dafinës dhe u priu. Ai e vuri çupën në një velenxë shajaku dhe pasi e pa që nuk e shëronte dot, u tha prindërve:

— Zoti ju paska në zemër. Ai ju ka nderuar juve si pindër. Librat e shenjta thonë se në çdo 1000 vjet në këto anë shfaqet një njeri i shenjtë. Bile, t'ju them të drejtën, sonte nuk më ka zënë gjumi fare. Pashë ëndër sikur Zoti na dhuroi një foshnjë të shenjtëruar. U ngrita, hapa librat dhe mësova se një gjë e tillë duhej pritur. Për këtë më paralajmëroi i dërguari i zotit që m'u çfaq në ëndër. Dhe erdhët ju. Çupa juaj është shenjtoreja jonë, e tërë Shpatit. Mos vononi, bëni gati shtëpinë se do ta marrin vesh të gjithë dhe do të vinë të takojnë shenjtoren.

Sifi me Dafinën dëgjonin si të shushatur: ishte apo nuk ishte në vete urata? Prifti nisi t'i sqarojë.

— Merreni çupën, o të bekuar! Cojeni shpejt

në shtëpi dhe ruajeni nga djajtë se ndryshe na dënon Zoti, qoftë lëvduar. Nisuni shpejt, mos njoftoni në infermieri, asgjékundi! Ja, unë po vishem shpejt dhe po lajmëroj priftërinjt e zonës.

Urata tha këto fjalë dhe iku në dhomën tjetër. Sifi rrëmbeu në krah «Shenjtoren», e puthi në ballë dhe i priu Dafinës për në shtëpi. Fjalët e priftit e bënë punën mirë: prindërit besuan se vajza e tyre, Marina, do të bëhej shenjtore.

Rrugës e pyesnin shokët se ç'kish çupa, por ai i ngrysur dhe i zverdhur, u përgjigjej:

— Asgjë! Ishte ca e pamundur, por tani u shërua!

Dhe shpejtonte hapat, që të mos hynte në bisedë me njeri.

... Tërë atë ditë, Sifi me Dafinën nuk ishin në vete. Për gjendjen e çupës nuk po bëheshin më merak. Në kokë, secili në heshtje, bluante fjalët e priftit. Punonin, rregullonin shtëpinë si përfestë.

Sifi mblodhi edhe ato lekë që kish dhe u derdhë në dyqanin e fshatit fainjë për të blerë sendet e nevoishme. Në atë kohë tre priftërinjtë e kishave të Shpatit u zbritën kuajve në oborrin e «Shenjtores». Hynë me këmbën e djathtë, në dhomën kundodhej Marina, bënë kryq dhe u përkulën përparrë trupit të tretur të vogëlushes. Si ata, bëri edhe Dafina.

— Duhet bërë një sënduk për «Shenjtoren», — tha njeri nga priftrinjtë.

— A vonohet Sifi?, — pyeti tjetri.

S'kish mbaruar akoma fjalën, kur i zoti i shtëpisë hyri në dhomë.

— Mirësenaurdhëruat! — i përshëndeti.

Ata e këshilluan Sifin të bënte kryq dhe të përulej kur të hynte në dhomë se që tanë e tutje ajo nuk ishte më çupa e tij, por njeriu i zotit», «Shenjtorja» e maleve të Shpatit.

...Të nesërmen që pa gdhirë, shpatarakë, nga fshatra të ndryshëm, që nga Selta, Zavalina dhe Shelcani, ishin nisur për të parë «shenjtoren».

Shpatarakët bënин kryq dhe para se të largoheshin e dorovitnin «Shenjtoren», kush me para, kush me ndonjë gjë tjeter. Pranë sëndukut qëndronin të tre priftrinjtë, kokulur dhe të përvuajtur, me kryqet e varur në gjoks.

Për të takuar «Shenjtoren» erdhën në shtëpi të Sif Bukanikut gra që nuk lindin, shurdhër e memecë. Ata bënин kryq dhe thoshin nga dy uratë përpara Marinës, që sa vinte tretej.

Sifi me Dafinën e kishin humbur toruan. Fjalët e priftrinjve se ata do të ishin të lumtur pas vdekjes, sepse «Shenjtorja» Marinë që ditën e vdekjes do t'i priste me buqeta lulesh... i bënë të harrojnë çupën e tyre.

Edhe ditën e katërt priftrinjtë e panë të udhës të bëheshin vizita te «Shenjtorja». Në dardkë, kur po «sistemonin» paratë dhe gjërat e dorovitura nga besimtarët (Sifit i dhanë aq sa të përballonte shpenzimet, kurse të tjerat shkuan «në dobi të kishës») të tre priftrinjtë vendosën: Marina e «Shenjtëruar» duhej varrosur.

U kujtuan prindërve të Marinës legjendën e pavdekshmërisë së «shenjtorëve» prandaj u tha në se ajo duhej varrosur përsëgjalli. Menduan të zbresin një njeri në qendër të lokalitetit për të marrë lejen e varrimit për «të vëekurën» dhe për-

hapën lajmin se «Shenjtorja» kërkonte prehje, qetësi!

Deri këtu gjithçka kishte vajtur mbarë. Por përpëra se priftrinjtë të shpërndaheshin, në shtëpinë e Sif Bukanikut erdhi një mjek nga qyteti, bashkë me ndihmësmjekun e krahinës. Ata i kish lajmëruar mësuesi i fshatit.

— Pse nuk ke njoftuar se vajzën e ke të së-murë, o Sif? — e qortoi ndihmësmjeku të zotin e shtëpisë.

Në vend të Sifit njeri nga uratat tha:

— Dilni, jashtë. «Shenjtorja» kërkon qetësi!

— Mirë, mirë, ta vizitojmë njëherë, pastaj për qetësinë e saj kujdesohemi ne, — u përgjegj mje-ku.

— Mos u afroni se zoti do ta gjuajë me rrufe këtë truall, — bërtiti urata i dytë.

— Shoku Ali, ju qëndroni, se unë po shkoj të marr shokët e këshillit popullor të fshatit, — tha ndihmësmjeku dhe bëri të ngrihei.

— Muhamedan qenka doktori? Jo, nuk lejojmë ta prekni «Shenjoren», — tha prifti i tretë.

Doktori u përpoq t'i bindë prindërit e Mari-nës. Ai u tha se kishin rënë në kurthin e gënjeshtës dhe për qëllimet e errta e të ulta të klerikëve reaksionarë, po sakrifikonin fëmijën e vet.

— Edhe në qoftëse je verbuar, Sif, ne nuk të lejojmë ta hedhësh çupën në greminë.

Mjeku iu afrua sëndukut, ku ish vendosur Marina. Asaj mezi i dëgjohej pulsi, ishte e mpirë. Sytë i lëviznin me përtesë. Vdekja po i afrohei.

— Gjallë! — mori frymë thellë mjeku. Dhe iu drejtua Thanasit, ndihmësmjekut, që të prega-tiste shiringat.

Ndihma e parë iu dha. Priftrinjtë të zënë në grackë ikën fshehurazi, bile pa u përshëndetur me Sifin e me Dafinën. Shtëpia erdh e u mbush me shokë e miq, me bashkëfshatarë.

— Turp i madh! — tha mjeku, — Marinën do ta shpëtojmë, por si ratë në këtë kurth të priftrinjve?

Pranë të sëmurës qëndruan tërë natën mjeku me ndihmësmjekun. Ajo zuri të ndjehej më mirë.

Të nesërmen në mëngjez, në sheshin, nën shtëpinë e Sif Bukanikut ishte mbledhur populli në kuvend. Kishin njofuar edhe priftrinjtë, por ata ishin strukur në kishat e tyre.

Në mbledhje i pari foli Sifi, i cili u tregoi bashkëfshatarëve gjithë ngjarjen. Ishte e qartë përtë gjithë.

«Priftrinjtë, që të forconin besimin në njerëzit, dhe që të majmeshin më shumë me djersën e popullit, trilluan ëndrrën, krijuan legjendën e «Shenjtores së Shpatit» dhe desh më varrosën përsë gialli. Po s'ja arriten qëllimit. Unë shpëtova, sot jam mësuese e luftoj që të zhduken deri në fund këto bestytnira që u përpoq të rrënjoshte kleri në popullin tonë» — tha Marina duke përfunduar këtë ngjarje të hidhur të foshnjërisë së saj.

HAJ E LER O ZOTI SHËN THANAS....!

(Simbas një kallëzimi popullor)

Ngjarjet dhe meseletë shkojnë gojë më gojë dhe trashëgohen brez pas brezi. Mbaj mend se për çdo vit, ditën e festës së Shën Thanasit, im më, na tregonte një ngjarje që e kish dëgjuar prej gjyshit. Megjithse im më s'dinte as përralla e as tregime. (se s'ja kish ënda të njerëj me to, por edhe sikur të donte, nuk e linin punët) këtë e kish mësuar si jo më mirë dhe e tregonte me shije të madhe.

Sa herë na thoshte këtë ngjarje kujtonte gjyshin dhe para se të fillonte lutej duke bërë kryq: «Ndjeje o Zot, ku ka rënë».

«Tregonin qëmoti, se në Starovë, në fshatin që gjindet këtu pranë, ka patur një mëhallë me shosharë. Shosharët ishin muhamedanë e kish nga ata që Shën Thanasin e lutnin. Ata kishin një zakon të tyren: mbasi e shtronin drekën me gjithë gjellërat e me gjithë të mirat që ka bota, (se një Shën Thanas është ai dhe s'ka të dytë) e linin për një copë herë sofrën të shtruar dhe largoheshin nga ajo dhomë. Besonin se hynte Shën Thanasi për të bekuar gjellët dhe prandaj s'duhej të ndodhej një-

ri brenda, se shenjtë s'donte të shfaqej në syt e njerëzisë.

Shën Thanasi, po të kish uri edhe mund të hante, se e kish atë të drejtë me kartë nga Perëndia dhe s'mund ta ndalonte njeri. Le që kush guxonte t'i delte përpara, se ai prandaj ishte goxha shenjt dhe me një të fryrë, po të donte, të fshinte nga faqe e dheut. Por si shenjt i perëndisë, ai s'bënte gjëra të paudha. Kështu besonin lutësit e Shën Thanasit. Ca të paktë tregonin se gjellët i kishin gjetur të nisura dhe për këtë mbashin më të madh.

Kështu edhe në shtëpinë e Behlulit ishin ulur rrëth sofrës për të ngrënë drekën e Shën Thanasit, sa me ëndje aq edhe me uri. Disa kishin agjëruar dy-tri ditë para festës, vetëm e vetëm që të hanin sa më shumë atë ditë, si të thuash e kishin vënë barkun ndë ujë.

Sofra ishte mbushur me gjithë të mirat. Kish-te mish dy tri soje, kishte kos e qumësht, kishte bukë të bardhë dy pëllëmbë të lartë, kishte dja-thë, èmbëlsira dhe ku di unë sa gjëra të tjera.

E kishin lënë sofrën një copë herë vetëm sипas zakonit, pastaj kishin ardhur. Ishin në të nisur e sipër, kishin marrë edhe lugët nëpër duar, kur në shkallë u dëgjuan këmbë. Behluli, më plaku mbajti vesh, pastaj u ngrit në këmbë e foli nxituar:

— Erdhi zoti Shën Thanas të na bekojë sofren, po o burrani të shkojmë në dhomën tjetër! — Pa mbaruar mirë fjalën plaku, dymbëdhjetë duar lanë lugët dhe njëzet e katër këmbë u sulën për në dhomën tjetër, kush e kush më parë.

Në atë kohë dyert ishin pa mandalla e pa brava: hapeshin e mbylleshin fare pa pengesë.

Mjaftonte një shtyrje e vogël sa edhe ajo e një maceje që porta të hapej. Të tillë derë kishin edhe miqtë tanë, se tani u njohëm me ta!

Ata u futën në dhomën tjetër, dhe dy tre i vunë krahët derës se mos bënte gabim shenjti e hynte në atë dhomë.

Shën Thanasi as që e mori mundimin të hyrte në dhomën e fortifikuar, por me një të shtyrë të vogël, hyri në dhomën tjetër. E ndjenë edhe ata që dera krisi dhe Shën Thanasi u ndodh përparrë sofrës. Njerëzit në dhomën tjetër i prenë fare bisedat. Një copë herë qetësi, pastaj dëgjoheshin fare shkoqur të mbillacitura nga dhoma e gjellëvet.

— Llap-llap-pllap, llap-llap-pllap...

— Paska ardhur me uri zoti Shën Thanas që i paçim uratën! — tha Behluli duke rrrotulluar sytë me frikë.

Në dhomën tjetër zhurma as që kish ndërmend të pakësohej, përkundrazi sa vinte shtohej. Herë-herë dëgjoheshin edhe sahanë që përbyseshin, lugë që ngatërröheshin dhe të tjera gjyryllitira. Ata e panë keq. Thanë të hante Shën Thanasi nga pak, sa për t'i provuar e sa për t'u bëré nder, po jo kaq shumë sa kish ndërmend ai, sepse siç e kish nisur, më së fundi, përveç sahanavet të bo-shatisur, s'kishin për të gjetur gjë tjetër. Behluli, që kish agjëruar tri ditë me radhë, u lut i pikëlluar:

— Ha e lerë, o zoti Shën Thanas!...

I thërritnin që prapa derës, dhe çuditeshin për ato që dëgjonin. S'e pandehnin atë thagmë që po u bënte Shën Thanasi.

— Siç ka nisur ai, përveç sofrës s'do të na

mbetet gjë tjetër, — tha një me frikë për këtë mëkatë.

Disa të tjerë, që u gjerrisnin zorrët, s'e mbajtën dot veten, po ja filluan me të bërtitura e më të folura.

— Ha e lerë, zoti Shën Thanas! Ha e lerë!

— Të hajë dhe të lerë, se ndryshe u pa puna... — tha njëri,

— Do të vete ta shikoj si do të jetë, — u hodh e tha një frikacak.

— Mos, mor derëzi, se të bëri pluhur — e këshilloi një tjetër.

— Ku vete, mor t'u mbylltë! — ju shkreh një grua. — Ç'të duhen ty ato punë?

Ai «më guximtari» s'i dëgjoi, por hapi derën, zgjati kokën dhe i shtrëmbëroi sytë aq tepër sa i tejmi vetëm të bardhët do t'i shikonte. Nga frika as që hyri në dhomën tjetër, por ata i gënjeu.

— E pashë, — tha — i ndritnin rrobat si pas-qyrë!

— Po si ishte? — e pyeti një kureshtar.

— I madh, hata. Koka i arrinte gjer në tavan. Pa, pa, pa, pa!

— Po fytyrën si e kishtë?

— S'e vura re! Të gënjej s'di! Më kishtë kthyer kurrizin.

Të gjithë i drejtonin nga një pyetje dhe ai përgjigjej si t'i vinte mbarë.

— Do të vete ta shikoj dhe unë — tha një tjetër që s'para i zinte besë atij frikacakut.

Doli nga dhoma dhe pa e bërë të gjatë hapi derën tjetër dhe futi kokën brenda. Përnjëherësh klithi sikur ta kishtë kafshuar gjarpëri.

— Qenka Buçja i Dimços, mor e hëngërt flama! Sillmëni një dru ta këput në mes!..

Të gjithë, që nga plaku e gjer te fëmija u vërsulën në dhomën tjetër. Dhe atje q'të shikoje...! Buçja e kishte ngrënë tërë kosin dhe sahanet i kishte përbysur. Mish s'kish lënë as edhe një kockë dhe në tërë çanakët kishte futur turinjtë për të provuar shijen e gjellëvet.

Papo kur u sulën të gjithë duke mallëkuar e duke cjeperruar qenin, që e pandehnin për Shën Thanas; pa kur i binin me se t'u ndodhej dhe me aq inat sa mundet të ketë një i urtuar. Këta thërrit nga inati e qeni angullit nga dhembja. Atje edhe Buçja i Dimços e pa keq. Bëri të ikte nga dera, po atje ishte gardh me njerëz. Më në fund e mblodhi mendjen: një sulm drejt drıtares dhe u ndodh në rrugë. Vërtet se u vra pak po prandaj hëngri gjithë ato gjera.

\* \* \*

Ne s'mbanim dot lotët nga të qeshurit dhe sidomos atje ku ata pikasën, se në vend të Shën Thanasit, mysafir kishte ardhur qeni: «Qenka Buçja i Dimços, mor e hëngërt flama..! Sillni mor një dru ta këput në mes!» dhe kusuri.. .

## P. ZOTO

### SËNDUKU I SHENJTË

Kësaj radhe do t'ju rrëfej një ndodhi, e cila e vuri Astritin, një shokun tonë të klasës, mbi të gjithë ne, që i thoshim vetes se çoç jemi.

Astriti është një djalë i pakët, nga ata që s'ta mbushin syrin. Trupin e ka të fortë e tërë muskuj, por duket si i ngathët. Megjithatë nuk bie në sy e duket si i leshtë. Në muhabet rrallë e merr fjalën: Ama kur flitet për histori, ec e ta dëgjosh! Këtë lëndë e ka shumë qejf dhe e mëson si askush tjetër.

Ndoshta ngaqë është i zoti, megjithëse duket si i leshtë, ndoshta për këtë, them, veprimi i tij i la me gojë hapur të gjithë në fshat. Por kjo mund të lidhet edhe me një çështje tjetër. Sa jemi nxënesës është bërë zakon të na shohin si fëmijë dhe askujt s'i shkon ndër mend që ne jemi moshuar, jemi bërë më të pjekur e se bëjmë pjesë në rini prej afro dy vjetësh. Natyrisht askujt s'i shkon nér mend edhe që ne të jemi të zot për punëra prej të mëdhenjsh. Po ju më mirë dëgjoni ndodhinë që po ju rrëfej dhe gjykoni vetë në kam të drejtë ose jo.

Ato ditë mbledhjet ishin të shpeshta. Po Mbledhje bëheshin edhe nëpër rrugë, edhe nëpër shtëpi. Si mund t'i quash, ndryshe ata grumbuj

njerëzish që flisnin aq me zjarr? Bëhej fjalë pér fenë. Feja i pérket së kaluarës, prandaj nuk e kish hak tē jetonte ende me ne. Kështu mendonin më tē shumtët e atyre që flisnin me aq zjarr. C'ndodhira s'tregoheshin pér tē e c'kujtesë që kishin fshatarët! Më dukej tamam sikur bëhej fjalë pér gjarpérinjtë, sepse, dihet, kur flitet pér ta, muhabeti s'ka tē sosur. Kish edhe nga ata që kundërshtonin e ca që rrinin tē heshtur. Po këtyre s'uva varte asnjeri.

Biseda tē tilla bënim edhe ne në shkollë; dhe, sa mbaronim mësimet, shkonim e ndihmonim pér mbledhjen e ikonave e vjetërsirave tē tjera që kishin tē bënин me fenë.

Kështu ndodhete kudo.

Një ditë, kur Astriti s'kish mbaruar ende së ngrëni drekë, e éma i tha duke psherëtitur si me ankim:

— C'është kjo që bëhet, mor bir? Punë i thonë kësaj? Kërkojnë tē prishin «Vendin e mirë» këta tē mallkuar.

Ai kërceu drejt e në këmbë.

— Vërtet, mama?

— Posi, o bir, posi! Kanë vajtur, atje janë. Sikur u kërkon bukë ai vend. Po do tē ndodhë ndonjë e pabërë që...

Astriti e la bukën dhe doli me nxitim, ndërsa e éma i thosh nga pas:

— Ti tē rrish rehat,. S'ke punë ti, dëgjon? S'të duhet gjë. Se... tē kujtohet ç'të ka treguar yt atë?

Po, atij i kujtohej fare mirë. Kur i ati i tij qe i vogël, «Vendi i mirë» ish xhami me minare tē lartë. Pasi kish vdekur hoxha, minarja ish rrenuar

dhe ajo karabinaja kish mbetur bosh dhe e hallakatur. Një të kremte, i ati kish vajtur të shpinte vajguri në xhami. Mirëpo udhës ish takuar me shokët e tij, e kish lënë atë mënjanë dhe kish luajtur me ta. Kur u kujtua ish errur. Nuk mund të kthehej në shtëpi pa e shpënë vajgurin në xhami. T'u thosh shokëve, i vinte rëndë që ata të kujtonin se ai kish frikë.. Dhe kështu, duke u dridhur nga frika, kish vajtur dhe e kish lënë shishen tek dritarja. Befas i qe dukur sikur kishte dalë prej xhamisë një figurë e përbindshme. Ai kish rënë në gjunjë dhe i qe lutur Nevruzit që ta shpëtonte, se dita e Nevruzit ish. Si përgjigje kish shkrepur një vetëtimë, pastaj një bubullimë e më pas një shi i rrëmbyer.

I shushatur nga frika, djali kish mbetur atje, si i ngrirë, dhe ish lagur paq. Rrugës mendonte zemërdredhur: «Pse s'më ndihmoi Nevruzi, pse? Ku është? Pse s'i tha allahut ta pushonte shiun? Unë i shpura vajguri e ju luta...» Po ai dukej se nuk ja kish ngenë. Ca nga të lagurit e ca nga frika ai u sëmur e u dogj si në ethe një javë të tërë. Gjyshja e tij thosh duke u falur:

«Bëri gjynah djali, bëri gjynah që harroi e u sorollat nëpër rruge.»

Edhe Astritit i kish ndodhur diçka e tillë. Kur qe më i vogël, atij i kish ardhur si të vjellë prej ajrit të atjeshëm të ndotur me erë vajguri e dhjami të tretur, i ndenjur e i prishur si mos më keq.

Tek kujtonte këto ndodhi, duke shkuar rruge, Astriti mendonte:

«Kjo histori kështu është përsëritur brez pas brezi. Njerëzit i janë lutur allahut e shenjtoreve

me përgjërim e besim të madh tek fuqia e tyre, kurse ata na shtonin vuajtjet... E kush ja ka vë-në emrin «Vend i mirë». Do të jetë ndonjë figurë si ato të legjendave që i thonë mortjes «zonjë».

Këto mendime ndoshta do t'ju duken si përsëritja e fjalëve të mësuesit të historisë. Këtu mund të kini të drejtë, se rrugës ai sillte ndër mend gjithë ato q'kish mësuar në histori përfenë. Ja, sikur i kish parasysh skllevërit e bujkro-bërit, të cfilitur, me sytë e përlotur drejtuar qie-llit, duke pritur më kot lehtësimin e vuajtjeve të tyre. Sikur i kish para syve Jan Husin, Avicenën, Xhordano Brunon, të dënuar aq egërsisht prej fesë...

Por duke kujtar ai arriți tek «Vendi i mirë» dhe kujtimeve ua preu rrugën. «Vendi i mirë» s'ish vecse një ndërtesë e vjetër me dritaret mbër-thyer me dërrasa. Ay kishin ardhur shumë njerëz, që mblidhnin buzët me mërzi, ashtu siç bëri edhe Astriti, sepse i çau hundët ajo erë aq e keqe që sundonte gjithmonë në atë vend. Bëhej një pote-re e madhe. Një grua klithte:

— Hasan, mos, të keqen!

— Jo ti, jo! Le ta heqë ndonjë tjetër!

Astriti u fut në mes të turmës dhe ju afroa hyrjes. Atje ndodheshin të rinjtë.

— C'prisni akoma? — tha ai.

Pa mbaruar mirë fjalën Astriti, një djale e shtyu derën me forcë. Ajo u hap duke krakëritur si vjetërsirë që ish. Ca gra klithën edhe me fort:

— Të zintjtë! Uh! Mos i lini, mos i lini!

Në dhomën gjysëm të errët nuk dukej asgjë. Pastaj ja ku doli si prej dheu një sënduk me dë-

rrasa të krimbura. Ky i ngjante një qivuri të madh që kishte mbetur pa u kallur në dhe.

Të rintjtë e rrrethuan atë. Ç'kish vallë atje? Ç'fshihej në atë gjerdallë? Askush s'e dinte. Sënduku s'mbahej mend që kur ndodhej aty. Dikush thosh se atje kish gjëra të shenjta, një tjetër shton te se aty flinte shenjti Abaz Ali, i cili ngrihej dhe ja hipte kalit që fluturonte aq shpejt sa dëgjohej një orë larg si bubullimë. Një i tretë... Po a mund të numërohen thashethemet rrreth atij sënduku të çuditshëm? Për çdo gjë të fshehtë njerëzit kështu krijojnë thashetheme nga më të pabesueshmet.

Astriti e shikonte me kureshtje sëndukun dhe mezi i pritej sa të kërkonte ç'kish atje. Nuk i besonte përrallat rrreth kësaj arke, akoma kureshtar ish.

Njëri nga të rintjtë vuri sëpatën në një të çarë të sëndukut po dikush e kapi nga prapa.

— Jo, s'të lë! Hiqu, se do të të lërë në vend. Dëgjon? Ty të thom!

Ish eëma. Djali kundërshtoi po pastaj sikur u tremb dhe u tërhoq mënjanë.

Një plakë po mundohej me mish e me shpirt:

— Mosni, bre, dëgjomëni mua! Djem, do të merrni veten më qafë. Kështu bëri shakë edhe Aliu që desh të priste një goricë të vakëfit. Po mbeti në vend, ja, më placin sytë, në ju gënjej. Ky sënduk është i shenjtë. Kushedi që kur është këtu. Por s'ka guxuar njeri ta hapë! Kot, flisni ju!

Djemtë sikur u stepën. Fjalët e plakut dikush u mundua t'i kundërshtonte, por, sidoqoftë, askush s'po vepronte më, bile njeri iku si fshehurazi. Tronditjen e tyre e shtoi akoma më tepër një zë

i ngjirur që erdhi nëpërmjet drifores prej dërrase:

— I pari që do të mundohet ta hapë, do mbër-thehet atje, ta dini. Le të vinte kryetari vetë, po të desh. Mirëpo mbrëmë juva futi fitilat juve dhe kur u kthye në shtëpi e gjeti lopën të ngordhur. Kush ja bëri këtë thuamëni ju? Allahu, ta dini».

«Oh, ç'njerëz! — tha me vete djali i vogël — Po ç'kanë kështu? Përse mundohen të na trembin? Vërtet kanë frikë apo besojnë kaq shumë? Apo s'duan?

Atij ju kujtua një proverb që thotë se po hyri pleviti, është zor të dalë dhe këtë e lidhi aty për aty me idetë e mykura që kishin zënë rrënje në mendjen e këtyre njerëzve. Mirëpo në çast solli nér mend se tani tek ne pleviti nuk është si gogoli i dikurshëm. Kjo e gjëzoi.

— Kush kuit kështu? — thirri — Akoma do të trembemi ne nga këto përralla? Ja, në ka allah, le ta tregojë sa i zoti është!

Dhe menjëherë Astriti rrëmbeu sépatën, e futi në një të çarë dhe i dha me forcë. Dërrasa e krimbur krisi. Diku gjerviti një peronë. Ai i dha edhe një herë, pastaj ndjeu se dora ju lirua. Të rinxjtë e kishin marrë veten dhe po e ndihmonin me veglat e tyre. Kur u hap kapaku, njerëzit mbetën të habitur. Aty brenda kish ca rrangulla që të vinte pështirë t'i shihje: thika të thyera, kocka, lecka, një poçe e thyer, ca gurë.

— Hej, hej! Hajde t'i shihni sendet «e shenjata»! — thirri Astriti.

Njëri nga djemtë i tregoi rrangullat me një hu. Leckat e tretura u grisën dhe pluhuri që doli prej tyre u përhap duke u zhdukur sikur të fshi hej i trembur nëpër skutat e karakatinës që e kish emrin «Vend i mirë».

— Ama njeri i ditur paska qenë ai që e ka bë-  
rë këtë marifet, o shokë! — tha njëri nga djemtë.

— E pse? — u çudit një tjetër.

— Si pse? Në këtë arkë ka hedhur ca plehra.

Pse t'i harxhonte kot gjérat me vlerë?

— Mirë thua. Do ta ketë bërë hoxha. Kushedi  
sa para ka xhvatur prej fshatit me sebepin e kë-  
tij sënduku «të shenjtë».

— E ne budallenjtë besonim. Ptu! Gënjeshta-  
rët e drejt — mallkoi një plak.

Ndërsa bisedonin, djemtë e pastruan arkën, e  
pastruan edhe dhomën. Dërrasat që shërbën si  
kanata u hoqën dhe ajri i pastër e i freskët vërshoi  
në të duke e përzënë tej ajrin e ndenjur.

Ca ditë më pas «Vendi i mirë» u bë depo e  
kooperativës. Astriti ynë u bë si me krahë, aq  
u gëzua nga kjo punë. Tani askujt s'i shkon ndër  
mend ta quajë «leshko» e ta shohë me mospër-  
fillje.

Harrova t'ju them se mësuesi ynë, që s'i le të  
shkojnë pa u ndjerë rastet, kur ne bëjmë ndonjë  
punë për të qenë, tha të nesërmen e ditës që u  
prish «Vendi i mirë»:

— Astrit, ngrehu të të shohim, o trim. Ja  
edhe një revolucionar tjetër, i vogël akoma, por  
me zemër të madhe. «Vendi i mirë» do prishej  
edhe pa të. Por ne gëzohemi që këtë e bëri Astriti,  
djali i klasës sonë, që e tregoi veten se është  
një anëtar shembullor i organizatës së rinisë dhe  
një nxënës me mendime të shëndosha, të pastru-  
ara nga ndyrësitë e së kaluarës.

Astriti qëndronite serioz, por dukej që e ndjen-  
te veten shumë krenar. E cili nxënës nuk do të  
krenohej duke dëgjuar të flitej kaq mirë për të?

## XH. VEIZAJ

### HIEJA DHE SHKOLLA

Në Bregas kurrë ndonjëherë nuk kishte patur shkollë.

«Bregasi është fshat i largët. Ç'duhet shkolla atje? Fundi i fundit nja tetëdhjetë e ca shtëpi ka. Punë e madhe pse brez pas brezi bregasit lindin, rriten e plaken pa ditur të shkruajnë emrin. Ouaaa! Ç'u dashkan të na bëhen ata? Ministra? Le të shohin dhitë e atë dhé që u ka falur perëndia, se, asull-asull, edhe atë tepër e kanë, rjepacakët!. Kështu i qenë përgjigjur ca vite më parë, atje në komune, xha Iljazit, që vdiq me maraz i gjori, nga që s'arriti ta shohë Bregasin, fshatin e vet, me shkollë e fëmijët me libra.

\* \* \*

Skënderi qe mësuesi i parë në këtë fshat. Sa punë iu desh për ta hapur shkollën! Bashkë me këshillin, brodhi andej-këndej, e derë më derë, për të mbledhur nxënësit. Dhe u bënë dyzet e më shumë nxënës. Po jo vetëm shtatë a tetë vjeçarë, po dhjetë e dymbëdhjetëvjeçarë, bile ca edhe katermbëdhjetë, që dukeshin më të mëdhenj se ai.

Sa më tepër shtoheshin, aqë më shumë i gufonte zemra atij. Thoshte me vete: «Do t'i mësoj».

Por ky gjësim, kjo forcë e madhe, që e kish pushtuar mësuesin, atij mëngjesi, iu errësua nga një e papritur.

\* \* \*

Nxënësit vinin në shkollë me të zbardhur drita. Këputnin dega lofate, fshinin klasën, se një klasë kishte shkolla, pastaj ca rrinin brenda, ca luanin në sheshin me bar. Çupat e vogla mblidhni aty afër lule shpatëze, që rritheshin shumë në Bregas, dhe i linin mbi tavolinë. Pastaj të gjithë, çuna e çupa, i delnin përpara mësuesit, që vinte bashkë me Ndrekën.

Shkolla qe bërë gjëzimi i fshatit. Dhe burrat i hapnin punë vetes, po t'u binte rruga andej. Rrinin e vështronin që nga jashtë me bërrylat mbësh-tetur në dritare dhe habiteshin me Skënderin, se qysh na qënkesht kjo punë e shkollës, se si është i zoti ky «msusi», që t'i bëka çilimijtë të rrinë si në xhami, pa bërë zë. Por ndodhët nganjëherë, që ndonjë fshatar (më tepër bënte vaki që ky të qe plak), hapte derën e shkollës, dhe pasi i jepte Skënderit një «selam aleqëm» me shumë nderim, zinte vend në një bankë andej nga fundi, dhe ja mbërthente sytë në gojë, pa ja ndarë për asnjë çast, deri në fund të mësimit. Pastaj ikte, ashtu si kishte ardhur, duke përsëritur buzëgaz atë «selam aleqëm» të tij me dorë në zemër.

Kujtimet e tri javëve, që kish kaluar në Bregas, i silleshin tanimë Skënderit në kokë shumë të turbullta, të errëta, të ngatërruara.

\* \* \*

U ngrit nga praku dhe hyri brenda në klasë.  
Ndreka i vajti prapa.

— E Ndrekë, ç'thua? Kush ta ketë bërë këtë punë?

Ky, si pa një herë me të shpejtë ato eshtra njeriu sipër tavolinës, ktheu kokën nga ana tjetër dhe u përgjegj me zë të ulët:

— Nga ta di unë?

... Kish rastisur, atë mëngjez, që të hynte e para në shkollë një nga nxënëset, Filja. Sapo kish shkelur te dera e klasës, kish klithur dhe qe mbërpsur me llahtari. Zemra sa s'i kish pushuar. Por edhe nxënësit e tjerë kishin vrapuar nëpër shtëpira me kuje. Kurrë s'kishin parë një gjë të tillë. Pastaj, edhe sikur të mos qe kështu, ç'donin ato eshtra aq të frikshme, të thyera dhe të përlyera me baltë, mbi tavolinë!?

— Të vjen frikë, Ndrekë?

— Jo... por...

— Si?

— Më vjen.

Dolën. Njérën dritare që ishte e hapur, Skënderi nuk e mbylli. Ç'ta mbyllte? Xhamet e saj i gjeti copë-copë...

Arritën buzë përroit të thatë.

— Mos ka dashur të tallet ndonjë?

— Nga ta di unë?

— Ndrekë, përsë të mos mblidhemi prapë në shkollë. Ne duhet të vazhdojmë mësimin, apo jo?

— Po.

— Si t'i lajmërojmë nxënësit?

— Vete unë, shtëpi më shtëpi.

Dhe ndérkaq u largua. Skënderi u kthye në shkollë. Afroi karrigen pranë tavolinës, u ul, por sapo mbështeti kokën, e hoqi menjëherë dhe u çua në këmbë. Era e dheut të keq i mbyti hundën. S'dinte ç'të bënte. Nisi të shetisë nëpër klasë... U ul rishtas në një bankë. Asnjë nxënës nuk po dukej. Mos po priste kot? Por ja, ja behu Ndreka. Fryma i merrej.

— Pse ke vrapiuar kështu?  
— Se... se...  
— Ulu një herë, ulu. I lajmërove nxënësit?  
— I lajmërova.  
— Po ku janë?  
— Nuk duan të vijnë. Thonë që në shkollë ka dalë lugati.

— Ç'lugat? Ku ka lugat?!  
— Ka, ka zotni.  
— Si?  
— Mbrëmë në darkë kish ardhur këtu Ismaili bashkë me Jonuzin se kishin harruar librat te cepi i murit. Kur po iknin panë një hie të zezë, që po i afrohej shkollës.  
— Hie të zezë!?

— Po, zotni. Ashtu është lugati, si hie e zezë.

Nuk e zgjatën më shumë. Shkuan të dy në shtëpi. Te Ndreka rrinte mësuesi.

Pa rënë nata, ky u tha njerëzve të Ndrekës:  
— Sonte më kanë thirrur për darkë te xha Dulja. Nuk do kthehem dot. Mos më prisni!

Pas kësaj shkoi në shkollë. Zuri vend në banët më cep të klasës, ndenji shtrirazi dhe, si u err, filloj të vëzhgonte.

Iku një orë, dy...

«Ta ketë kuptuar, se mund ta ruajmë, e të mos vijë?»

Skënderi nuk dyshonte se ndonjë nga fshati do të qe...

«Në s'ardhtë, në dreq të vejë! Por në erdh...». Kur sillte këto nëpër mend, vuri re matanë gardhit të shkollës, një hie të zezë. I hapi sytë shumë. Hieja kapërceu gardhin. Ekte nga dalë... Tashti ishte afër dritares. Skënderi u fut lehtas poshtë bankës. U përplasën kanatat e dritareve. Pastaj qetësi...

Për një çast, Skënderin e mbërtheu një frikë e madhe. Hieja e zezë u hodh me shpejtësi në dritare dhe që andej brenda në klasë. Bankat kërcitën nën peshën e këmbëve. Skënderi mundohej që edhe frymë të mos merrte. Se ç'u lëshua mbi tavolinë. Diçka u përhap afër dërrasës, disa banka u përbysën pa zhurmë.

«Po vjen këtu!» Skënderit i ngriu gjaku.

— «Po vjen, po vjen!» Hieja e zezë ndaloi. Që nga poshtë i dukej dora, mbështetur një pëllëmbë më tej. Merrte frymë sikur gulçonte.

«Ç'të bëj tani? Të ngrihem t'i hidhem? Jo, jo. Sa të madhe e paska dorën! Paska edhe orë! Ja, këmbët! Paska mbathur këpucë! Sikur të kisha një shok, sikur të kisha një armë!... Pse s'po lu-an që këtu. Ç'pret?... Mos m'i ka ngulur sytë dhe po matet të më ngulë ndonjë thikë?...»

Në këtë çast, hieja e zezë vuri këmbën mbi bankën, nën dritare dhe u hodh jashtë. Skënderi mori fymë me gjithë gjoksin... Ndënji akoma palëvizur. Pastaj, ngriti kokën dhe pa. Hieja e zezë largohej si erë, përtej gardhit.

Për një çast, Skënderit iu duk se qe treguar shumë frikacak. Por ndërroi mendje.

«Jo, veç të kisha qënë i çmëndur, që të lëvizja. Mund të shkoja si qeni në vreshtë... Do t'i tregoj Abazit. Ai është kryetar këshilli. Ka edhe pushkë».

Këto mendime nuk iu ndanë mësuesit, gjersa zbardhi drita. Edhe më parë ai kishte shqar nibi tavolinë një gjë si të rrumbullaktë, veç jo shumë të madhe. Por të themi të drejtën, kish pasur frikë të shkonte e ta shihte. Se s'do mend, natën ish errësirë. Ku ta dije c'mund të qe? Tani që nata iku, gjithshka dukej e qartë.

«Shoh vërtetë, apo më bëjnë sytë?!? Si është e mundur!» Kafka, po ajo kafka e thyer e me dhe, që e kish hedhur në ferra.

S'e mbajti dot veten. Psherëtiti duke e shtrën-guar kokën me të dyja duart. Sytë iu mbushën me lot. I fshiu me pëllëmbë. Vajti te burimi. U freskua. U përpoq të merrte një pamje më të qetë. Qe zbehur dhe hequr. U nis për tek Abazi. Asnjë këmbë fëmije s'dukej rrugës. Të gjithë ishin struktur nëpër shtëpirat.

\* \* \*

C'ditë kishte nisur! Me sa mërsi! Mësuesit i bëhej sikur e kapte dikush në grykë. Një re e madhe, e zezë, po çlodhej mbi majën e malit. Të tjera re endeshin në qiell, si barka peshkatarësh në det. Po ai i shihte me sy tjetër.

Ekte me të shpejtë, donte të arrinte sa më parë te shtëpia e Abazit. Ndjente një dhëmbje në

krahëror. Herë-herë nuk kuptonte në qe dhëm-bje apo zbrazësirë. Një dorë e thatë, dorë plaku le-shtore, sikur i qe futur thellë në gojë, e përpiquej t'i shkulte mushkëritë.

— Abaz! — i thirri kryetarit të këshillit, me një zë të shqetësuar, posa ky i doli në prak të portës.

Dhe filloi t'i dridhej buza e poshtme.

— Ç'ka ndodhur?...

Skënderi ja tregoi të gjitha.

— Si, ore? prapë sonte, hë?! — ja ktheu Abazi. Pastaj thithi bishtin e cigares, sa iu përvëluan gishtat, nxori tymin me përtim e, me vështrimin të ngulur në tokë, tha:

— Mos e prish gjakun, se do ta rregullojmë këtë punë. Që mbrëmë po vras mendjen. Është dora e armikut kjo, që hapëm edhe ne shkollë dhe duan të mos na lenë. Duan që ti trembesh e të ikësh që të na lënë pa shkollë.

— Jo, unë as trëmbem, as iki. Por vetëm ta kapim atë dhe t'i mbledhim nxënësit prapë.

— Të dyja, do t'i bëjmë të dyja; vetëm ti, ama, mos u mërzit! Se, çdo punë e mirë kështu e ka! Do të vijë një ditë, dëgjo mua ti, do t'i kujtosh këto gjëra dhe s'do të të vijë keq që i ke hequr. Ja, ne hoqëm në luftë të zezat e ullirit. Po tani, për sytë e ballit, kur i zemë me gojë, zemra qysh na bëhet det. Se ja arritëm ditës. S'i thonë shaka. Është gjë e madhe... Ku ta di unë i shkreti, më merr vesh ti apo s'më merr?

— Po, Abaz, po.

— Ashtu, rrofsh! Tani, ja ç'të bëjmë.

— Çfarë?

— Hë për hë, hajde të hyjmë brenda në shtë-

pi, të hamë një përslesh me qumësht!

— Jo, jo, dua të kthehem.

— Mos ma prish qejfin, o mësues! Hajde, hajde! Je si në shtëpinë tënde këtu. Për nxënësit mos e vra mëndjen, se e mora unë tanë përsipër këtë barri.

I hodhi krahun dhe e la të ecë përpara.

\* \* \*

Abazin e dëgjonin të gjithë në fshat, dhe fjalën dy nuk ja bënin, se çdo gjë që thoshte ai, delte sikur e kishin pleqësuar dhjetë burra. Po atë pasdreke, nuk i shkoi aq mbarë. Në shumë shtëpi i ndodhi e njëjta gjë: dilte plaka në mes të avllisë e ja priste:

— Marshalla, marshalla! Më trokëllitke te porta e s'më hykë brenda! Hidh, ore, çapat, se të mora kosoren e të shkurtova këmbët. — Dhe më pas plaste së qeshuri. Po kjo e qeshur, që e priste, nuk e përcillte.

— Jo, jo, të keqen! Veç atë gjë s'e bëj dot. S'kam si e çoj tim nip prapë në shkollë, se më bëhet me ydhër mua korbës, e pastaj më mirë të më bjerë një pikë. Ç'të rroj kot, të shoh ukubetet me sy? Ti, si këshillë që je, gjej një konak tjetër dhe i mblidhni çiliminjtë prapë, se atje, larg qoftë, nuk ju vijnë, mehazallah! Më dëgjoni mua, lereni atë vënd, hiquni një sahat e më parë, se e kanë zaptuar shpirtërat e këqinj! Ja, më placin këta dy sy, po s'qe ashtu.

— Mjaft, moj xhexho Salushe, se po flet marrëzira.

— Mirë, o Abaz, mirë, po mos harro, se duhen dëgjuar fjalët e pleqve.

— Ashtu është vërtet, vec këto muhabete, që po bën zotrotë, s'janë për t'u thënë. C'shpir-terë të këqinj na ze në gojë?

— E, ç'kërkon ta mbulosh!? Atë llaf e ka marrë dheu, e di i madh e i vogël.

— Moj Salushe, rri paç jetën e gjatë, në ha-llin tënd, e mos fol më kështu, se vetëm na prish punë e s'na ndreq.

— Jo, të keqen, unë e shkreta jam zemërbardhë, qysh ju prishkam punë!

— Ehu! Nuk po e zgjas më. Nesër çojeni Bar-dhylin në shkollë, atë bëni.

— Hajt, mbeq me shëndet, se ne po ikim. — Dhe vajtën në shtëpinë ku rrinte mësuesi.

Abazi i thotë xha Selimit, të parit të shtëpi-së.

— Në s'të mbetet hatëri, o mik, po e mbaj ca ditë mësuesin të flerë andej nga unë. Se, qysh të të them i ziu, më ka hypur në kokë që të nxë nga ato mësimet edhe unë ca. M'u dashkërkë e uruara, Gjithnjë shkresurina më bien nëpër duar. Dhe shumë sëkëlldi më japid. Pa lëre qysh më kullojnë djersët, kur i këndoja, si në mes të gushtit. Se llafet me zahmet të madh i lidh, dhe ato të shkreta shkronja i zë një e nga një. Kështu de, o xha Selim, po ta kem ca kohë afër mësuesin, ashtu pranë oxhakut, sikur fare gdhë të jem, do të mësoj ndopak. Dhe mbasë do ta kem më kollaj me ato shkresurinat.

— Shumë mirë të paska vaitur nér mënd — ja ktheu xha Selimi. — Pso, më paç uratën, pso, se kë vakt akoma. Po ne pleqtë ç'të bëjmë që e

hëngrëm kullotën. Sytë në ballë i kemi dhe qorra që qorra jemi. Eh, kjo dyniaja me rrota!

Si dualën nga shtëpia e xha Selimit, Abazi i kthehet Skënderit:

— Ti mos kujto shoku mësues, që i këputa një gjenjeshtër plakut, se vallahi, si të kapërcej-më këtë bela, ashtu vërtet do ta bëjmë.

— Me gjithë qejf, Abaz.

— E, e, kështu thua ti, po ta dish vec, që nuk do ta kesh aq të lehtë, sa e ke me çiliminjtë. Se kjo koka, është sa një karroqe. Kam frikë se mos do të të duhet të zbrazësh fare tënden, që të mbushësh timen.

Kur arritën te rrapi i djegur, Abazi, pasi shikoi rrëth e rrëth e u sigurua se s'kish njeri, i tha Skënderit:

— Këtë do ta mbash ti.— Dhe i tregoi një revole. — Kij kujdes, Është plot. Mba vesh këtu, si shtihet me të... Më parë kjo siguresë ulet poshtë me gishtin e madh, pastaj tërhiqet këmbëza dhe... Kuptove?

— Kuptova.

— Kaq, na, merre!

Skënderit i ndritën sytë. E mori me shumë gëzim.

Pastaj Abazi tha:

— Pa të dhënë urdhër unë, të mos e zbrazësh. Këtu me urdhëra është puna. Ti mos u zemëro!

— Jo, nuk zemërohem.

— Ashtu de!

Një copë rrugë e bënë pa shkëmbyer fjalë.

• • •

Pak e nga pak u bë natë. Hynë në shkollë. Skënderi do të rrinte afër tryezës te dritarja karshi derës. Abazi atje, ku një natë më parë pat qëndruar Skënderi.

...I pari, pasi nguli këmbë Abazi, ra të flinte Skënderi, mbi dy banka të afruara pranë njëra tjetrës. Abazi vështronte jashtë dritares, andej nga ana e gardhit. Në mes dy këmbëve kish vënë pushkën, të dyja duart përmbi tytën e pushkës dhe njérën faqë përmbi duart. Nuk po mbyllte dot sy. Vetëm mendonte:

«Ah, ç'm'u pik për një duhan! M'u ca hunda fare. Sikur ta pi një? Bah! Edhé kjo duhet këtu».

Abazi, sikurse e lanë të dy, do ta zgjuante Skënderin kur të këndonin gjelat e parë dhe pastaj do të flinte vetë. Dhe ja, gjelat e parë kënduan. Kryetari i këshillit u ngrit nga vendi dhe, duke ecur me çape të lehta, gjithmonë pa e ndarë vështrimin nga gardhi, iu afrua mësuesit. Qëndroi më këmbë përpara tij. Mezi ja shquante ftyrën në erësirë. Ai, mësuesi, bënte gjumë të qetë, me krahun e majtë të varur poshtë. Abazit iu dhimb shumë. Deshi t'ja kalonte mbi ballë pëllëmbën e dorës me kallo e të ashpër, por ndryshoi mëndje, se druhesh mos e zgjonte. U kthyesh përapë, po ashtu me çape të lehta, gjithmonë e pa e ndarë vështrimin nga gardhi...

Kënduan gjelat e dytë. Errësira po lëkundej. U muarr vesh: hieja e zezë nuk do të vinte.

Vetëm kur ra drita mirë, kur as kishe ç'të ruaje e nga se të ruheshe, Abazi ndezi një cigare.

E zgjoi Skënderin, pasi e çoi cigaren në gjysmë.

— Paska zbardhur!? — pyeti ky me habi

\*\*\*

Abazi dhe Skënderi vazhdonin të tyren. Natën e kalonin në shkollë duke ruajtur. Abazi qe si gjithnjë i qetë, kurse Skënderi jo.

— O Abaz, më duket se i ka rënë era.

— Prit, prit! Akoma s'dihet.

— Si s'dihet. Kaluan kaq ditë.

— S'ka gjë. Do të presim. Ta kapim lepurin me qerre. Sa marifete kanë këto punë. Të liqtë janë si gjarpëri. Nuk i tregojnë këmbët.

— Se mos po mendojnë që nuk u doli gjë dhe i venë kapakun me kaq?

— Jo, jo. Mbase s'po ndihen; që të ftohen pak muhabeti.

...Skënderi qe dobësuar e zverdhur pak, systë i qenë thelluar shumë. Lëkura rreth tyre i qe bërë edhe më e hollë dhe i kish marrë një ngjyrë mavi.

Ditë të tjera ikën.

Mësuesi e kishte humbur besimin, kurse Abazi, jo. Ai ecte i qetë, me krahun e rëndë mbi shpatullat e vogla të mësuesit, dhe ndjente një forcë të çuditshme, që e tërhoqte drejt shkollës. Mollëzat e tij pa mish, faqet e hequra, vetullat e trasha dhe të zeza, balli me ato vija, si brazda-brazda, të gjitha ngjanin si të skalitura me daltë.

• • •

... Ishte mezi i natës. Hieja u duk matanë gardhit. «Po vjen, po vjen!... Erdhi!», tha nëpër dhëmbë mësuesi dhe, filloi të dridhej nga gjëzimi. Lëvizte duart, zinte gojën, kafshonte gishtat, shqyente sytë... Nxori revolen nga xhepi. I bëhej të thërriste, sa të dëgjonte i gjithë fshati:

— Erdhi! Erdhi! Ja tek është, ja, po afrohet! Abazi rrinte gati me pushkën shtrënguar fort. Heshtje... Vetëm një cinxër e prishi qetësinë me fërshëllimën e tij.

Dritarja u hap lehtazi. Hieja e zezë kërceu në dritare, mbi banka. Bankat kërcitën.

— Duart lart! — thirri Abazi.

— Mos luaj! — thirri Skënderi.

Duart e hies u ngriten lart. Se c'iu rrëzua përdhe me zhurmë.

— Një hap po bëre, të shkoi koka në hava! — thirri Abazi. Luajti shulin e pushkës dhe e çoi fëshekun në gojë. Me gishtin në këmbëz hodhi një hap përpara.

— Zbrit nga bankat!

Hieja e zezë zbriti me këmbë të dredhura dhe, duke mbajtur duart lart.

— Afrohu te muri.

Hieja e zezë iu afrua murit.

— Edhe më, po të them!

Hieja e zezë iu afrua edhe më.

— Ngjitu, ngjitu me murin!

Hieja e zezë u ngjit me murin.

— Hapi këmbët, qen bir qeni!... Hapi akoma, se t'i derdha trutë!... Ashtu! Mos luaj tan!

— Po luajte, kaq e pate, — ja priti mësuesi.

— Jam dorëzuar, mos më vrisni!

— Mjaft. Ashtu më rri, në s'të ka ardhur vdekja! — Njérën këmbë dhe dorën e djathëtë me revolen, Abazi i mbante më prapa. E kontrolloi në njérin xhep të pantallonave, s'i gjeti gjë. E kontrolloi në tjetrin i nxori një revole. Ja kaloi pastaj dorën në brez. I mori thikën. Bëri dy hapa më këtej.

— C'ke tjetër? Folë!

— S'kam gjë.

— Mirë. Në pate, dëm kokës do t'i bësh. Uli duart tani!

Hieja e zezë uli duart.

Në këtë kohë, nga jashtë, u dëgjua një zë i trashë:

— Ej, ju aty brënda! Lëshoni armët dhe dilni, se jeni të rrëthuar!

Hieja e zezë filloi të lëvizte. Abazi mbështeti tytën e pushkës mbi kokën e hies së zezë.

— Ti nepërkë, mes hidh vicka! Dëgjon? Se plumbat në vesh t'i zbrazi!

«Si s'më ra ndër mend, dreqi ta hajë, — u hëngër Abazi me vete, — se ky edepsës mund të kishte edhe zagarë të tjerë nga prapa?»

U duhej kthyer përgjigja atyre, që dhanë urdhërin.

— Armët në i deshët, hajdeni të na i merrn! Zakon s'i kemi t'i dorëzojmë vetë.

— Kush je ti, që na flet?

— Hyni këtu të më shihni?

— O po kush je, të marrtë lumi!

— Ju fola një herë.

— Mos je Abazi, kryetari i këshillit?

— Ai vetë jam.

— Zbutu, o t'u mbylltë dera, se jemi forcat e sigurimit. Si, s'po ma njeh zënë! Jam Elmaz Lapi. Kemi kaq orë që na ranë këmbët pas një... Mos ma ke aty firaunin?

— Siurdhëron, këtu e kam. Merak mos u bën! Shëndoshë e mirë është. Bujrum ta dredhim nga një duhan.

• • \*

Ca e nga ca, i gjithë fshati po derdhej në she-shin e shkollës.

Në atë çast Skënderi futi çelësin në dry dhe dera e shkollës u hap. Që andej doli kryetari i këllit me pushkën hedhur krahut.

Abazi, si u hodhi njerëzve një vështrim me kokë, tha:

— Ju, gra, qasuni ca! Çiliminjtë le të dalin në këtë anë... Ashtu, de!... Dëgjoni tanë! A ua merr mëndja përse ju kemi mbledhur?

— Jo! — u ndjenë disa zëra.

— Mirë. Që të merrni vesh... nja tri javë e ca të shkuara, në shkollë na pat ardhur një lugat...

— E, të keqen pat ardhur, — foli si me vete xho Salushja, duke tundur kokën andej, tek qe, në mes të grave. — Ma dëgjove që ma dëgjove fjalën or bir. — Pastaj iu kthyeshoqeve: prit, kur të thotë tashtithi, që do ta çkulin shkollën që këtej.

— ...Kështu, na pat ardhur një lugat... pooo... dhe ai qerata na prishi shumë punë, apo jo?...

— Ruana zot! — pëshpëriste xho Salushja.

— Ne kujtuam — vazhdoi Abazi — se nuk do të na binte havale, po ai qënkesh fare harbut. Prapë na erdhi mbrëmë, edepsëzi.

— Ju ciliminjtë mos u trëmbni, se lugati, që shkeli prapë në shkollën tuaj, kurrë më nuk do të shkelë.

— E ore, e, ku bëhet dot zap ai? — tha xha Telua.

— Bëhet s'bëhet është punë tjetër, — ja priti Abazi — unë vetëm këtë di t'ju them, që kësaj radhe s'i eci të shkretit, se e ka pësuar si cjapi te kasapi. E kemi mbërthyer dhe e kemi këtu brënda...

— Unë vë kokën në satër, në s'ju ka ikur. Ku lidhet ai, ore?! Fjala është kjo! Fësht ja bën dhe të lë pendët. Hajde ta gjesh pastaj.

Xha Braushi iu kthyte prapë Abazit:

— Mirë, de, mirë; po ta keni lidhur, na e nxirrni një herë t'ja shohim çehrenë!

— Ç'çehrre kërkon të shohësh, or lumëmadh,

— ja priti xha Telua.

— Jo, këtu e ka mirë, — tha Abazi, — ne do t'uа tregojmë pa tjetër, se kot nuk ju thirrëm... po unë kam qejf, qysh e shëmbëllen xha Braushi lugatin.

— E si do ta shëmbëllej, o t'u shtoftë ymri? ja, ashtu si plënc, që ikën, duke kërcyer: pllup, këtu, pllup aty.

Abazi dhe Skënderi ja plasën së qeshurës.

Mësuesi rrinte në mes të nxënësve, afër Ndrekës. Nga brënda shkollës u dëgjua:

— Hë de, luaj! — dhe sakaq në derë u duk hieja e zezë me duar të lidhura. Të gjithë u ngritën në këmbë.

— Qënka rob! — bërtiti xha Braushi.

— Hihihishi...

Pas hies së zezë dolën Elmas Lapi, Vesel Ha-limi, Servet Tusha.

Gratë sa e panë, thanë:

— Uaaa!...

— Të kallka datën, moj korbë!

— Shoq pastë veten!

Në shesh bëhej zhurmë e madhe.

— Ja, ky është lugati — tha Abazi.

### GURI I PENDIMIT

Prifti u hodhi një sy të ftohtë atyre që mbushnin kishën pastaj nisi nga predikimi. Ata që e njihnin prej vitesh Dom Nikollën nuk e patën të vështirë të kuptojnë se ai ishte egërsuar si bishë mali dhe se mezi po e mbante zemërimin. Prifti ishte një burrë rreth të pesëdhjetave, i shëndoshë dhe i fortë si ndonjë kalë race. Fytyra e tij, e rrojtur dhe gjithnjë e freskët, flakëronte nga shëndeti. Në të shumtën e rasteve njerëzit e fesë mundoheshin ta mbanin grigjën e tyre besimtarë me të butë dhe me një sjellje të pérunjur shenjtori, por Dom Nikolla nuk e pëlqente këtë mënyrë të sjelluri. Butësia që i nevojitej veshjes së tij, nuk i shkonte për shtat karakterit. Ai sillej i vrasdhë, nuk përfillte veç dy a tre vetë në fshat dhe i mirrte nëpër këmbë të gjithë të tjerët. Priftit ja kishin frikën më shumë për karakterin dhe për lidhjet e ngushta që kishte me zyrtarët e qytetit se sa për rroben që mbante. Fjala e Dom Nikollës ishte ligj e përmby ligj. Kush e shkelte atë e mirente lumi...

...Prifti kryqëzoi duart në gjoks.

— Besimtarë katolikë! Në këto ditë të bardha

të muejit të lumnueshëm të virgjineshës sonë, prej zemnave tonë naltohet në qiel nji lutje e pastër për Zotin tonë Jezu...

Në atë heshtje të rëndë, që sundonte kishën, zëri i Dom Nikollës, që vinte duke u ngritur fjalë pas fjale, përbante një kërcënim të fshehur.

— Por zanin tonë të pastër e ndyen ndonji pëshpëritje Jude, ndonji fjalë e ndonji të patenzoti, që përlyen gjakun e shëlbyesit tonë...

Dom Nikolla u bë spec i kuq në fytyrë, kokërdhokët e syve i kërcyen jashtë. Gjithë kisha ushtoi nga zëri i tij, që gjëmonte si këmbanë urrejtjeje. Ai zgjati dorën nga një qoshe e kishës, pastaj vazhdoi:

— Dhe e keni midis jush! E keni midis jush atë që nuk e nderon kishën. atë që flet keq për shërbyesit e Zotit. Shifnie Gjin Bardhokun, këtë të patenzot, mbi kryet e të cilit kanë me shkrepë herët a vonë zhgjetat e të lumnushmit.

Heshtja u prish. Njerëzit zunë të lëviznin, të zgjasnin kokën në drejtim të dorës së priftit, të pëshpërisnin.

Dom Nikolla zgjati të dy duart përpara, zhurma pushoi.

— Zoti nuk na urdhnon me ua dhanë të shty-men menjiherë deleve të pabinduna. Edhe ne do të bajmë simbas mësimit të tij. Në vend që ta nxjerrim prej kishet, po e dënojmë Gjin Bardhokun me nji gur pendese në shpinë për gjithë mëkatet e tij. Le t'i sillet me te rrëth e qark kishës së shenjtë e le t'i peshojnë në shpirt mëkatet njiqind fish ma shumë se ai gur pendese. Amen!

Heshtje. Një heshtje e rëndë, si në çastin, kur i vdekuri zbret në banesën e përhershme. Vendimi

i priftit i preu të gjithë... Ai gur mbi shpinë ishte çnderimi, ishte fundi! Dhe ai gur peshonte shumë, ishte një mal turpi, që duhej mbajtur patjetër, se prifti të çkishëronte...

Njerëzit zunë të dilnin kokulur nga kisha. Sytë e të gjithëve vështronin tinës një gur të madh, të gdhendur, pranë derës së oborrit. Guri i pendimit!

Dom Nikolla u afrua me të shpejtë.

— Zoti ta ndjeftë pendimin, Gjin Bardhoku!  
— tha, — Mbaje gurin!

Nga grumbulli i fshatarëve u shkëput një burrë rrëth të dyzetave, një burrë truplidhur dhe me ca sy të mprehtë. E vështroi pa frikë Dom Nakkollën.

— S'e ven Gjin Bardhoku n'shpinë gurin e pendesës, more zotni! Po këqyr se po i randon malë fort...

— Mendohu mirë, Gjin Bardhoku — e kërcënoi prifti. — O gurin në shpinë, o mallkimin. Eshtnat e tua s'kanë me pushue në vorre të kishës.

— Ban si të duesh. Gurin nuk e ve në shp'në, pasha bukën!

— Qofsh i mallkuem! — uluriti prifti, — Të vrafshin rrufetë e qiellit e zemrën ta coptofshin shtatë hanxharët e zojës sonë!

Gjin Bardhoku vështroi fshatarët. Disa ulën kokën, të tjerët e shikuani me dhembje, ndonjë ju kërcënuai. Ai ngriti kokën lart dhe zuri të largohej. I hapën rrugën, siç do t'ja lironin ndonjë demë të tërbuar. Ai tani ishte i mallkuar, i pafë!

\* \* \*

Gjin Bardhoku kish jetuar dyzet vjet me frikën e zotit në shpirt. Po më pas erdhi një kohë që ai u ftoh nga feja dhe nuk besoi më si përpara. Megjithatë, shkonte ndonjëherë në kishë, jo për të dëgjuar meshën, por për t'u ndodhur në mes të burrave dhe për të marrë pjesë në bisedat e tyre. Dom Nikollën e urrente. E urrente edhe si prift, edhe si njeri. Po mos ishin më të mirë priftërinjtë e tjerë që shërbenin nëpër fshatrat?! Të gjithë njësoj ishin. Marimanga... Kush më shumë e kush më pak, të gjithë i ngjanin Dom Nikollës. Fshati i Gjin Bardhokut ishte një nga më të vallfërit e asaj ane, fshat i mbytur gjer në grykë në borxhe tek tregëtarët e Shkodrës, që e kishin pronë të tyre. Gjin Bardhoku thoshte poshtë e lart se haku i kishës ishte i madh, se Dom Nikolla peshonte gashtëdhjetë çkë ndërsa fshatarët po vdisnin për bukë. Ku ishte mëshira e zotit këtu? Pastaj, c'ndjeri i zotit ishte ai Dom Nikolla, që bridhte me kobure në brez? Çfarë i duhej koburja atij?

Të gjitha këto i shkonin në vesh Dom Nikollës. Për një kohë urrejtja e tyre u vërtit nën rrogoz, gjersa ndodhi diçka që e mbushi kupën e zemërimit të priftit. Një plak i varfër, një farë Gjet Marku, tri vjet me radhë nuk kish qenë i zoti talante plotësisht hakun e kishës. Dom Nikolla e dënoi me «gurin e pendesës» dhe e urdhëroi ta mban te menjëherë në shpinë, në sy të të gjithëve. E për çfarë se? Vetëm se kish sjellë katër okë misër më pak.

— Aman, zotni — lutej plaku, — aman! Edhe këte që e kam pru, ma kanë falë shokët.

— Gurin në shpinë! Gurin në shpinë! — thërriste Dom Nikolla.

Plaku u ul dhë e vuri gurin në sup. U lëkund nën peshën e tij, pastaj u nis ashtu, këmbëzbathur siç qe, nëpërmes ferrave dhe drizave që rrëthonin muret e kishës. Të këpuste shpirtin tek e shihje ashtu. U rrrotullua një herë, pastaj erdhi përpara priftit dhe i hodhi një vështrim për të ardhur keq.

— Sillu! — bërtiti pristi — Sillu prapë!

Plaku gjëmoi. Pastaj bëri të ecte përpara.

Nga mesi i fshatarëve u hodh një burrë.

— Turp e marre! — bërtiti ai dhe me një lëvizje të shpejtë ja rrëzoi gurin nga supi plakut. — Shumë po i random malet, mor Dom Nikollë, shumë!

Ishte Gjin Bardhoku. Kështu doli fushës armiqësia e tij me priftin.

• • •

Një mbrëmje, pesë ditë pasi e mallkoi Dom Nikolla, Gjin Bardhoku kthehej nga një fshat i afërt. Kishte hedhur pushkën krahëve dhe po ecte i menduar. Befas pa një dritë të bardhë, që shkrepit përpara tij, pastaj ushtoi një krismë. Gjin Bardhoku ra përdhe, i goditur për vdekje. Të nesërmen e gjetën përbysë mbi «gurin e pendesës». Pushkën e kishte me tytë në drejtim të plagës.

— Zoti e ndjeftë! — u thoshte Dom Nikolla fshatarëve. — Nuk mundi me jetue si i pafe dhe vau veten tamam mbi ate gur që nuk desh ta mbante në shpinë. Zoti e ndjeftë!

\*\*\*

Disa vjet më vonë, pas çlirimit, u kap një diversant pranë pyllit të fshatit. Ai hqđhi drítë mbëvrasjen tragjike të Gjinit. Ai pohoi se, vetë i tre-të, i shtyrë nga Dom Nikolla, kështë vrarë Gjin Bardhokun.

Prifti kriminel u mundua të mohojë. Por, kur ai u ballafaqua me diversantin e kapur, të cilin e dinte të vrarë, u detyrua të pohojë. Ajo ideologjia e Vatikanit, që e bënte Dom Nikollën ta përdorte «gurin e pendimit» si mjet për të nënështruar e poshtëruar njërejt, e bëri atë vrasës. Shokët e Gjin Bardhokut kishin të drejtë të merrnin shpargim. Dhe e morën.

### SIHEMBJA E TEQESE

Asnjeri s'u gëzua më shumë se Floria, kur thanë se do ta shembnin mekamin pranë teqesë. Ajo vetë kish dashur ta shembte me duart e saj atë ndërtësë të vogël anës teqesë, me atë derë të rëndë ndërtuar me dhoga të trasha e me dy driftare të vogla pranë çatisë. Sa herë shkonte pranë saj, një ndjenjë e turbullt ja pushtonte shpirtin, prishej në fytyrë duke mbledhur buzët e kthente kokën në anën tjetër, nga neveria që ndjente.

Teqeja e Baba Qaniut nuk ishte shumë e vjetër. Pleqtë e mbanin mend kur ish ndërtuar, se pse ato livadhe që tani i përkisnin kësaj, dikur ishin të tyret.

Po s'kishin ç'bënин, ky qe vullneti i zotit dhe i atij, kaut të bardhë, të cilin dervish Halimi thonte se e kish sjellë nga ato vendet e shenjtë, të largëta e të panjohura.

Dervish Halimi kish ndenjur ca kohë në një teqe andej nga Skrapari dhe pastaj qe kthyer në fshat. Ai kish mbledhur burrat, atëhere që maj, e u kish thënë:

— Unë do të sjell një ka të bardhë «Ku të bjerë kau të ngresh një teqe», kështu më tha Ha-

xhi Bektashi në ëndërr, dhe unë ashtu do të bëj.

Pleqtë prisin. Kaun e suallën ca burra nga rruga e qytetit. Ai erdhi i urët, filloi të kulloste, ndërsa sytë e njerëzve e ndiqnin plot kureshtje. Pasi u ngop, u shtri që të ripërtypej në Livadhet, në tokën më të mirë të fshatit.

— Thikën! — tha shpejt dervish Halimi dhe ndërsa burrat mbanin kaun, ai i hipi përsipër dhe i preu kokën. Ai spërkati vendin me gjakun e kaut të shenjtë dhe nguli disa hunj.

Pastaj teqeja filloj rrugën e saj të zakonshme. Shenjë e mbarëvajtjes së saj qe qafa e trashë dhe e kuqe e dervish Halimit, i cili e deklaroi veten baba. U shtuan të ardhurat e saj, u shtuan çudirat që bënte, dhe dervish Halimi do të ish bërë vetë njeri i shenjtë sikur të mos i pëlqenin avenirat dhe paratë. Në kohën e luftës u bë ballist i tërbuar dhe fundi i tij qe fare i palavdishëm. Skuadra partizane e vuri rrëzë një muri dhe e pushkatoi.

Të gjitha këto i kish dëgjuar Floria, po atëhere as i shkonte ndër mend se atë ka të bardhë, hileja më e bukur që kish kurdisur dervishi për të gënjiyer fshatarët e thjeshtë e të padjallëzuar, ai e kish blerë në Fier. Vendin e baba Halimit pas lufte e zuri baba Qaniu. Teqeja vazhdonte punën e saj. Njerëzit vinin në teqe t'i luteshin zotit, i bënnin kurbane, merrnin dorë te babai duke u bërë myhibë<sup>1</sup>), i ndihmonin për të mbjellë, për të vjelë rrushin dhe për të bërë pekmes. Famë të ma-

---

1) Myhibë — quheshin kështu besimtarët që merrnin dorë te babai dhe pranoheshin në sektin e tyre.

dhe kish fituar teqeja nga përrallat e përhapura pér gratë që s'bënин fëmijë. Flitesh pér sa e sa raste, nusesh tē reja që gjoja ishin bërë me fëmijë, sapo kishin ardhur e ishin falur në atë teqe. Tē gjithë mrekullitë, thoshin se i bënte një copë hekur i bardhë, që ndodhej i ngulur në murin e mekamit. Sapo ta zije me dorë atë hekur... ndodhte çudia!

Edhe Floria e kish provuar atë hekur...

Kjo kish ngjarë para shtatë vjetësh.

Floria po hynte në vitin e katërt të martesës dhe akoma s'kish lindur. Kish dëshirë tē madhe, pasion tē zjarrtë tē mëndëte<sup>1)</sup> e tē përkëdhelte një fëmijë tē vogël. Qfarë s'kishte bërë pér tē patur një fëmijë!

Floria, pas vizitave tē gjata nëpër spitalet e qytetit, qe kthyer në ilaçet e plakave dhe, pas këtyre ish hedhur në krahët e zotit «mëshirëplotë».

Një rr Ethanë e bënte tē besonte vërtet në një diagnozë tē çuditshme tē plakave tē fshatit. Ato thoshin me një gojë se ajo nuk bënte fëmijë mbasi i qe «trembur gjaku» atë ditë që ish martuar. Dhe a mund tē ngjiste ndryshe, kur Floria priste tē martohej me Kadrinë, ndërsa i ati dhe tē vëllezëri qenë marrë vesh me ca njerëz tē tjerë që ta rrëmben tek kulloste bagëtitë në mal pér ta martuar me një tjetër që ajo as e njihte? Floria u kish shpëtuar atyre duke u hedhur në lumë. Mos ishte e lehtë kjo pér një vajzë? Mos i qe «trembur gjaku» vërtetë?

Dhe e vjehrra gjithmonë e këshillonte:

---

2) Mëndëte — Me kuptimin t'i jepte gji foshnjës.

— Pse tē mos vemë një herë nē teqe? Këtu vijnë nga ana e anës dhe tē mos vemi ne që e kemi nē prag tē derës?

I kish thënë kaq shumë herë sa Floria më nē fund ish bindur. **Kish dëgjuar ca fjalë që nuk i** pëlqenin, po e vjehrra i kish thënë se gjëra tē atilla s'ishin pér t'u besuar. Këto i thoshin njerëzit që kishin dalë nga rruga e zotit.

Floria as vet s'besonte te zoti. Më tepër kish një frikë tē pa përcaktuar pér ato gjera që s'kuptonte se sa ndjenjë tē vërtetë fetare.

E vjehrra e siguroi se do tē shkonin së bashku nē teqe dhe s'kish pérse tē ndruhej. Pse tē mos e provonin edhe këtë gjë? Mos qenë ndryshe nga tē tjerat?

Dhe Floria u nis me vjehrrën nē teqe. Baba Qaniu i priti mirë. U shtruan nē shilte, biseduan pér motin, pér tē korrat, pér bagëtinë.

Hëngrën drekë së bashku duke këmbyer tek tuk ndonjë fjalë.

Pas bukës nëna, siç e thërriste Floria, duke vënë dorën nē zemër, tha:

— Ejvallah Nazari ne kemi ardhur pér një hall.

Dhe me pak fjalë i tregoi pérse kishin ardhur.

— Pse kështu, bijë e babajt? — tha ai duke e përkëdhelur me sy Florien, — më përpara tē kishe ardhur këtu pastaj tē kishe shkuar gjetkë. A bëhet gjë pa urdhëruar allahu?

— Këta tē rintjtë tani e kanë me shkencë, — tha me qesëndi nëna.

Me zë tē butë baba Qaniu vërejti:

— Edhe shkenca është nē dorën e zotit. Po s'urdhëroi ai nuk i vete mëndja shkencëtarit. Edhe

barërat të mira janë, nuk them se jo, bëjnë mirë pér kollë, pér plevit, pér djegie, por pér fëmijë s'bëjnë gjë, se kjo është në radhë të parë në dorë të zotit.

Pastaj biseda mori karakter të përgjithshëm. Baba Qaniu tregoi pér njeriun, pér zotin, pér gjithësinë, dhe pér çudirat e Haxhi Bektashit, kur e bëri shkëmbin kalë dhe gjarpërin kamxhik dhe fluturoi me të sipër vendeve të shenjta. Me këtë përralla ai mundohej të pregetiste shpirtërisht Flörien pér fuqinë që kanë njerëzit e fesë e t'i largonte çdo emocion të pakëndshëm që mund ta kishte pushtuar atë, kur kishte shkelur prakun e teqesë.

Në drekë baba Qaniu tha se do të shkonte të falej pér nusen që zoti ta gëzonët me fëmijë dhe u mbyll në mekam.

Pas gjysëm ore babai u kthyte dhe e mori Flörien pér dore.

— Ta kungojmë! tha me sytë nga qielli.

Floria si e magnetizuar e ndoqi pas, duke e shikuar me frikë e ndruajtje.

Muzgu i mbrëmjes po binte ngadalë. Zhurmat e ditës po shuheshin, qielli po merrte një ngjyrë manushaqe, ndërsa ajo ecte dhe i dukej sikur pér herë të parë vinte re se si dita ja linte vendin natës.

U futën brenda në mekam. Prapa tyre u mbyll dera. Babai i tregoi hekurin e bardhë. Mjafton ta zije atë me dorë dhe laheshin të gjitha mëkatet.

— Vere dorën, bijë e babait.

Floria e vuri.

— A nuk e ndjen veten më të lehtë?

— Po, tha Floria me një farë dyshimi në kish thënë tamam fjalët që duhej.

— U lirove nga mëkatet, prandaj e ndjen vreten më lehtë. — E pas pak:

— Mirë, — tha babai me një zë të dredhur, — tani zhvishu.

Floria u step.

— Zhvishu, bijë e babait. Këtu vetëm syri i zotit na sheh.

Dy dritaret e vogla të mekamit qenë lart thuajse në çati. Asnjeri s'arrinte të hipte në to.

Floria qëndroi në të linjta.

— Zhvishu, të mos kesh mbi trup asnje rro-bë të huaj.

Gjysëm e zhveshur ajo priste tani me ankth çdo të ndodhje. Fytyra e babait ishte e qetë.

Pastaj babai e vuri pas murit dhe duke i shkuar duart mbi trup që nga supet e gjer te këmbët filloj të thoshte diçka nëpër dhëmbë, ca fjalë të panjohura me një tingull monoton, sa dukej sikur gjithë mekami thoshte «ylyly-bylyly».

Këtë veprim e përsëriti edhe nga kurrizi gjithmonë duke thënë të njëjtat fjalë: «ylyly-bylyly».

Pastaj bëri sikur ta përqafonte. Ajo u hoq mënjanë dhe duke thërritur «maskara» e shtyri me sa fuqi që kishte. Babai që s'e priste atë goditje, e humbi ekuilibrin dhe ra në dysheme.

Floria hapi derën dhe u zhduk në errësirë. Gjysmë e zhveshur vajti në shtëpi.

Ndërkohë në teqe baba Qaniu e mbledhi veten shpejt. Eksperiencia e gjatë dhe e pasur me këso punësh e ndihmoi si të delte nga gjendja e vështirë. Si doli nga tyrbja foli me një zë të përdëlluar, duke u munduar t'i japë fytyrës pamjen e një «shenjti».

— Nusja u çmend. Nuk e di q'pati, hapi derën dhe krisi e iku gjysmë e xhveshur. A del një njeri me mend këshfu? Rrobet i ka lënë këtu.

— Ku vajti? — pyeti vjehrra me frikë. — Ku ta gjejmë?

— Në shtëpi. S'ka ku të vejë gjetkë. Lidheni dhe mbajeni brenda ca ditë...

Ajo u kthye në shtëpi shumë e tronditur, duke menduar gjithë rrugës si të përgjigjej përpara djalit e çfarë t'i thoshte.

Po përfat nusja qe kthyer.

Atëhere ajo ju vërsul asaj me fjalë të ashpra.

Nusja e hoqi mënjanë dhe i tha:

— Të mos më thuash më asnijë fjalë se atë që më bëre ti, s'ma ka bërë njeri tjetër. Pse më shpure atje? Të pata thënë që ai është një maskara.

— Turp, turp, — tha vjehrra duke zënë faqet me duar.

— Më mirë të mos kemi tërë jetën fëmijë se sa të kthehem edhe një herë në atë teqe të mallkuar.

Njerëzit e afërm deshën ta mbyllin, por Floria nuk u tremb. Vizita e saj në teqenë e baba Qaniut bëri aq bujë sa që një pjesë e fshatit kërkoi largimin e tij. Por ai me be e rrufe thoshte se ja kishte kushtuar veten perëndisë, si gjithë njerëzit e tarikatit të tij, dhe Floria o ishte çmendur o nuk dinte q'thoshte.

Çështja u duk, sikur u mbylli. Por ndodhi diçka e papritur. Një ditë të rintjtë e fshatit dhe Floria u ngjitën me shkallë dhe prishën çatinë e tyrbes, e dalngadalë gjithë teqeja u bë rrafsh me tokën. Ca fanatikë prisnin që të dilte një gjarpër me dy kokë që ruante mekamin e t'u vërsulej të

«pafeve», por për çudi të tyre s'ndodhi asgjë, s'ndodhi asgjë as edhe, kur baba Qaniu mblodhi leckat e iku nga fshati.

Njerëzit, sidomos, fanatikët qeshën me veten e tyre, me frikën e tyre, po sidomos qeshën kur mësuan se njeriu i shenjtë, që ja kish kushtuar veten perëndisë, dy muaj pasi u prish teqeja kërroi të martohej me një vejushë.

44255

~~LIBRERIA E SHTETIT  
SHENJTORJA~~

**PËRMBAJTJA**

	Faqe
Përsheshi i paput (J. Xoxha) .....	3
Bualli i kënetës (M. Kallamata) .....	28
Bishtuku (Dh. Xhuvani) .....	44
Pariku (Gj. Zheji) .....	58
Hija e zezë e «efendiut» (M. Zaloshnja) .....	73
Futa e zezë (S. Dreni) .....	83
Lugina e rusevë (F. Cakaj) .....	91
Shenjtorja e Shpatit (A. Hamiti) .....	100
Haj e lër, o zoti Shën Thanas (N. Prifti) .....	109
Sënduku i shenjtë (P. Zoto) .....	114
Hieja dhe shkolla (Xh. Veizaj) .....	121
Guri i pendimit (S. Drini) .....	138
Shembja e teqesë (N. Prifti) .....	144

